

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIV - Nr. 7442 E premte 16 Shkurt 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion Ditës

Para së gjithash, dua të falënderoj organizatorët e këtij eventi dhe sidomos zotin Rakipi, i cili më ftoi të marr pjesë në këtë takim, ftesë kjo që unë e pranova ...
Vijon në faqet 18-19

Nga ALEKSANDËR KARPUSHIN

NATO-centrizmi dhe interesi rus në Shqipëri



Studimi Ditës

Problemet e njohjes së kufirit shqiptar prej Greqisë e kanë zanafillën qysh në dekadat e para të shtetit grek, kur edhe pse nuk kishte akoma shtet shqiptar, hapësira ...
Vijon në faqet 14-15

Nga ALBERT HITUALIAJ

Gjeopolitika e kufirit greko-shqiptar sipas DASH



Vendimi nga Departamenti Amerikan i Shtetit

Ish-kryeprokurori Adriatik Llalla dhe familja e tij shpallen "non grata" nga SHBA

Sekretari i Shtetit, Rex Tillerson: Masa e ndalimit, për shkak të përfshirjes së ish-zyrtarit shqiptar në raste të mëdha korrupsioni

Ish-kryeprokurorin Adriatik Llalla dhe familjes së tij i ndalohet hyrja në SHBA. Ky ishte vendimi i Departamentit Amerikan të Shtetit, i cili është bërë publik më 14 shkurt. Sekretari i Shtetit, Rex Tillerson sqaron se DASH e miratoi masën e ndalimit për shkak të përfshirjes së ish-zyrtarit shqiptar në raste të mëdha korrupsioni. Ligjet ...
Në faqen 4

TOKAT E ZENA NGA NDERTIMET PA LEJE, PROCEDURA E RE PER TE MARRE PARATE

NDRYSHON LIGJI PER KOMPENSIM, FORMULARI I RI PER PRONARET

Agjencia e Trajtitimit të Pronave publikon dokumentet që duhet dorëzoni. Kostoja e aplikimit është 2000 lekë. Toka do paguhet me çmimin e tregut



(Në foto) Zonë informale

TEATRI E INCENERATORET

Kuvendi sherr e batuta, Rama-Berishës: Erdhe nga delet. Ish-kryeministri: Ty të ruajnë 350 gardistë
Në faqet 2-3

INTERVISTA

Ngërçi në Kushtetvese, Gjata: Mund të shfrytëzohet për marrëveshjen e delit. 4 sugjerime për reformën
Në faqen 5

ARTISTI TREGON EMRAT

Maks Velo hap dosjen: Më ka spiunuar miku im, Llambi Blido. 27 denoncime nga vjehrra
Në faqen 17

REAGIMI

"CEZ", Balla e Berisha përplasen te Krimet e Rënda, deputeti i PS: Ka miliona pa punuar
Në faqen 11

MJEKJA: PACIENTET TE MOS DETYROHEN PER TE BLERE ILAÇE



Alarmi, mungojnë ilaçet për fëmijët me kancer. Anila Godo: Rreth 80 raste të reja në vit
Në faqen 12

Policia: Memli Begalla merrte mbi 50.000 euro nga të tjerë, precedentët

Borxhet, si u ekzekutua para shtëpisë biznesmeni

Mediat italiane: Rrëmbeu të bijën se s'donte që të martohej

Ekzekutimi me plumb në kokë i biznesmenit Afrim alias Memli Begalla ka alarmuar policinë dhe prokurorinë e Tiranës. Një ditë pas ngjarjes së rëndë të ndodhur mbrëmjen e së mërkurës në rrugën "Nikolla Tupë" në zonën e ish-Blokut, burime pranë



grupit hetimor bënë me dije se 64-vjeçari (administrator i kompanisë LAB-AB, e cila merrej me import-eksport, ndërtim dhe turizëm) u qëllua për vdekje me një pistoletë tip "TT" me selinciator. Babai i tre fëmijëve ishte duke hipur ...
Në faqen 9

PARLAMENTI DEBATET

PD akuzon qeverinë "Rama" se ka shpenzuar 178 mln euro për 3 inceneratorë

Mbetjet, Tabaku: Skema mafioze, burgu është gati. Gjiknuri: Ka transparencë

Akuzat e Bashës, Ahmetaj: Nuk kam qenë në makinë me Klodian Zoton

Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë, Damian Gjiknuri, raportoi dje në Kuvend për koncesionet e inceneratorëve në Elbasan, Fier e Tiranë. Pas kërkesës së bërë nga Partia Demokratike, Gjiknuri tha se transparencja për këtë çështje ka qenë e plotë dhe Partinë e Vetës dhe Partinë Demokratike të Publik Privat ka qenë e vetmja zgjidhje. Deputetja e PD-së, Jorida Tabaku, e cila foli në emër të partisë së saj, theksoi: "Qeveria shqiptare në vite bashkë me GTZ (GIZ) hartoi një strategji për menaxhimin e mbetjeve dhe përçaktoi landfill rajonal. U ndërtaun landfill në Shkodër, Tiranë etj. Filluan të ndërtohen, por papritmas 3 vite më parë nga asgjëja, qeveria dha vendimin e parë për një incenerator për djegjen e mbetjeve në Elbasan. Vazhdoi i dyti në Fier e i treti në Tiranë. Më konkretisht, lidhja e kontratës është paraprirë nga një procedurë që ligji nuk e parashikon. Se si është zhvilluar procedura, ende nuk është bërë publike. Por, që prej tre muajve i kam kërkuar qeverisë dhe ministrave dosjen, ndërkohë që vetëm dy ditë më parë më kanë vënë në dispozicion procedurën për koncesionin vetëm për inceneratorin e Fierit. Asgjë për Elbasanin, asgjë për Tiranën. Pse e gjithë kjo skemë u zbatua në funksion të dhurimit të një koncesioni, të një personi të vetëm në të tria qytetet? Aq i rëndësishëm ishte ky koncesion për qeverinë saqë vendosi të përshpejtojë 9 procedura në një ditë të vetme", tha Tabaku, sipas të cilit më 17 dhjetor qeveria ia kontratën fituesit Klodian Zoto. Deputetja Tabaku më pas u shpreh: "Vetëm dy ditë më parë më kanë sjellë një dosje, e cila në qoftë se ajo është dosja e plotë e të gjitha koncesioneve për 178 milionë euro që qeveria shqiptare i ka dhënë një kompanie të vetme,

atëherë nuk di çfarë të them, vetëm shprehjen e z.Alibeaj: Burgu 313 është gati, megjithëse thonë se edhe burgjet do t'i jepni me koncesion". Në këtë interpellancë reagoi edhe ministri i Ekonomisë dhe Financave, Aren Ahmetaj, i cili tha se inceneratorët s'ishin asgjë tjetër veçse ato që opozita kishte kërkuar në të kaluarën. "Ministrin që e ka iniciuar projektin për të zhdukur landfillin e kenit në koalicion. Lefter Kokën e kenit në koalicion", - tha Ahmetaj. "Nuk e kam mik, s'kam qenë në të njëjtën makinë. Nuk ju vjen turp?! Vazhdoni merrni ende me këto, se gjoja pas Klodian Zotës qëndron Ahmetaj. Unë të gjithë biznesmenët i njoh, miq i kam se kanë halle, këtë punë kemi. Ju thoni t'i shpallim armiq e t'i guajmë nga kulla? Pse janë dy botë këtu, kush kalon nga biznesi t'i biem. Nuk e kam mik, po edhe po ta kisha, do isha i nderuar...".

atëherë nuk di çfarë të them, vetëm shprehjen e z.Alibeaj: Burgu 313 është gati, megjithëse thonë se edhe burgjet do t'i jepni me koncesion". Në këtë interpellancë reagoi edhe ministri i Ekonomisë dhe Financave, Aren Ahmetaj, i cili tha se inceneratorët s'ishin asgjë tjetër veçse ato që opozita kishte kërkuar në të kaluarën. "Ministrin që e ka iniciuar projektin për të zhdukur landfillin e kenit në koalicion. Lefter Kokën e kenit në koalicion", - tha Ahmetaj. "Nuk e kam mik, s'kam qenë në të njëjtën makinë. Nuk ju vjen turp?! Vazhdoni merrni ende me këto, se gjoja pas Klodian Zotës qëndron Ahmetaj. Unë të gjithë biznesmenët i njoh, miq i kam se kanë halle, këtë punë kemi. Ju thoni t'i shpallim armiq e t'i guajmë nga kulla? Pse janë dy botë këtu, kush kalon nga biznesi t'i biem. Nuk e kam mik, po edhe po ta kisha, do isha i nderuar...".



Deputetja e PD-së, Jorida Tabaku



Ministri Damian Gjiknuri

"Vetingu në polici" futet me procedurë të shpejtë

Kuvend, votohet projektligji mbi bursën e energjisë, 5 deputetët të LSI "pro"

Në seancën e sotme plenare, pas një debati për më shumë se 8 orë, u miratua projektligji mbi bursën e energjisë. Ky projektligji kaloi me 73 vota pro, 31 kundër dhe 3 abstenim në tërësi. Pesë nga votat "pro" ishin të deputetëve të LSI-së. Deputetë e LSI-së votuan në parim "pro", por në tërësi ata votuan kundër: Pesë deputetët e LSI-së ishin Edmond Haxhinasto, Edmond Panariti, Zhezai Rrokaj, Nasip Naço, Viktor Tusha. Për z. Haxhinasto, çështjes i përfitimit e konsumatorit, siguria e konsumatorit, tarifa e sistemeve të transmetimit dhe shpërndarjes në rast operimi nga aktorë të ndryshëm, garancija në rast të mosmarcjes së energjisë së blerë nga konsumatorët, përmirësimi i cilësisë së energjisë elektrike dhe kohëzgjatja me furnizim ishin çështje që duheshin adresuar më mirë nga projektligji. Seanca plenare miratoi me 86 vota pro dhe 1 abstenim projektvendimin "Për miratimin me procedurë të përshpejtuar të projektligjit 'Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme". Abstenim votoi deputeti i PD, Aldo Bumçi.



Rama i tha "ha pilaf, plënc e pi raki", Dash Shehi: Nuk fëlliqim fare

Gjatë fjalës së tij në Kuvend, kreu i LZHK-së, Dashamir Shehi u ka dhënë përgjigje deklaratave ironizuese të kryeministrit gjatë seancës së kaluar, ku ironizoi kreun e LZHK-së për ato që ai i quajti prirje europiane në lidhje me investimet e kompanive turke për aeroportin e ri të Vlorës. Shehi tha se nuk fëlliqim fare se pse ha plonca dhe groshë dhe sipas tij, mjafton që t'i shërbejë vendit. "Ne të Tironës hamë plonca dhe groshë, por ai ha si aristokratët. Le të thotë se unë ha groshë dhe plonca. Nuk fëlliqim fare dhe mjafton që unë t'i shërbejë vendit. Këta janë këlyshët e komunizmit dhe duan ta shesin Shqipërinë për interesat e tyre. Nëse këtu bëjmë batuta me plonca dhe raki, ai është nxënësi im dhe unë e lë 200 vite pas, por nuk duhet të merremi me këtë punë", - tha ai.



Kryeministri Edi Rama dhe ish-kryeministri Sali Berisha, gjatë seancës së djeshme parlamentare

OLTA XHAÇKA

Gjatë takimit të ministrave të Mbrojtjes të vendeve anëtare të NATO-s në Bruksel, ministria e Mbrojtjes, Olta Xhaçka pati një takim të veçantë me sekretarin amerikan të Mbrojtjes, James N. Mattis. Në bisedën miqësore të zhvilluar gjatë punimeve të këtij Ministeriali, sekretari Mattis vlerësoi bashkëpunimin dypalësh Shqipëri-SHBA, sidomos në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes. Takimi me sekretarin Mattis i paraprin vizitën së ministres Xhaçka në Departamentin Amerikan të Mbrojtjes në muajin prill.

Grada e Republikës i përgjigjet Berishës: Të shërbejmë, mos ceno imazhin

Garda e Republikës shprehu dje keqardhjen për sulmet publike të ish-kryeministrit Sali Berisha në seancën e Kuvendit, por edhe në faqen e tij në rrjetin social "Facebook", ku kishte publikuar një foto. Sipas Berishës, në atë foto ishin gardistët që keqshqeheshin, duke i bërë roje vilës së kryeministrit Rama, në Surrel. Garda në një reagim të saj sqaron se kjo "cenon imazhin, integritetin dhe dinjitetin e kësaj trupe në shërbim të autoriteteve shtetërore e të garantimit të sigurisë së aktiviteteve të tyre". "Ky institucion që qysh prej krijimit të vet e kryen veprimtarinë në kushte jo të lehta, ndjehet edhe më i keqardhur për faktin se është sulmuar përsëri publikisht nga një ish-kryeministër, të cilit i ka shërbyer dhe vazhdon t'i shërbejë me përkushtimin më të plotë", thuhet në njoftim. "Sqarojmë opinionin publik dhe vetë shkëlqesinë e tij, zotin Sali Berisha, se fotoja e propaganduar sot prej tij në Kuvendin e Shqipërisë, si pjesë e veprimtarisë së Gardës së Republikës, nuk ka asnjë lidhje me Gardën e Republikës dhe as me zonën e banimit e kryeministrit aktual të Shqipërisë. Po ashtu, personat në foto nuk janë punonjës të Gardës së Republikës", thuhet nga Garda. Sipas saj, kjo foto është bërë në një provincë të Italisë. Ata i kërkuar Berishës "të tregojë respekt për Gardën e Republikës dhe të mos e përfshijë këtë institucion në vorbullën e luftës politike, mbetimi në dispozicion të zotërisë për çdo verifikim të nevojshëm përpara sesa të bëhemi objekt i sulmeve politike mbi bazë shpifjesh".





Presidenti Ilir Meta u konsultua dje me 3 ish-presidentë të tjerë për marrëveshjen e kufirit detar me Greqinë. Pas takimeve të së mërkurës me Bamir Topin e Bujar Nishanin, ai dje priti ish-presidentët Sali Berisha, Alfred Moisiu e Rexhep Meidani. Madje, me këtë të fundit edhe ka drekuar. Takimet konsultative u zhvilluan pas kërkesës së Ministrisë së Jashtme për të marrë plotfuqishmërinë e presidentit për të nisur negociatat zyrtarisht për një marrëveshje që pritet të nënshkruhet në muajin prill, atëherë kur Rama dhe Tsipras do të takohen dhe që palët duken shumë afër dakordësisë. Në mbrëmje ai takoi edhe kryetaren e Komisionit parlamentar të Politikës së Jashtme, Mimi Kodheli. Plotfuqishmëria që duhet të japë presidenti sanksionohet në nenin 92 të Kushtetutës

Presidenti u konsultua edhe me Mimi Kodhelin

Plotfuqishmëria për paktin me Greqinë, Meta takon Berishën, Moisiun e Meidani



Presidenti Ilir Meta dhe ish-presidenti Sali Berisha, dje në Presidencë

ERJON BRACE
"Konsultimet e Presidentit Ilir Meta humbin logjikën tek Sali Berisha", deklaroi dje deputeti i PS-së, duke sqaruar se ishte Berisha, që shkeli Kushtetutën dhe refuzoi të merrte plotfuqishmërinë nga Topi. "E kuptoni se logjika nuk ka vlerë kur mendon se po bën politikë të madhe?", shkroi Brace.

dhe në vendimin për rrëzimin e marrëveshjes së vitit 2009, të bërë nga qeveria "Berisha". Kërkesa për plotfuqishmëri u bë nga Ministria e Jashtme pas dy takimeve të shtrirë zonën e tyre detare deri në 12 milje, siç e përcak-

ton Konventa Ndërkombëtare e Detit. Sipas "Report TV", ish-presidenti Moisiu ka shprehur në takim se marrëveshjet duhen bërë publike, ndërsa Meidani i konsideron normale të tilla takime.

Kryeministri, replika me ish-kreun e PD në Kuvend: Teatri i ri nuk do jetë as mbi kullë, as nën kullë

Batutat, Rama: Erdhe nga delet. Berisha: Të ruajnë 350 gardistë

"Asnjë qindarkë para publike nuk kam shpenzuar për aktivitetin artistik"

Darina Tanushi

Seanca e djeshme parlamentare përplasi ashtu siç shpesh ndodh, kryeministrin Edi Rama me ish-kryeministrin Sali Berisha. Madje në një moment, Berisha i kërkoi kreut të Kuvendit, Gramoz Ruçi ta nxjerrë nga seanca Ramën. Seanca ka vijuar me batuta, por edhe me akuza të ndërësella për çështje si ajo e ndërtesës së Teatrit Kombëtar apo arsimit të lartë. Gjatë fjalës së tij ish-kryeministri Sali Berisha tha se Rama ka "rrjedhur" ndaj ofendon artistët. Ndërkaq, tha se kryeministrin e ruajnë 350 gardistët në Surrel. "Kur ishte ministër i pseudo-kulturës mbushë xhepat duke zënë sallat e Teatrit me ruletat e bingove dhe të bixhozit. I ke të dokumentuara. Përsa u përket investimeve për kulturën, ke mbushur xhepat. Por investimet në periudhën e qeverisë së kaluar kanë qenë të paktën tri herë më të mëdha se sa ç'janë sot. Si për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, e cila po degradoon çdo ditë në të katërta anët e vendit, po shemben monumentet e pavdekshme të kohërave të lashta, të braktisura, të një vendi që s'ka shtet, të një lukunie që përpigjet të vjedhë dhe të nxjerrë paratë kudo



për të mbushur xhepat", i tha Berisha Ramës në Kuvend. "Po kush ta ndërtoi atë studion ty nën kryegjyhatë? Me çfarë paresh? Po kush ta ndërtoi Surrelin ty? Me çfarë paresh e ndërtove Surrelin? E dini që janë 350 gardistë të angazhuar për të ruajtur fshatin Surrel? A e dini se si hanë të shkretët? Hanë në stola, s'kanë ku rrinë, por vetë jeton në sara-je ky. Vetëm xhami i tavanit i ka kushtuar 170 mijë euro, se është superspecial. 70 mijë euro ka bërë vetëm pigmenti i bojës së vilës. Një batalion policie ruan rrugën nga Surreli në Kryeministri. Se burrë më frikacak bota s'ka më të madh se këtë", i tha Berisha, Ramës. Ndërsa kryemi-

nistri u shpreh: "Në Teatrin e ri Kombëtar do ta ndërtojmë. Nuk do të jetë as nën kullë, as mbi kullë, sepse po kërkojmë një mundësi të re. Ne do bëjmë Teatrin. Siç është Stadiumi Kombëtar, i riu, që e premtoi Saliu, iu tha shqiptarëve do ju baj Arenën kuqezi. Ku e ke Arenën kuqezi?" E ndërsa ish-kryeministri ishte ngritur në këmbë në një moment, duke treguar edhe foto të Ramës nga tableti i tij, i ka kërkuar Ruçi ta nxjerrë jashtë, Rama iu përgjigj: "Ju hoqët këpuçët këtu dhe nuk ju nxori njeri jashtë. E fillon me elitën e kombit, shkon te shkarravinat, pastaj te inceneratorët dhe në fund je ai që je".

PJESË NGA REPLIKAT RAMA-BERISHA

EDI RAMA: Jeni njësoj si ata aktorët që zihen për muret, ndërkohë që fatkeqësia e tyre është që nuk ka rolë.
EDMOND SPAHO: Keni dashur që kur ishit ministër Kulture të ndërtonit një teatër me kullë dhe ndoshta tek kullat të varnit ato që janë thënë. Vetëm kryeministri i asaj kohe, që sot e ke ministër në qeveri dha urdhër që projekti juaj nuk do të zbatohet.
SALI BERISHA: Kur ishte ministër i pseudo-kulturës mbushë xhepat duke zënë sallat e Teatrit me ruletat e bingove dhe të bixhozit. I ke të dokumentuara. Përsa u përket investimeve për kulturën, ke mbushur xhepat. Ky po ju fundos juve në fund të detit. Nëse e duroni dhe e mban, ju qofshi. Rama është kryehajduiti, këta që shihni këtu s'janë asgjë para tij. Këta s'levizin dot qimën pa lejen e këtij, këta shklojnë derdhin paratë në zyrën e tij çdo ditë. Po kush ta ndërtoi atë studion ty nën Kryegjyhatë? Me çfarë paresh? Po kush ta ndërtoi Surrelin ty? Me çfarë paresh e ndërtove Surrelin? E dini që janë 350 gardistë të angazhuar për të ruajtur fshatin Surrel? A e dini se si hanë të shkretët? Hanë në stola, s'kanë ku rrinë, por vetë jeton në sara-je ky. Vetëm xhami i tavanit i ka kushtuar 170 mijë euro se është super-special. 70 mijë euro ka bërë vetëm pigmenti i bojës së vilës. Një batalion policie ruan rrugën nga Surreli deri në Kryeministri. Se burrë më frikacak bota s'ka më të madh se këtë. E patë vetë që u fut në vrimën e miut. Ndaj lëri ato, s'mund të gënjesht ti artistët. Aty ke parashikuar kullën 45-katëshe. Ke parashikuar të marrësh për vete një 4-5 kate të mira njëherë. Po lufton dhe ndikulla të marrë diçka, siç thonë qytetarët.
EDI RAMA: Në Teatrin Kombëtar, Sali, do ta ndërtojmë që ta dish ti. Ti nuk do shkoh në Teatër, se ti s'ke nevojë. Ti je regjisori, je aktor, je edhe spektator, ke edhe teatrin tënd dixhital. Ti vazhdo të teatri yt. Në Teatrin e ri Kombëtar do ta ndërtojmë. Nuk do të jetë as nën kullë, as mbi kullë, sepse po kërkojmë një mundësi të re. Ne do bëjmë Teatrin. Siç është Stadiumi Kombëtar, i riu, që e premtoi Saliu, iu tha shqiptarëve do ju baj Arenën kuqezi. Ku e ke Arenën kuqezi?
BERISHA, RUÇI: Nxirre jashtë (për Ramën).
RAMA: O Sali, ju këtu hoqët këpuçët në mes të Parlamentit dhe nuk ju nxori njeri jashtë. Kështu që e di dhe nuk të vë faj se është ajo hirja e të parëve, kur i shihje njerëzit nga flokët e gjata dhe nga basetat si Zdravko Çolici. Atëherë ishte në krye të luftës kundër shfaqjeve të huaja. Ishë sekretar partie në fakulltet dhe luftojte me pantallonat "cowboy". Megjithëse ishte "boy of cows" se kishe ardhur nga lidhja e ngushtë me lopët dhe me delet, siç e ke thënë dhe vetë, luftojte këta që mbanin pantallonat "cowboy". Tani merresh me këpuçët. Ti vjen këtu, ndërthyn, e fillon me elitën e kombit, shkon tek gardistët, del tek shkarravinat, kthehesh tek inceneratorët dhe në fund shfaqesh ai që je. Prandaj mos vizato kurrë. Berisha nxjerr fotot me tablet.
RAMA: O Sali, kujdes se po të marrin dhe po të filmojnë dhe kushedi çfarë po të del dhe ty. Kujdes se ti je i çuditshëm dhe ku nuk futash. Kujdes se ka kamera lart... Na morët fytyrën edhe në të tjerëve. Kujdes të lutem, mos na i hap këto muhabetë. Të lutem Sali, bashkoi me aktorët se ti mund të flasësh në emër të Agron Llakajt, se Agron ka punë. Ti bashkoi me ata të papunët dhe fal në emër të Agron Llakajt. Atë punë ke, vazhdo, vetëm kujdes ata atje lart. Sali, se i përsërit shpesh me atë teorinë "shpif" shpif se diçka do të mbetet", por po të sqaroi që asnjë qindarkë para publike nuk është shpenzuar kurrë për asnjë aktivitet timin artistik, zero. As biletat e udhëtimit, as qëndrimet në hotel jashtë, jo më pastaj ekspozitat. Por ti nuk kupton nga kjo punë. Sa për gardistët dhe për... 350 the? E ke të nevojshme të thuash 350, se kur ishte zotrore, nuk lëvizje pa një karvan të tërë që të shoqëronte. Ndërkohë që unë kam shkurtuar në mënyrë drastike të gjithë shërbimet për mua.

DREJTËSIA AKUZAT

Sekretari i Shtetit: Vendimi u mor nga Departamenti Amerikan e Shtetit

Ish-kryeprokurori Adriatik Llalla dhe familja e tij, "non grata" në SHBA

Rex Tillerson: Masa e ndalimit, për shkak të përfshirjes në raste të mëdha korrupsioni

Ish-kryeprokurorit Adriatik Llalla dhe familjes së tij i ndalohet hyrja në SHBA. Ky ishte vendimi i Departamentit Amerikan të Shtetit, i cili është bërë publik më 14 shkurt. Sekretari i Shtetit, Rex Tillerson sqaroi se DASH e miratoi masën e ndalimit për shkak të përfshirjes së ish-zyrtarit shqiptar në raste të mëdha korrupsioni. Ligjet amerikane parashikojnë që në rastet kur ka informacione të besueshme se zyrtarë të huaj përfshihen në raste madhore korrupsioni, ose në shkelje të rënda të drejtave të njeriut, këtyre individëve dhe familjes së tyre u ndalohet hyrja në Shtetet e Bashkuara. Ligji po ashtu parashikon që Sekretari i Shtetit ka të drejtë që sanksionet ndaj këtyre individëve dhe familjeve të tyre t'i miratojë privatisht ose publikisht. Përveç zotit Llalla, sekretari Tillerson ka miratuar ndalimin e hyrjes në Amerikë edhe të bashkëshortes së tij, Ardjana Llalla; të vajzës Eni Llalla dhe një fëmije tjetër të tij, që nuk ka shtetësinë amerikane. Pak ditë më parë ambasadori amerikan, Donald Lu u shpreh se Llalla i shpëtoi vetingut, por s'duhet t'i shpëtojë hetimit penal. Përmes dy mesazheve në "Twitter", shefi diplomacisë amerikane kërkoi që historia e Adriatik Llallës të mos mbyllet me kaq. Në mesazhin e parë, Lu tha: "Vendimi për t'u tërhequr është një vendim personal, por largimi i çdo gjykatësi apo prokurori të korrumpuar apo të paafte është një fitore në betejën për një sistem drejtësie më të mirë. Ata nuk mund të rikthehen në sistem për 15 vjet", thuhet në reagimin e Lu. Ambasadori Lu megjithëse nuk e përmend emrin e Adriatik Llallës, referimi i drejtohet pikërisht atij. Donald Lu i dërgon një mesazh të qartë ish-kreut të akuzës shqiptare apo edhe atyre që kanë ndërmend t'i shpëtojnë vetingut. Lu kërkoi për ta hetime dhe ndjekje penale. Kjo është kërkesa e tij, që vjen padyshim si një kambanë alarmi për njerëzit e drejtësisë. "Vendimi për t'u tërhequr nuk i shfaqëson këta ish-zyrtarë nga përgjegjësitë e mundshme penale për korrupsion apo shpërdorim detyre. Ata që kanë frikë nga vetingu, duhet të kenë frikë edhe nga hetimet e pashmangshme penale", thuhet më tej në reagimin e ambasadorit amerikan.



Ambasadori amerikan, Donald Lu dhe Adriatik Llalla

Arta Marku: Të rihapen dosjet e pezulluara, hetoni korrupsionin

Kryeprokurorja Arta Marku ishte dje në analizën e Prokurorisë së Tiranës, ku nuk ka kursyer kritikën për cilësinë e hetimeve dhe dosjet e pezulluara për të cilat ka kërkuar rihapjen e dosjeve të vjetra. "Në dimensionin cilësor rezultojnë dukshëm hetime pa cilësi, sporadike të paorganizuara dhe me mungesë vizioni për t'u fokusuar në prioritetet që ka pasur dhe ka prokuroria në luftën kundër krimit. Prokurorët me kurajë dhe guxim duhet të fokusohen tek hetimi i çështjeve me karakter sensitiv dhe impakt në publik, si korrupsioni në të gjitha fushat dhe nivelet e çfarëdo lloji, abuzimi me pushtetin nga nëpunësit publikë, lufta kundër drogës dhe grupeve kriminale që organizojnë dhe financojnë kultivimin, shpërndarjen e drogave në qytetin e Tiranës", u shpreh Marku. Kryeprokurorja kërkoi nga prokurorët e Tiranës rihapje të dosjeve të vjetra, të cilat qëndrojnë në sirtarët e organit të akuzës së kryeqytetit. "Rritje të bashkëpunimit me shërbimet e Policisë Gjyqësore për të analizuar çështjet e vjetra të pezulluara, kjo me qëllim rifillimin e tyre dhe ndëshkimin e autorëve, si një fillim i mirë për të rritur besimin e publikut tek agjencitë e zbatimit të ligjit dhe organet e drejtësisë", kërkoi më pas Marku. Po ashtu, ajo kërkoi nxitjen e prokurorëve për të filluar hetime kryesive, duke shfrytëzuar çdo informacion që mund të merrret nëpërmjet mediave apo burimeve të ndryshme informative. "Pavarësia e prokurorisë, ashtu siç edhe jam shprehur edhe në takime të tjera me prokurorët, është një prerogative kushtetuese dhe ligjore, që duhet ushtruar me përgjegjësinë më të madhe nga çdo prokuror i çdo niveli goftë. Është një prerogative që ju shumëfishon obligimin për t'u thelluar në ushtrimin e përgjegjësisë tuaj, në ushtrimin e ndjekjes penale dhe përfaqësimit e akuzës", u tha Marku prokurorëve të Tiranës.

Dorëheqja e Llallës nga sistemi i drejtësisë e përjashton nga vetingu

Në fund të muajit janar 2018, ish-kryeprokurori Llalla bëri kërkesë për të mos qenë më pjesë e sistemit të drejtësisë. Ai njoftoi Presidentin e Republikës, Ilir Meta, në cilësinë e kryetarit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, se ka hequr dorë nga e drejta për të qenë pjesë e sistemit të drejtësisë shqiptare. Ligji parashikon që pas përfundimit të detyrës, Prokurori i Përgjithshëm mund të emërohet Gjykatës i Apelit. Këtë njoftim, z.Llalla ua nisi për dijeni edhe organeve të ngarkuara me procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, i njohur edhe me termin veting. Ish-Prokurori i Përgjithshëm është në listën e drejtuesve të lartë të sistemit të drejtësisë,



emrat e të cilëve po i nënshtrohen këtij procesi. Tërheqja për të mos qenë pjesë e sistemit të drejtësisë duket se mund t'i japë atij mundësinë që verifikimet ndaj tij të ndërpriten. Ligji parashikon që "subjekti i rivlerësimit ka të drejtë të japë dorëheqjen nga detyra jo më vonë se 3 muaj nga hyrja në fuqi e këtij ligji... Në rastin e dorëhe-

qjes, komisioni merr vendim për pushimin e procedurës së rivlerësimit". Por ky nen u analizua nga Gjykata Kushtetuese, kur vitin e kaluar dy shoqatat e gjyqtarëve që vepronin në Shqipëri iu drejtuan Gjykatës Kushtetuese për të shfuqizuar ndër të tjera edhe shprehjen "jo më vonë se 3 muaj nga hyrja në fuqi e këtij ligji". Në vendimin e saj të dhjetorit të kaluar, gjykata nuk e ka marrë parasysh kërkesën për shfuqizim, duke e quajtur nenin plotësisht kushtetues, por në interpretimin e saj, gjykata thekson se "për sa kohë që subjekti i rivlerësimit është në detyrë dhe procesi i rivlerësimit nuk ka përfunduar ende, ai ka të drejtën të japë dorëheqjen dhe në këtë rast procesi i rivlerësimit ndërpritet".



REPUBLIKA E SHQIPËRIË
ENTI RREGULLATOR I ENERJISË

NJOFTIM

Me vendimin nr. 31, datë 09.02.2018, Bordi i ERE ka vendosur "Fillimin e procedurës për miratimin e rregullave për sigurimin e aksesit të palëve të treta në sistemin e transmetimit dhe transparencën në sektorin e gazit natyror."

Të gjithë personat, shoqatat, institucionet, që mendojnë se kanë interes mbi këtë çështje, ftohen të shprehin opinionet dhe komentet e tyre me shkrim brenda 15 ditëve nga dita e publikimit të njoftimit.
Draftin e Rregullave sipërcituar, mund ta gjeni në faqen tonë të web-it: www.ere.gov.al në seksionin [Konsultime](#).

KRYETARI
Petrit AHMETI

Adresa: Bulevardi "Barjam Curri"
Rruga. Viktor Eftimi, Tiranë
E-mail: erealb@ere.gov.al

Tel/Fax +355 42 22 963
Tel +355 42 69 590
www.ere.gov.al



Prokuroria e Përgjithshme e Tiranës

Valentina Madani

Ish-kreu i KQZ-së, juristi Çlirim Gjata, beson se pa mbështetjen e ndërkom-bëtarëve nuk do të kishte reformim të sistemit të drejtësisë, por ai shpreh shqetësimin se në këtë periudhë as vetë ata nuk dinë se çfarë të bëjnë. Z.Gjata përmend se u reformua drejtësia pa prekur sistemin politik, që sipas tij, i shtriu l'kthe-trat' deri tek gjyqësori. Z.Gjata i referohet zgjedhjes së kryeprokurores së përkohshme, teksa thotë për "Gazeta Shqiptare" se me ardhjen e saj, kemi parë liri-me dhe zbutje, por jo arres-time kundër korrupsionit të lartë, apo krimin të organi-zuar". Lidhur me ngërçin në Gjykatën Kushtetuese, jur-risti zbardh arsytet teksa paralajmëron: "Këto kushte mund të shfrytëzohen nga politika qoftë edhe për intere-sa të momentit, siç është ai për të kaluar pa shumë zhurmë dhe kontroll marrëveshjen e detit me vendin fqinj".

KRYEPROKURORJA

"Prokurori i Përgjithshëm zgjidhet me 69 vota, pra vetëm nga njëri krah i politikës. Ndërkohë që nuk duhet të zgjidhet fare nga politika. Apo edhe deklarata e 'peshqve të mëdhenj'. Ku janë? Çfarë po bëhet? Me ardhjen e prokurores së re kemi parë liri-me dhe zbutje, por jo arres-time kundër korrupsionit të lartë, apo krimin të organi-zuar", deklaroi z.Gjata.



NGERÇI

"Këto kushte mund të shfrytëzohen nga politika, qoftë edhe për interesa të momentit siç është ai për të kaluar pa shumë zhurmë dhe kontroll marrëveshjen e detit me vendin fqinj. Ajo që ndodhi në Gjykatën Kushtetuese me marrëveshjen e parë mund të kthehet në bumerang sot", deklaroi juristi Çlirim Gjata.



Juristi: Marku veçse zbutje, jo arresime kundër korrupsionit të lartë, apo krimin të organizuar

Ngërçi në Kushtetuese, Gjata: Mund ta shfrytëzojnë për marrëveshjen e detit

Ish-kreu i KQZ, 4 sugjerime për reformën e re zgjedhore



Ish-kreu i KQZ-së, juristi Çlirim Gjata

eliminuar nga ONM. Kështu po rrezohet edhe miti i garancisë së ndërkom-bëtarëve.

Si e shikoni rolin e ndërkom-bëtarëve për përbushjen e kësaj reforme dhe pa ndihmën e tyre, a rrezikohet reforma në drejtësi?

Kjo reformë do të kishte qenë një disastër po të mos kishte ndërhyrë Komisioni i Venecias. Apo edhe pranimi në minutën e fundit të pretendimeve të opozitës politike nga ambasadorët në Tiranë për ndryshimet kushtetuese. Pra, do të kishte qenë edhe me keq. Prandaj kjo reformë nuk realizohej dhe nuk ecën pa ndërhyrjen e ndërkom-bëtarëve. Por mendoj, se edhe vetë ndërkom-bëtarët nuk janë të qartë në këtë periudhë se çfarë të bëjnë.

Në ç'kuptim nuk janë të qartë?

Po të lexojmë deklaratat e tyre, apo edhe heshtjen e tyre, duket kontradiksoni dhe pasiguria. Sepse nuk është e thjeshtë të bësh një Kushtetutë, nuk është politikë, diplomaci apo edhe dëshirë e vullnet. Është shkencë dhe shkencën më e vështirë e jurisprudencës. Si shembull mund të marrim emërimin e Prokurorit të Përgjithshëm të përkohshëm të përkrashur nga ndërkom-bëtarët. E gjithë reforma në drejtësi u bë që politika të mos kishte kurr-

farë ndikimi në drejtësi, pra t'i kishte duart sa më larg drejtësisë. Ky ishte qëllimi i madh i kësaj reforme.

... Dhe çfarë ndodh në këtë rast?

Prokurori i Përgjithshëm zgjidhet me 69 vota, pra vetëm nga njëri krah i politikës. Ndërkohë që nuk duhet të zgjidhet fare nga politika. Apo edhe deklarata e "peshqve të mëdhenj". Ku janë? Çfarë po bëhet? Me ardhjen e prokurores së re kemi parë liri-me dhe zbutje, por jo arresime kundër korrupsionit të lartë, apo krimin të organi-zuar.

Pse ka ngërç në Gjykatën

"ZGJEDHORJA"

Për t'i rënë shkurt, do të mbështetesh në disa pika. Së pari, futja e teknologjisë zgjedhore, votimi dhe numërimi elektronik. Së dyti, kontroll i rreptë mbi financimin e partive politike në fushata zgjedhore. Së treti, shkurtim dhe depolitizim i administratës zgjedhore dhe së fundi, masa të rrepta mbi kontrollin e fenomenit të shitblerjes së votës.

Kushtetuese dhe a ka të drejtë deputeti i PD-së, Oerd Bylykbashi, kur thotë se ky ngërç vjen si pasojë e marrëveshjes detare me qeverinë shqiptare dhe asaj greke dhe mund të shfrytëzohet nga qeveria pikërisht për këtë qëllim?

Edhe ky ngërç është pasojë e mënyrës tepër të ndërlikuar të emërimit të anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese. Kjo e fundit

ka mundësi të mbetet pa korum, sepse deri tani ka 4 anëtarë mangët. Dhe nuk është e qartë se kush nga të katër do të zgjidhet nga Presidenti dhe cili nga Parlatenti. Ndërkohë që propozimet bëhen nga KED, një institucion tjetër kushtetues, që ka hapur edhe ky i fundit një debat për mënyrën e funksionimit të tij. Këto kushte mund të shfrytëzohen nga politika, qoftë edhe për interesa të momentit siç është ai për të kaluar pa shumë zhurmë dhe kontroll marrëveshjen e detit me vendin fqinj. Ajo që ndodhi në Gjykatën

REFORMA

Kjo reformë do të kishte qenë një disastër po të mos kishte ndërhyrë Komisioni i Venecias. Apo edhe pranimi në minutën e fundit të pretendimeve të opozitës nga ambasadorët në Tiranë për ndryshimet kushtetuese. Pra, do të kishte qenë edhe me keq. Prandaj kjo reformë nuk realizohej dhe nuk ecën pa ndërhyrjen e ndërkom-bëtarëve.

Si ish-kryetar i KQZ-së, cili është sugjerimi juaj për reformën e re zgjedhore?

Për t'i rënë shkurt, do të mbështetesh në disa pika. Së pari, futja e teknologjisë zgjedhore, votimi dhe numërimi elektronik. Së dyti, kontroll i rreptë mbi financimin e partive politike në fushata zgjedhore. Së treti, shkurtim dhe depolitizim i administratës zgjedhore dhe së fundi, masa të rrepta mbi kontrollin e fenomenit të shitblerjes së votës.

Si mund të arrihet një gjë e tillë?

Kjo arrihet nëpërmjet ndryshimit të sistemit zgjedhor, ku të jenë qytetarët ata që do zgjedhin nëpërmjet alternativash dhe jo t'i jepen lista të gatshme si deri sot. Të gjitha këto të shoqërohen penalitete të rënda dhe mundësisht shpërblerja e votës të konsiderohet krimin i rëndë dhe barazohet me korrupsionin e të hetohet nga Krimet e Rënda (SPAK). Ka edhe një faktor tjetër, që mund të luajë një rol shumë të rëndësishëm. Ky është faktori ndërkom-bëtar që monitoron zgjedhjet në Shqipëri. Ky faktor duhet të ngrihet mbi nivelin mediokër të deritashëm dhe duhet të verë gishtin në plagë. Ata duhet të jenë të qartë, që nëse ka fenomen të shitblerjes së votës, të mos njohin zgjedhjet. Përndryshe e keqja do të vazhdojë.

NJOFTIM ANKANDI

Përmbasues gjyqësor privat Artan Sima, në datë 14/03/2018, ditën e Mërkurës, ora 16:00 përfundon ankandin i ri (i dytë), për shpëtimin e pasurisë së paluajtshme të llojit "Apartament" me sipërfaqe totale 73.40 m², e ndodhur në Bllisht, lenë garanci nga debitorit z. Ramadan Ibrahim Kordalli banues në Bllisht, Bashkia Devoll, për detyrimin ndaj kreditorit znj.Lindita Bere Kordalli, banuese në fshatin Tren, rrethi Devoll, në vlerën 1.080.000 lekë. Ankandin zhvillohet pranë zyrës së përmbasuesit me seli lagjen nr.3, Rruga «Avni Rustemi», nr.31 k.1, Korçë. Kontakt: Cel.0674044666, e-mail. simartaan@yahoo.com

REPUBLIKA E SHQIPERISE
Zyra përmbasimore "Best 2010"

SHPLLJIE ANKANDI

Më datë 03 Janar 2018 nga ora.08.00-ora.16.00 tek kjo zyrë përmbasimore do zhvillohet ankand i ri për shpëtimin e tokës (trual) Diani Selim Shuli që ndodhet në ZK 8581, L.1, prapa shkollës së mesme, Fqograde. Pona ka sipërfaqe 80 m². Cmimi fillestar për këtë pronë, me të cilin do çelët ankandin është 671.424 lek. P.s: Qytetarët/subjectet që dëshirojnë të marrin pjesë në ankand krahas një kërkesë duhet të kenë depozituar dhe 10% të cmimit fillestar si garanci për pjesëmarrje në ankand. Kjo garanci pasurore duhet të jetë e dëdhurur në BKT, nr.llogarisë Salmiri Hoxha PF (IBAN: AL07 2051 2046 4204 98CL PRCLALLA), para ditës së përcaktuar për ankand. Adresa: L. 2, prapa Prokurorisë së Rrethit Durrës. Tel/Fax: 052-22-6000 E-mail: best.2010@permbasues.al, web: www.permbasues.al

DREJTESIA AKUZAT

Kreu i PD takon deputetët gjermanë dhe britanikë: Kanabizimi, me bekimin e Ramës

Basha: Shteti i kapur nga krimi, Kuvendi u shndërrua në gjykatë

Vizita në Budapest, në samitin e Komitetit Ekzekutiv të CDI

Valentina Madani

Kryedemokrati Lulzim Basha ndodhet në Samitin e Komitetit Ekzekutiv të CDI, organizatës botërore të partive të qendrës së djathtë, i cili mbahet në Budapest. Z.Basha ndodhet atje me frësesë të kryeministrit të Hungarisë Viktor Orban. Në fokus të takimit dy ditë janë zhvillimet politike dhe bashkëpunimi mes partive të qendrës së djathtë. Në samit marrin pjesë një numër i madh drejtuesish politikë të Partisë Popullore Europiane dhe partive të qendrës së djathtë nga e gjithë bota. Para nisjes, kreu i PD-së, priti në takim të veçanta raporterin e Grupit Parlamentar CDU/CSU në Bundestag Thorsten Frei dhe anëtarët e Parlamentit Britanik, John Whittingdale dhe Martin Vickers. Deputeti gjerman Frei ishte me mision faktmbledhës për përbushjen nga Shqipëria të 7 kushteve të integritimit, për të cilat do t'i raportojë grupit më të madh parlamentar në Bundestag, CDU/CSU. Në të dyja takimet temat e bisedimeve u përqendruan tek nevoja jetike e Shqipërisë për të ndarë qeverisjen nga krimi, aleanca me të cilin vazhdon të jetë pengesa kryesore për hapjen e negociatave me Bashkimin Europian, thuhet në njoftimin e PD-së. Kryetari i opozitës theksoi se, ashtu siç konstatohet edhe në strategjinë e zgjerimit, kapja e shtetit nga krimi dhe interesat private është sfida më jetike me të cilën përballlet Shqipëria. Treguesi më i mirë për këtë është çështja "Tahiri", dhe qëndrimi që mbajti Rama duke rrëzuar kërkesën e prokurorisë dhe mbrojtur Tahirin me imunitet duke e kthyer Kuvendin në gjykatë. Ai u shpreh se kanabizimi i vendit ndodhi me dijeninë dhe mbështetjen e plotë të kryeministrit dhe instancave më të larta qeveritare, të cilët kanë bashkëpunuar



Kreu i PD-së, Lulzim Basha

me organizatat kriminale në këmbim të parave dhe ndërhyrjes së tyre në zgjedhje. Për të mbrojtur pushtetin e tij, theksoi Basha, kryemi-

nistri po përqendron të gjithë pushtetin dhe vendimmarrjen duke shkelur Kushtetutën dhe ligjet dhe duke uzurpuar çdo institu-

cion, përfshirë prokurorinë, gjykatat dhe reformën në drejtësi. Kreu i PD-së theksoi se krimi i organizuar me mbështetje qeveri-



Kreu i PD-së, Lulzim Basha, me deputetët gjermanë dhe britanikë

tarë, përveç investimit në zgjedhje po kap sektorë jetikë të ekonomisë. Basha tha se eksodi i shqiptarëve është pasojë direkte e krizës

ku e ka zhytur vendin aleanca e qeverisë me krimin. Pseudo-stabiliteti i bazuar në bashkëqeverisjen me krimin nuk është real dhe si i tillë nuk mund të zgjasë. Kreu i opozitës rikonfirmoi qëndrimin e opozitës për krijimin e një qeverie antimafia si hap i domosdoshëm për të zgjidhur krizën dhe për të rikthyer procesin politik përmes reformës zgjedhore dhe zgjedhjeve demokratike. Basha siguroi bashkëbiseduesit se Partia Demokratike mbështet plotësisht hapjen e negociatave, duke e konsideruar këtë hap si kontribues në monitorimin e qeverisë, e cila është përgjegjëse për mospërbushjen e kushteve të integritimit. Deputeti gjerman Frei ishte me mision faktmbledhës për përbushjen nga Shqipëria të 7 kushteve të integritimit, për të cilat do t'i raportojë grupit më të madh parlamentar në Bundestag, CDU/CSU.

73-vjetori i kryengritjes antikomuniste

Kreu PD-së Lulzim Basha kujtoi dje 73-vjetorin e Kryengritjes së Kelmendit. Sipas tij malësorët e Kelmendit i dolën përballë të keqes së madhe që po i avitej vendit dhe kombit, regjimit gjakatar, me kryengritjen e parë anti-komuniste në Europë. "Pasardhësit e komunistëve dëshmuuan me shembjen që i bënë mureve të kullës së Prek Calit në Vermosh se ata nuk janë të qetë me heronjtë e vërtetë as sot, pas 73 vitesh. Sepse heronjtë e kësaj bande qeverisëse janë kriminelët dhe trafikantët me të cilët ndajmë milionat e krimi", -tha z.Basha.



Studimi për strategjinë, ministri i Jashtëm takime në Holandë

Bushati: Perspektiva europiane e Ballkanit, garanci për një Europë të aftë ndaj sfidave



qipëria ka bërë përparim në plotësimin e prioriteteve, përbushja e të cilave forcon themelet e një demokracie funksionale të bazuar në shtetin e së drejtës dhe në një ekonomi

të zhvilluar, të aftë për të sjellë prosperitet për qytetarët", -tha ministri në fjalën e tij. Ministri bëri një panoramë të reformave dhe rezultateve të Shqipërisë në rrugën drejt Europës, që

Integritimi

"Që kur Shqipëria nisi udhëtimin e saj antikomunist, prioriteti ynë kombëtar ka qenë dhe është anëtarësimi në Bashkimin Europian. E kemi pasur gjithmonë të qartë që rruga jonë drejt BE-së është e patjetërsueshme".

nga vitet e para pas 90-ës deri në ditët e sotme kur Shqipëria po troket në derën e BE-së për hapjen e bisedimeve për anëtarësim. Sipas tij, është koha e duhur që BE të hapë dyert për Ballkanin

Perëndimor, pasi Europa bëhet më e fortë. "Marrëdhëniet me BE dhe perspektiva e integritimit evropian janë çelësi i stabilitetit dhe ecurisë së reformave në Ballkanin Perëndimor", -u shpreh ministri, i cili shtoi se shumë nga sfidat me të cilat përballlet sot Ballkani Perëndimor, janë të njëjta edhe për vendet e tjera, përfshirë edhe vendet anëtare të BE-së. Krjedhimisht, vetëm duke punuar së bashku, Evropa mund të jetë më e fortë për të përballuar sfidat, për të garantuar siguri, mirëqenie sociale dhe prosperitet për qytetarët e saj.

Analiza vjetore, Leskaj: Gjysma e tenderëve në 2017 u fituan nga vetëm 57 kompani

Shteti, 825,6 milionë euro dëm buxhetit

Meta vlerëson performancën e Kontrollit të Lartë të Shtetit

Ornela Manjani

Korrupsioni i lartë me pronat dhe legalizimet, problemet me tenderët publikë, rishfaqja e detyrimeve të prapambetura dhe nevoja e uljes së borxhit publik janë disa prej problemeve kryesore të evidentuara nga Kontrolli i Lartë i Shtetit në adresë të administratës publike. Në analizën vjetore të punës së këtij institucioni, Kryetari i KLSH Bujar Leskaj tha se gjysma e vlerës totale të tenderëve, janë fituar nga vetëm 57 subjekte. Në analizën e tij, kreu i KLSH Bujar Leskaj u ndal edhe te kostot shumë të larta me të cilat përballet shteti shqiptar për shkak të vendimeve të Gjykatës së Strasburgut.

DËMET

Nga auditimet e realizuara gjatë periudhës janar - dhjetor 2017 janë konstatuar parregullsi dhe shkelje financiare. Parregullsi dhe shkelje financiare, në të ardhurat dhe në shpenzimet e kryera, me dëm ekonomik në shumën totale prej 11.5 miliardë lekë ose 85.8 milionë euro. Shkelje të disiplinës financiare me ndikim negativ në performancën e subjekteve të audituara, në shumën totale prej 99.05 miliardë lekë, afërsisht 739.7 milionë euro nga e cila: 92.7 miliardë lekë në fushën e të ardhurave, afërsisht 692.1 milionë euro dhe 6.3 miliardë lekë afërsisht 47.8 milionë euro, në fushën e shpenzimeve jo me eficientë, efektivitet dhe ekonomicitet të fondeve. Në total janë konstatuar shkelje në shumën 110.5 miliardë lekë ose afërsisht 825.6 milionë euro. KLSH ka depozituar në organet e prokurorisë 47 kallëzime penale dhe 4 raste të tjera i janë përcjellë prokurorisë për vlerësim. Numri i personave të kallëzuar arrin në 129 persona. "Dëmi i konstatuar në realizimin e të ardhurave në dogana është në vlerën 1,637,631 mijë lekë ose 16%, pasuar nga 14% në fushën e prokurimeve, sektor që mbetet me një risk të lartë për sa kohë shkeljet nuk lidhen vetëm me dëmin e zbuluar, por edhe me mungesën e efektivitetit të një sistemi të plotë që siguron prokurimin e mallrave/punimeve/shërbimeve"-tha kreu i KLSH-së Bujar Leskaj.

PREZIDENTI

I pranishëm në analizën vjetore, Presidenti i Republikës Ilir Meta nxiti inspektorët e KLSH të vijojnë punën për rikthimin e be-



Presidenti Ilir Meta në analizën vjetore të KLSH-së


simit të publikut te institucionet shtetërore. "Performanca e qëndrueshme dhe në rritje e këtij institucioni gjatë viteve të fundit ka ardhur si rezultat i reformimit dhe modernizimit të praktikave audituese konform standardeve ndërkombëtare të auditimit duke ndikuar drejtpërdrejt edhe në forcimin e mirëqeverisjes së institucioneve publike në vend. Shtyllat kryesore mbi të cilat besoj se do të vazhdohet të bazohet veprimtaria e Kontrollit të Lartë të Shtetit janë pavarësia dhe profesionalizmi. Do të doja të ndalesha në disa momente, që i konsideroj si tejet të rëndësishme për rolin dhe vazhdimësinë e punës suaj"- tha Meta.

DËMI NË PRONA

Po të analizojmë dëmin sipas sektorëve, vërejmë se niveli më i lartë i dëmit për këtë periudhë është ai i shkaktuar në administrimin e pronës shtetërore në vlerën 4,1 miliardë lekë ose 36% të vlerës totale të dëmit të zbuluar dhe në riberljen e pasurisë shtetërore.



Grafiku 5: Dëmi ekonomik sipas fushave



Burimi KLSH

AKEP paralajmëron shërbimin 5G

Pas prillit do të prokurohen frekuencat e para



Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare njoftoi se gjatë këtij viti do të tentohet të tenderohet dhënia e disa frekuencave të reja që do mundësojë ofrimin e shërbimit 5G për kompanitë celulare, por jo vetëm. AKEP beri me dije vendimi është marrë në takimin e kësaj të enjte u miratua dokumenti rregullator për këshillim publik "Mbi dhënien e të drejtave të përdorimit në brezin e frekuencave 800 MHz (790-862 MHz)". Këto frekuenca ishin në përdorim nga televizionet, por gjithë procesi i lirim-it të tyre dhe kalimi nga AMA tek AKEP pritet të përfundojë shpejt në kuadër të dixhitalizimit. Pas muajit prill pritet që të vijohet edhe me prokurimin për t'i kaluar tek kompanitë celulare. "Plani Kombëtar i Frekuencave përcakton që këto frekuenca janë për përdorim nga operatorët që ofrojnë rrjete dhe shërbime publike të komunikimeve elektronike - telefoni e lëvizshme, për të mundësuar ofrimin e shërbimeve të gjeneratave teknologjike të avancuara të sotme dhe të perspektives të njohura ndryshe si LTE.

strukturës dhe Energjisë, ministri të Financave dhe Ekonomisë, AMA dhe AKEP. Në përfundim të këshillimit publik më datë 16.4.2018, procesi do të vijojë me administrimin e konkluzioneve të këtij konsultimi dhe procedurën për

zhvillimin e tenderit publik për dhënien e të drejtave të përdorimit të frekuencave në brezin 800 MHz (790-862 MHz) për ofrimin e rrjeteve dhe shërbimeve publike të komunikimeve elektronike LTE, duke e radhitur në këtë

mënyrë edhe Shqipërinë në vendet e më të zhvilluara në Rajon dhe Evropë në ofrimin e rrjeteve dhe shërbimeve publike të komunikimeve elektronike broadband të shpejtësisë së lartë"-mbyllet njoftimi i AKEP.

REPUBLIKA SHQIPERISE
GYJKATA E APELIT DËRRËS

Shpallje për vend të lirë punë për specialist IT pranë Gjykatës së Apelit Durrës
Kushitet që duhet të plotësojë kandidatit:

- të jenë diplomuar në shkencat teknologjike dhe informacionit, të paktën në nivelin "Master shkencor" ose të barasvlershëm me të, sipas përcaktimeve të legjislativës të arsimit të lartë;
- të kenë kryer të paktën një vit praktikë profesionale ose çdo lloj përvojë tjetër profesionale që lidhet me gjykatën;
- përbëjnë avantazh kualifikime në fushën e administratës së punësimiti dhe mëparëshëm në administratë gjyqësore;
- Të ketë njohuri të mira në gjuhë të huaja, sidomos gjuhës angleze;
- Të ketë aftësi të mira komunikuese dhe të bashkëpunimit në grup;

Dokumentacioni dhe afati i dorëzimit:
Kandidati të paraqesë brenda datës **26/02/2018** në Gjykatën e Apelit Durrës në adresën

Lagja Nr.14, Shkozet Durrës, këto dokumenta:

- Kërkesë për aplikim;
- CV të përshtirë me karrierën;
- Fotokopje të diplomës dhe librezës së notave (e noterizuar);
- Fotokopje të librezës së punës (e noterizuar);
- Fotokopje të certifikatave të kualifikimeve (nëse ka);
- Fotokopje të dëshmimeve të gjuhëve të huaja (nëse ka);
- Vërtetimin e gjendjes gjyqësore;
- Certifikatë personale.

Mosparaqitja e plotë e dokumentave sjell s'kualifikim të kandidatit.
Kandidatët e interesuar duhet të dërgojnë dokumentacioni pranë Gjykatës së Apelit Durrës **jo më vonë se data 26/02/2018**. Pas verifikimit paraprak të aplikimeve, vetëm aplikantët që kualifikohen për intervistë do të kontaktohen.

Agjencia e Trajtimit të Pronave publikon dokumentet që duhet të dorëzoni

Ornela Manjani

Tokat e zëna nga ndërtimet pa leje, formulari për kompensim

Kostoja e aplikimit është 2000 lekë

Të gjithë pronarëve që u është toka nga ndërtimet pa leje për të marrë kompensimin duhet të plotësojnë formularin tip dhe ta dorëzojnë atë në Agjencinë e Trajtimit të Pronave. Në listën e dokumenteve është dëshmia e trashëgimisë për të gjithë trashëgimtarët e ligjshëm të subjektit përfitues, sipas radhës së trashëgimtarëve, në përputhje me përcaktimet e Kodit Civil. Procesi i regjistrimit apo pranimit të kërkesave për kompensim fillon 5 ditë pas datës së njoftimit publik. Me urdhër të drejtorit të Përgjithshëm të ATP-së ngrihet grupi i punës për pranimin dhe shqyrtimin e kërkesave, me objekt shpërbëlimin e pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private që preken nga ndërtimet informale dhe shpërndarjen e fondit përkatës. Grupi i punës, brenda 60 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës për kompensimin e pronës, kryen verifikimet e duhura. Drejtori i Përgjithshëm i ATP-së, brenda 30 ditëve nga data e përfundimit të procesit të verifikimit nga grupi i punës, nxjerr vendimin me emrat e subjekteve që përfitojnë nga kompensimi dhe urdhëron publikimin e listës së subjekteve që kompensohen. Gjithashtu, ai njofton edhe aplikantët që nuk përfshihen në listën e subjekteve që kompensohen, duke përcaktuar arsyet e mospërfshirjes.

DOKUMENTET

Subjekti apo përfaqësuesi i tij me prokurë duhet të paraqesë pranë ATP-së Tiranë kërkesën tip që i vihet në dispozicion nga grupi i punës pranë AKKP-së, të plotësuar sipas rubrikave. Në listën e dokumenteve është dëshmia e trashëgimisë për të gjithë trashëgimtarët e ligjshëm të subjektit përfitues, sipas radhës së trashëgimtarëve, në përputhje me përcaktimet e Kodit Civil. Sipas ligjit për dëshmitë e trashëgimive të lëshuara nga gjykata për testamentin e bërë me akt noterial të sille certifikatë familjare e personit për të cilin është lëshuar kjo dëshmi.

Në rastin e kërkesave individuale të secilit bashkëpronar apo të një pjese të tyre, për çdo aplikim të kryer, paguhet tarifë shërbimi në vlerën 2000 lekë, pavarësisht se i përket të njëjtës pasuri të paluajtshme.

VLERA E PRONËS
Vlera e pronës që kompensohet nxirret bazuar në çmimin e tregut, llojin e pasurisë dhe qëllimin e përdorimit të saj, sipas standardeve ndërkombëtare të vlerësimit të pasurisë së paluajtshme. Procesi të vlerësimit të pronës, sipas përcaktimit të pikës 1 të këtij neni, i nënshtrohen të toka dhe objektet ndërti-

more. Në kategorinë e tokës përfshihen toka bujqësore, toka pyjore, pyjet, livadhet dhe kullotat, tokat e pafrytshme, si dhe trualli, pavarësisht masës dhe qëllimit publik apo privat të përdorimit të tij. Në kat-

egorinë e objekteve ndërtimore përfshihen ndërtesat dhe strukturat inxhinierike, që e gëzojnë këtë cilësi sipas legjislacionit në fuqi. Treguesit bazë të vlerës së pronës caktohen të veçanta për tokën dhe ob-

jektet ndërtimore. Kur një pronë është bashkim i tokës me objektin ndërtimor, vlera e saj nxirret për njësi, si shumë e vlerave të objektit ndërtimor dhe të tokës mbi të cilën ai ngrihet. Metodologjia për vlerë-

simin e pronës, miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave. Sipas ligjit baza e të dhënave shtetërore të vlerësimit të pasurive të paluajtshme krijohet me vendim të Këshillit të Ministrave, në të cilin përcak-

tohen: institucioni administrues i bazës së të dhënave shtetërore, të dhënat parësore dhe dytësore, ndërveprimi me bazat e tjera të të dhënave dhe niveli i aksesimit për subjektet e interesuara.

FORMULARI APLIKIMI
KOMPENSIM FINANCIAR PËR PRONARËT E PASURIVE TË PALUAJTSHME QË PREKEN NGA LEGALIZIMI I NDËRTIMEVE INFORMALE
AGJENCIA E TRAJTIMIT TË PRONAVE
MINISTRIA E DREJTËSISË

Nëse keni pyetje, lutemi kontaktoni:
Tel: (+355) 42 22 56 831 / 38
E-mail: info.atp@atp.gov.al
Web: www.atp.gov.al

Shënim: Ju lutem plotësoni me kujdes dhe qartë informacionin e kërkuar në fushat në poshtë, ME SHKRONJË TË MADHE E NË NGJYRË BLU.

HAPËSIRË E REZERVUAR VETËM PËR INSTITUCIONIN

SEKSIONI A: INFORMACIONI MBI APLIKANTIN

1. Emri	2. Mbiemri
3. Emri i Babait	4. NID <small>Nr. i identifikimit personal</small>
5. Gjinia <input type="checkbox"/> Mashkull <input type="checkbox"/> Femër	6. Datëlindja <small>Data Muaji Viti</small>
7. Vendlindja	8. Shtetësia
9. Adresa	
10. Qyteti	11. Rrethi
12. Kodi Postar	13. E-mail
14. Nr. Tel. Celular	15. Nr. Tel. Fiks

SEKSIONI B: INFORMACIONI SPECIFIK MBI APLIKIMIN

16. Subjekti përfitues	Emri i Babait
------------------------	---------------

Formulari-tip

DOKUMENTET

1. Kërkesën tip që i vihet në dispozicion nga grupi i punës pranë ATP-së, të plotësuar sipas rubrikave;
2. Dëshminë e trashëgimisë për të gjithë trashëgimtarët e ligjshëm të subjektit përfitues, sipas radhës së trashëgimtarëve, në përputhje me përcaktimet e Kodit Civil. Për dëshmitë e trashëgimive të lëshuara nga gjykata për testamentin e bërë me akt noterial të sille certifikatë familjare e personit për të cilin është lëshuar kjo dëshmi (në rast se subjekti përfitues ka vdekur);
3. Vërtetimin original të lëshuar nga një bankë e nivelit të dytë për hapjen e llogarisë bankare dhe IBAN-in përkatës;
4. Fotokopjen e dokumentit të identifikimit;
5. Certifikatën familjare të kërkuarit/aplikuesit;
6. Mandat pagesën për shumën 2 000 lekë për çdo aplikim të veçantë.

Kontrabanda dhe çmimet e referencës Dhoma Amerikane i ankohet drejtoreshës së Doganave

Çmimet e referencës, re spektimi i procedurave të rivlerësimit doganor apo kontrabanda në vlera të vogla janë disa nga shqetësimet që ka ngritur biznesi i Dhomës Amerikane të Tregtisë në një takim me Drejtoreshën e Përgjithshme të Doganave Belinda Ikonomi. Lidhur me çështjen e parë që është ajo e referencave biznesi u shpreh se pavarësisht akteve nënligjore të miratuara po edhe Kodit Doganor që hyri në fuqi në 1 qershor 2017 ngërçi ka të bëjë me zbatimin e gabuar në praktikë dhe jo me plotësimin e kuadrit. Biznesi theksoi se brenda sistemit rregullator përcaktohet qartë se kur përdoret nga dogana vlera e transaksionit dhe kushtet në të cilat kalohet për rivlerësim të cilat zbatohen sipas radhës. Në udhëzimin e fundit të Ministrit të Financave përcaktohet se kur ekz-



iston një ndryshim i dukshëm midis vlerës së deklaruar dhe çmimit të Database Kombëtar apo të dhënave të disponueshme nga bursat, ky përbën një indikator rrisht të vlerës së transaksionit. Ky parashikim i vend për interprim se kush do të konsiderohet ndryshim i dukshëm. Një tjetër shqetësim për të cilën biznesi u ankua është mungesa e akteve të arsyetu-

ara për rivlerësimin doganor nga ana e administratës, të cilat pengojnë operatorin të ndjekë procedurat e aplikimit (pasí mungon akti administrativ, i cili duhet të apelohej). Argumentimi i doganës për rivlerësimin doganor sipas biznesit është në shumë raste i cekët dhe i pabazuar në ligj. Po kështu, shumë kërkesa të subjekteve për korrigjimin të deklaratarës doganore mbeten pa përgjigje dhe veprim nga administrata.

Tatimet bashkojnë forcat në luftën kundër evazionit fiskal

Koordinimi i veprimeve në luftën e përbashkët kundër evazionit fiskal, ishte objekt i takimit të sotëm, në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve. Drejtuesit rajonale dhe ata të Drejtorisë së Hetimit Tatimor, në një tryezë të përbashkët, diskutuan mbi fushat e veprimit, shkëmbimin efektiv të informacionit dhe bashkëpunimin e ngushtë, me qëllim reagimin e shpejtë të strukturave përkatëse për të parandaluar, evidencuar dhe penalizuar fenomene të shmangies së detyrimeve ligjore nga ana e tatimpaguesve. Në konkretisht, në këtë takim u analizuan të dhënat mbi referimet e rasteve të përcjella nga Drejtoritë Rajonale Tatimore drejt strukturave të specializuara të Hetimit Tatimor si dhe intensifikimi i bashkëpunimit për referimin në kohë të rasteve të dyshuara të veprave penale të lidhura me tatim-taksat. Kryesisht ky bashkëpunim do të ketë në fokus fenomenet e dyshuara të mashtërimit financiar, akumulimin e detyrimeve tatimore të papaguara, raste të fshehjes së të ardhurave apo akumulimit të pajustifikuar të tyre si dhe çdo rast tjetër që përbën shkelje të legjislacionit tatimor. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve është e angazhuar në forcimin e kapaciteteve të administratës tatimore në luftën kundër fenomeneve të shmangies së detyrimeve ligjore dhe vënien përpara përgjegjësisë ligjore të autorëve që kryejnë vepra penale.



Policia: 64-vjeçari u merrte mbi 50.000 euro borxh biznesmenëve. Fqinjët: Ishte njeri i mirë, s' dëgjuam krisma

Borxhet, ja si u ekzekutua para shtëpisë biznesmeni

2 atentatorët e Begallës, vrasës me pagesë. Në 'sitë' edhe konfliktet e 2 djemve për drogë

TIRANË

Ekzekutimi me plumb në kokë i biznesmenit Afrim alias Memli Begalla ka alarmuar policinë dhe prokurorinë e Tiranës. Një ditë pas ngjarjes së rëndë të ndodhur mbrëmjen e së mërkurës në rrugën "Nikolla Tupe" në zonën e ish-Blokut, burime pranë grupit hetimor bënë me dije se 64-vjeçari (administrator i kompanisë LAB-AB, e cila merrej me import-eksport, ndërtim dhe turizëm) u qëllua për vdekje me një pistoletë tip "TT" me selinciator. Babai i tre fëmijëve ishte duke hipur në automjetin e tij, kur u qëllua me plumb në kokë. Sipas hetuesve të çështjes, dyshohet se viktima mund ta ketë njohur atentatorin, pasi është qëlluar nga afër (një metër largësi) dhe vetëm me 1 plumb, i cili rezultoi vdekjeprurës. Pas kryerjes së veprimeve paraprake hetimore, burimet e mësipërme pohuan se në vrasjen e Memli Begallës kanë marrë pjesë dy persona, të cilët dyshohen të jenë vrasës me pagesë. Dy agresorët, pas krimit janë larguar nga vendi i ngjarjes me një makinë tip "BMW" me ngjyrë të zezë. Ndërkaq, burimet në fjalë thanë se pista kryesore e hetimeve është ajo e borxheve. Kjo për faktin se 64-vjeçari u kishte marrë disa biznesmenëve mijëra euro borxh për të kryer investime dhe më pas nuk ua ka kthyer më. Gjithashtu, grupi hetimor po heton edhe për ndonjë konflikt të mundshëm të dy djemve të viktimit me persona të tjerë për trafik droge brenda dhe jashtë vendit. Kjo, pavarësisht se ata kanë deklaruar gjatë marrjes në pyetje se nuk kishin konflikte me askënd. Në lidhje me ekzekutimin e biznesmenit Begalla (pronar edhe i dy dyqaneve që tregtojnë goma, një në autostradën Tiranë Durrës dhe një në Yzberisht) janë shoqëruar dhe marrë në pyetje 10 persona, por ende nuk është bërë i mundur identifikimi dhe vënia në pranga e autorëve të krimit.

HETIMET

Mbrëmjen e së mërkurës, biznesmeni Memli Begalla ka zbritur nga kati i tretë i pallatit ku jetonte dhe është nisur drejt makinës së tij. Dyshohet se ai e ka njohur atentatorin, pasi ka tentuar që të hipë shpejt në mjetin në pronësi të tij. Agresori nuk i ka lënë kohë, por e ka qëlluar nga afër me 1 plumb në kokë duke i shkakuar vdekjen e menjëhershme. Në atentat kanë marrë pjesë dy persona, të cilët fillimisht kanë ecur në këmbë dhe më



Biznesmeni i vrarë, Memli Begalla



Pallati ku banonte viktima

Mediat italiane: Ngjarja, në dhjetor të 2009-ës

Ja si e rrëmbeu të bijën biznesmeni Begalla, nuk donte që ajo të martohej me kosovarin

ITALI - Biznesmeni i ekzekutuar mbrëmjen e së mërkurës me pistoletë me selinciator në garazhin e pallatit ku jetonte në zonën e ish-'Blokut' rezultoi person me precedent penali në Itali. Sipas mediave italiane, Memli Begalla para se të ndryshonte emrin (e ka pasur Afrim Begalla) është arrestuar në dhjetor të vitin 2009 nga policia italiane në Bari, pasi ka marrë me forcë vajzën e tij (Ludmilla Begalla) nga Zvicra, duke mos e lejuar të martohej me një shtetas nga Kosova. "Pasi i kishte thënë prerë se 'nuk do martohej me kosovar', dy shtetas shqiptarë, babai dhe vëllai (Lili Begalla) i 27-vjeçarës që pritej të bëhej nuse, e kanë detyruar me forcë të hipë në makinë dhe nga një qytet i papërcaktuar



Vendi ku ndodhi vrasja

në Zvicër, mbërritën në Bari për të shkuar në Shqipëri", - shkruajnë mediat italiane. Ndaj biznesmenit të ekzekutuar, Memli Begalla, në atë kohë 56 vjeç dhe djallit i tij 29 vjeç u ngritën akuzat për rrëmbim të personit dhe

heqjes së lirisë, ndërsa u dërguan në burgun e Barit. Vajza e tij 27-vjeçare u dërgua sërisht në Zvicër, ku punon në një agjenci udhëtimi. Mësohet se vajza ishte mbajtur pa dëshirën e saj për të paktën tri ditë.

DJEMTË E VIKTIMËS

Për zbardhjen e ngjarjes së ndodhur në ish-"Blok", grupi hetimor po heton dhe për ndonjë konflikt të mundshëm të dy djemve të viktimit me persona të tjerë për trafik droge brenda dhe jashtë vendit. Kjo, pavarësisht se ata kanë deklaruar gjatë marrjes në pyetje se nuk kishin konflikte me askënd.

pas janë larguar me një "BMW" me ngjyrë të zezë. Njëri prej atentatorëve e ka pritur 64-vjeçarin të sheshi i pallatit që nuk ka ndriçim, ndërsa personi tjetër dyshohet se ka qëndruar pak meta më tutje. Dy kamera sigurie kanë filluar momentin kur janë larguar autorët. Nga të dhënat e policisë, personi që kreu vrasjen është i ve-

shur me një xhup, në kokë mban kapele, ndërkohe që në duar ka edhe dorashka. Ndërsa, përsa i përket motivit të krimit, policia ka deklaruar se biznesmeni u vra për shkak të borxheve të shumta. Nga verifikimet e bëra ka rezultuar se ai u merrte personave të ndryshëm shuma 50 mijë euro borxh për investime. Me disa prej të

cilëve ishte ende në procese gjyqësore. Ky mund të cilësohet edhe si krim i paralizimëruar, pasi rreth 3 vite me parë, Begallës në po të njëjtin vend ku u ekzekutua iu dogj qëllimisht automjeti i tij "Land Rover" që kishte në përdorim.

BANORËT

Fqinjët e biznesmenit të vrarë dje thanë për "News

Begalla u arrestua në '98-ën, iu gjetën 5000 dollarë falsë

TIRANË - Emri i Memli Begallës, që më parë mbante emrin Afrim Begalla, nuk ka qenë i panjohur për policinë, pasi është përfshirë në disa ngjarje. Mësohet se më 21 dhjetor të vitit 1998, Begalla, në atë kohë 45 vjeç është arrestuar pasi tentoi të tregonte dollarë falsë. Viktima, ndonëse nga Tepelena, kishte jetuar për shumë vite në Sarandë, ndërsa për këtë vepër i kap në Tiranë. Forcat policore të antikrimit ekonomik-financiar të asaj kohe arrestuan në tregun e valutës Begallën me 5050 dollarë falsë, që kishin të njëjtë numra serie. Gjatë kohës që ai qëndronte në burg, një tjetër akuzë rëndoi ndaj tij, ajo e kontrabandës.

Zbardhet vendimi i gjykatës, 64-vjeçari u padit për borxh

TIRANË - Pas vrasjes së biznesmenit 64-vjeçar, është zbardhur e kaluara e tij. "News 24" ka siguruar vendimin e Gjykatës së Apelit Tiranë, e cila mban datën 18.12.2009, ku biznesmeni i vrarë me armë me selinciator Memli Begalla (Afrim Begalla) është paditur nga Floresha Selmani, pasi nuk i është kthyer borxhi në vlerën 451,543.00 lekë dhe 54,013.40 euro, duke i shtuar dhe kamatat e arrira. "Kërkojmë sqarim dhe interpretim vendimi gjyqësor nr.10673, datë 18.12.2009 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, i cili nuk është ekzekutuar duke interpretuar që: Detyrimin e palës së paditur Shoqërisë 'Lab' sh.p.k., përfaqësuar nga administratori Afrim Begalla, t'i kthejë palës paditëse Floresha Selmani shumën e marrë hua së bashku me kamatat e arrira (të llogaritura si interesa bankare) në masën 451, 543.00 lekë dhe 54, 013.40 euro, duke i shtuar edhe kamatat e arrira (si interesa bankare) nga data 03.04.2009 deri në datën e ekzekutimit të vendimit gjyqësor", - thuhet në objektin e gjykimit nga Gjykata e Apelit Tiranë, e cila ka lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së Tiranës.

24" se 64-vjeçari nuk njihet si person problematik. Selami Maho u shpreh se ai ishte njeri i mirë dhe për herë të fundit e ka parë të mërkurën teksa rregullonte makinën. "Për herë të fundit e pashë dje Memli Begallin, po rregullonte makinën poshtë ballkonit tim. Ishte prind i dy djemve dhe familjar i rregullt. Nuk dëg-

jova krisma kur ndodhi ngjarja. Vrasjen e mësova kur erdhi policia dhe rrethoi oborrin. Nuk dëgjova as ndonjë zënkë në oborr", - pohoi fqinji i biznesmenit të ekzekutuar. Mësohet se biznesmeni lëvizte me një makinë të thjeshtë tip "Renault" me targa AA462NN dhe u vra në parkingun e pallatit ku jetonte.

ATENTATORËT

Pas kryerjes së veprimeve paraprake hetimore, burimet e mësipërme pohuan se në vrasjen e Memli Begallës kanë marrë pjesë dy persona, të cilët dyshohen të jenë vrasës me pagesë. Dy agresorët, pas krimit janë larguar nga vendi i ngjarjes me një makinë tip "BMW" me ngjyrë të zezë. Ndërkaq, burimet në fjalë thanë se pista kryesore e hetimeve është ajo e borxheve.

I akuzuari Sadein Sula dyshonte se fëmija ishte i tij

Dalin audio-përgjimet para vrasjes së Suela Sulës, bashkëshorti-punëtorit: Bëj magji gruas të më bindet

TIRANË - Dy vjet pas vrasjes së 38-vjeçares Suela Sulanë në një mobilieri në fshatin Melgushë të Shkodrës, janë zbardhur detaje të reja në lidhje me këtë ngjarje, për të cilën ka përfunduar në pranga bashkëshorti, Sadein Sula dhe punëtori i mobilierisë, Fatjon Karmeshtna. Dje në seancën gjyqësore të zhvilluar në Gjykatën e Krimeve të Rënda, prokurori i çështjes paraqiti 5 regjistrime audio të kryera nga viktimë në shtator të vitit 2015, të cilat janë transmetuar për herë

ARRESTIMI I VRASËSIT

Në janar të këtij viti, policia e Shkodrës vuri në pranga Fatjon Karmeshtnan, i cili akuzohet për vrasjen e Suela Sula. Ngjarje kjo e ndodhur më 18 prill të vitit 2016 në një mobilieri, në fshatin Melgushë të Shkodrës. Sipas bluve, 35-vjeçari u "tradhtua" pas analizës së AND-së. Mësohet se në qafën e viktimës u gjetën gjurmët e gishtave të tij. Po të njëjtat burime thanë se Karmeshtna e vrau Suela Sulën me porosi të burrit të saj.

të parë. Mësohet se i pandehuri Sadein Sula i dëgjoi i heshtur këto biseda të regjistruara nga bashkëshortja. Ndërkohë që në përgjimet audio dëgjohej debati mes çiftit Sula në ambientet e mo-

bilierisë. Sadein Sula e akuzonte Suelën se djalin e tretë nuk e kishte me të. Fill pas këtij debati, Suela shpërthen ndaj burrit të saj, ndërsa i kërkon atij që të shkojnë në gjykatë për të vërtetuar nëse



Bashkëshortët Suela dhe Sadein Sula

fëmija ishte i tij apo jo. Madje në audio dëgjohej edhe se gruaja i kërkon ndarjen. Pasi u zunë, Sadeini i merr telefonin bashkëshortes dhe e fut në xhepin e xhakëtës së tij, ndërsa nuk ishte në dijeni që regjistrohej. Për 11 orë me radhë telefoni ka regjistruar biseda që komprometojnë të pandehurin se ka urdhëruar vrasjen e gruas së tij, ngjarje që ndodhi në Shkodër. Gjithashtu, në audio

dëgjohej dhe një bisedë që Sadeini ka bërë me një person me emrin Fatjon Karmeshtna, i cili dyshohet si ekzekutor i Suela Sulës. Teksa i ankohej për faktin se gruaja nuk i nënshtrohej, Karmeshtna i thotë Sadeinit se këtë punë do ta rregullonte ai. Fatjoni i tha se "do ta nënshtroj gruan tënde duke i bërë magji". Ai i kërkon para në këmbim që gruaja t'i nënshtrohej.

Përfundon në pranga dhe një 38-vjeçar nga Lushnja. Nën hetim dhe 19 të tjerë

Shkatërrohet grupi kriminal, trafikonte kokainë nga Holanda dhe Spanja

Operacioni antidrogë në 3 shtete, arrestohen 12 persona

TIRANË
Një operacion ndërko mbëtar i kryer nga policia italiane, spanjolle dhe shqiptare ka çuar dje në arrestimin e 12 personave të përfshirë në trafikun e kokainës dhe hashashit. Burime zyrtare nga Policia e Shtetit bënë me dije se në bashkëpunim me policinë italiane dhe karabinierinë e Kompanisë Roma Centro, kanë bërë të mundur shkatërrimin e një grupi kriminal. Sipas policisë grupi kriminal i përbërë nga shqiptarë dhe italianë trafikonin lëndë narkotike të llojit kokainë e importuar nga Spanja dhe Holanda dhe më pas tregtohej në të zonat e Lacios dhe Pulias. Mësohet se gjatë operacionit të koduar "NADIR" ka rënë në pranga një 38-vjeçar nga Lushnja, mbi të cilin rëndon akuza për trafikim të lëndëve narkotike. Gjithashtu, gjatë kontrollit të ushtruar nga policia janë sekuestruar 4 kg kokainë e pastër, 1 kg hashash dhe 36 mijë euro 'cash'.

OPERACIONI ANTIDROGË

Policia e Shtetit në bashkëpunim dhe në koordinim të plotë me policinë italiane Zyrrën Interforcë, prezente në Shqipëri dhe me kolegët e Karabinierisë në Romë, nëpërmjet kanaleve të komunikimit të drejtpërdrejtë të dy policive ka bërë të mundur që në shtetin italian të lëshohen urdhër arrestet ndaj 11 personave, 8 prej të cilëve në burg dhe tre në arrest shtëpie me akuza të trafikut të lëndëve narkotike. Gjatë këtij operacioni janë sekuestruar 4 kg kokainë e pastër, 1 kg hashash dhe 36 mijë euro 'cash'. Ky grup kriminal trafikonte sasi të konsiderueshme kokaine të pastër, e cila transportohej nga korrierë të përgjeshmë, mes të cilëve të rinj pa precedentë penalë. Droga më pas tregtohej në

4

KG KOKAINË
Gjatë operacionit të koduar "NADIR" janë sekuestruar 4 kg kokainë e pastër, 1 kg hashash dhe 36 mijë euro 'cash'. Ky grup kriminal trafikonte sasi të konsiderueshme kokaine të pastër, e cila transportohej nga korrierë të përgjeshmë, mes të cilëve të rinj pa precedentë penalë.



Konferenca për shtyp e drejtuesëve të policisë për operacionin

zonat e Romës, Frozinones e në Foxha. Hetimi i përbashkët ka bërë të mundur të ndiqen penalisht 31 persona prej të cilëve 12 janë arrestuar në flagrancë. Në orët e para të mëngjesit të djeshëm është bërë i mundur arrestimi

njëkohësisht në Itali i 6 shtetasve shqiptarë, 1 italian dhe 1 rumune rezident në Itali dhe në Shqipëri i një shtetasi shqiptar Mario Ç., 38 vjeç, nga Lushnja me akuzën e pjesëmarrjes në organizatë kriminale dhe trafikim të

lëndëve narkotike. Dy organizatat policore janë duke punuar intensivisht për kapjen e elementëve të tjerë të përfshirë në trafik dhe për shkak të sekretit hetimor nuk bëhen me dije të tjera informacione. Policia e Shtetit

është e angazhuar maksimalisht në goditjen e grupeve kriminale si brenda ashtu edhe jashtë vendit duke u mbështetur nga partnerët e saj dhe duke dhënë siguri në një bashkëpunim të besueshëm dhe të suksesshëm.


TIRANË - "Javën e ardhshme do të ketë një sërë arrestimesh". Deklarata e fortë është bërë nga ministri i Brendshëm, Fatmir Xhafaj. I ftuar në emisionin "Opinion", ai tha se në vendin tonë janë rreth 40 grupe kriminale, që operojnë në fusha të ndryshme kriminale. Xhafaj deklaroi se duke nisur nga java e ardhshme do të ketë arrestime, që lidhen me grabitjen dhe tjetërsimin e pronave publike në vend. "Prokuroria e Përgjithshme ka përfunduar një sërë hetimesh dhe javën që vjen do të nisim gjyqet për disa persona. Kemi

Ministri Fatmir Xhafaj: Kryebashkiaku i Elbasanit është kërcënuar, ruhet nga policia



disa çështje penale, në bashkëpunim me prokurorinë në rrethet Kavajë, Durrës, si dhe ka një proces hetimi në Lezhë, por do ta shtrijmë në Vlorë dhe në të gjithë vijën bregdetare", deklaroi ministri. Xhafaj sqaroi se është hartuar një raport studimor, i cili ka realizuar profilin e këtyre grupeve kriminale, veprimtarinë e tyre, numrin e pjesëmarrësve, si dhe një

hartë të veprimtarisë së kriminit të organizuar në Shqipëri. Sipas tij, grupi më i madh ka rreth 20 anëtarë. Gjithashtu, ministri i Brendshëm ka deklaruar se kryebashkiaku i Elbasanit, Qazim Sejdimi mbrohet nga Policia e Shtetit, pasi është kërcënuar. "Qazim Sejdimi ka një nivel mbrojtjeje, për shkak të një kërcënimi që ka pasur një moment të caktuar", pohoi Xhafaj.



Vrasja e Devi Kasmit, Apeli lë në burg Mario Meshinin

TIRANË - Gjykata e Apelit dje la në burg Mario Meshinin, i cili dyshohet se nxori në pritë Devi Kasmin që u ekzekutua në një atentat mafioz më 29 janar të këtij viti, në rrugën "Petro Cani" në Tiranë. Avokati i Meshinit apeloj vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë për të lënë të lirë klientin e tij, me argumentin se nuk ka lidhje me ngjarjen, pasi viktimën e kishte mik prej disa kohësh. Por, Apeli nuk pranoi këtë kërkesë dhe la në fuqi masën e sigurisë "arrest me burg" për 25-vjeçarin Meshini. Ky i fundit i kishte dërguar mesazh në celular Devi Kasmit për t'u takuar poshtë pallatit ku banonte viktimë. Meshini ka thënë para hetuesve se në momentin që mbërriti me motor poshtë pallatit të Kasmit, aty ishin edhe vrasësit, të cilët qëlluan për vdekje 41-vjeçarin. Dëshmia e tij nuk e ka bindur prokurorinë, e cila ka dyshime se Mario Meshini ka nxjerrë në pritë viktimën. Në fillim të shkurtit, policia e Tiranës arrestoi ish-policin grek Efthimios Efthimi, si vrasësi me pagësë i Kasmit, si dhe tre bashkëpunëtorë të tij Elton Halipaj, Malvin Dinellari dhe Elton Hoxhallarin. Ndërsa Aurel Hoxhallari është në kërkim si organizatori dhe porositësi i atentatit

KURBIN

Maskat grabisin pronarin e restorantit në Patok

Dy persona të maskuar dhe të armatosur sulmuan në orët e vona të së mërkurës një tregtar në Patok të Kurbinut. Seit Sistani po mbyllte restorantin e tij në lagunën e Patokut, kur dy grabitësit i drejtuan armën. I gjendur në rrethana të tilla, pronari i lokalit "Gersi" u detyrua t'u dorëzojë agresorëve 500 mijë lekë të reja. Pas sinjalizimit për grabitjen, policia shkoj menjëherë në vendngjarje dhe nisi hetimet. Vetë biznesmeni deklaroi se ai nuk ka mundur t'i njohë personat që e sulmuan, për shkak të errësirës. Disa persona, banorë të zonës, u shoqëruan si të dyshuar në komisariat, por pa arritur të vënë në pranga autorët e ngjarjes.

Djali i ish-kryeministrit: Kam dokumente nga tatimet, kam paguar taksa

"CEZ-DIA", Balla e Berisha përplasen te Krimet e Rënda

Deputeti i PS: Shkëlzeni ka miliona pa punuar asnjë ditë

Cështja CEZ-DIA ka përplasur në Gjykatën e Krimeve të Rënda djalin e ish-kryeministrit Sali Berisha dhe deputetin e PS-së, Taulant Balla. Ky i fundit ngriti akuzë mbi Shkëlzen Berishën si i përfshirë në skandal. Kreu i grupit parlamentar socialist është paditur për shpifje nga djali i ish-kryeministrit, lidhur me provat e publikuara nga komisioni hetimor parlamentar për çështjen "CEZ". Seanca gjyqësore është shoqëruar edhe me debate mes Ballës e Berishës, pasi deputeti socialist i kërkoi trupit gjyqës të ketë nën vëmendje faktin që Shkëlzen Berisha është duke u hetuar nga prokuroria e Tiranës, gjë që është mohuar nga djali i ish-kryeministrit. "Jam këtu për të vendosur drejtësi. Gjykata iu përgjigj kërkesës së prokurorit dhe ia kthen sërish Gjykatës së Lartë. Kjo është frikë për të vendosur drejtësi. Gjykata e Lartë është institucioni më i lartë dhe një kryeprokurore, dhe gjykatës që ka frikë mund të kthejë sërish në Gjykatën e Lartë. Balla e ka një damkë si shpifës, dua që të marrë një përgjigje ligjore", tha Shkëlzen Berisha, duke shtuar se nuk ka asnjë lidhje me



Deputeti i PS-së, Taulant Balla

privatizimin e CEZ e që taksa i ka paguar. "Taulant Balla ka thënë që unë nuk kam paguar asnjë takse, unë dua transparencë, kam dokumente nga tatimet, kam paguar taksa. Balla është i vetmi kryetar grupi që nuk zbaton vendimin e Apelit si shpifës, fshihet pas Ramës dhe nuk paguan detyrimin. Nëse ky vend do të kishte prokurori, Balla do të ishte proceduar", shtoi Berisha. Ndërkaq, Taulant

Balla tha se nuk do të shprehet në lidhje me dosjen "CEZ". "Kjo dosje, me vendim të Kuvendit të Shqipërisë me 74 vota pro, sot është një prej dosjeve që po hetohet në prokurori. Personi i cili është kallëzuar nga Kuvendi i Shqipërisë për veprën penale të korupsionit dhe vepra të tjera penale së bashku me babanë e tij, me zyrtarë të lartë, tha se nuk ishte në dijeni që kjo çështje ishte nën hetim; pavarë-

sisht se nga ju kemi marrë vesh që ky person është paraqitur në prokurori për t'u pyetur për këtë çështje dhe të gjithë e dimë që kjo është një çështje që duhet hetuar", sgaroi Balla duke i bërë thirrje prokurorisë ta hetojë këtë dosje me seriozitetin më të madh. Balla shtoi se, "Nuel Nik Kalaj duhet të gjendet dhe të merret në pyetje nga prokuroria, sepse ditën për diell ka tërhequr 6.8 milionë euro".



Shkëlzen Berisha

AKUZA

Balla akuzon Shkëlzen Berishën se nuk ka punuar asnjë ditë dhe pasurinë e ka vendosur si sekser, ndërsa ka përfituar 350 mijë euro vetëm duke firmosur si komisione dhe se nuk ka paguar asnjë takse në shtet për tri vite. Por, Shkëlzen Berisha mohon akuzat duke deklaruar se ka të gjitha dokumentet nga organet se i ka paguar taksat. "Ky njeri nuk i ka thënë një herë 'mirëmangjesi' punës, të çohet në orën 7:00 të mëngjesit, në orën 8:00 të jetë në punë dhe në orën 6:00 pasditë të kthehet nga puna. Një njeri që nuk ka firmosur një herë në një vend pune, por që të vetmet të ardhura i ka të deklaruar si komisione të tipit 'merija këtij e dërgoja atij'", u shpreh Balla.

Prindërit e Aldo Ymerajt në Gjykatën e Fierit: Na lini ta takojmë

Vodhën 530 milionë dollarë, gjeniu i kibernetikës do të ekstradohet në SHBA

Gjeniu i kibernetikës, 24-vjeçar nga Fieri, do të ekstradohet në Amerikë. Aldo Ymeraj është lënë në burg nga Gjykata e Fierit deri sa të kryhen procedurat. Ai u arrestua pak ditë më parë në Tiranë me urdhër të FBI-së, pasi akuzohet për krime kibernetike. Familjarët e 24-vjeçarit, të cilët ndodheshin jashtë godinës së gjykatës kanë kërkuar që ta takojnë për herë të fundit djalin. "E dimë fatin e tij, do ta çojnë në Amerikë për ta gjykuar. Duam ta takojmë për herë të fundit, se nuk i dihet e takojmë më apo jo", - u shprehën ata pak para vendimit. Aldo Ymeraj bënte pjesë në rrjetin "In fraud we trust" (Në mashtrim besojmë) dhe njëjhe me epitetin "Kubanezi". Ky grup prej 36 vetash kanë mundur të vjedhin 530 milionë dollarë, që përvetësoheshin përmes shitjes së të



Aldo Ymeraj

dhënave të vjedhura të kartave të kreditit. Gjatë arrestimit dhe marrjes në pyetje, ai nuk ka thënë asgjë mbi veprimtarinë apo rolin e tij në këtë grup. Përveç Ymerajt, janë edhe 12 të tjerë të arrestuar në Kosovë, Serbi, Itali, Francë, Shtetet e Bashkuara, Australi dhe Britani. Grupi mundohet se është themeluar nga 34-vjeçari ukrainas, Svatoslav Bondareko, i njohur me nofkën "Rektori", por vendndodhja e

tij nuk është zbuluar ende. Nga ana tjetër, rusi Sergej Sergejeviç që mendohet se është njëri nga bashkëpunëtorët e tij më të ngushtë u arrestua gjatë pushimeve në Tajlandë. Emri i Aldo Ymerajt u bë i njohur për policinë vendëse gjatë goditjes së grupit AHG, "Albania Hackers Group", i cili solli jo pak shqetësim në bllokimin e serverave të institucioneve shtetërore dhe mjaft shoqërive private.

Veliu: Lufta kundër krimit ka hyrë në një epokë të re

Ndryshimet në Policinë e Shtetit, dy femra marrin në dorë drejtorinë

Zgjedhja e Ardi Veliu të krye të Policisë së Shtetit ka sjellë ndryshimet e ditura të drejtuesve. Në vend të tij u vendos Kastriot Skënderi për të drejtuar qarkun e Tiranës, ndërsa në detyrën e tij të mëparshme si drejtor i Kufirit, Enkelejda Tosku. Po ashtu, ndryshime janë bërë edhe në strukturën e Policisë së Shtetit. Rebani Jaupi është larguar nga posti i zëvendës drejtorit dhe vendin e tij e zuri Aida Hajna, e cila më parë mbante detyrën e drejtoreshës për Kufirin dhe Migracionin. Në vend të saj në krye të Kufirit ka shkuar Shaban Nexhi. Po ashtu, është zëvendësuar edhe drejtori i Departamentit për Rëndinë dhe Sigurinë, është larguar Altin Qato dhe në

krye të Rëndisë është emëruar Gjovalin Loka, i cili mbante detyrën e drejtorit të Policisë së Shkodrës. Altin Qato emërohet drejtor i Policisë së Elbasanit. Drejtori i Policisë së Lezhës, Bledar Çeliku emërohet drejtor i Njësisë së Task Forcës. Ndërkaq, Ardi Veliu drejtor i përgjithshëm

i Policisë së Shtetit, në ceremoninë e "PAMECA V" tha se lufta kundër krimit ka hyrë në një epokë të re. "Inkurajoj çdo nismë dhe iniciativë që i shërben qëllimit tonë të përbashkët. Jam besimplotë në arritjen e këtyre qëllimeve", tha drejtori i Policisë së Shtetit, Ardi Veliu.

EMËRIMET NË POLICI

- AIDA HANAJ, nëndrejtoreshë e Policisë së Shtetit
- KASTRIOT SKËNDERI, drejtor i Policisë së Tiranës
- REBANI JAUPI drejtor i Menaxhimit të të Dhënave në Policinë e Shtetit
- ALTIN QATO, drejtor i Policisë Elbasan
- ENKELEJDA TOSKU, drejtoreshë e Kufirit dhe Emigracionit në Tiranë
- BLENDAR ÇELIKU, drejtor i Njësisë së Task Forcës
- SHABAN NEXHI, drejtor i Kufirit dhe Migracionit

NJOFTIM ANKANDI

Përmbasues gjyqësor privat Artan Sima zhvillon ankandet sipas datave të mëposhtme:
 1)Data 16/03/2018, ditën e Premte, ora 16:00, përfundon ankandi i ri (i dytë), për shënjjen e pasurive të pallogjishme të ligjit.
 -Ara' me sip. 2506 m2, e ndodhur në fshatin Vashtrimi Korçë, në vlerën 210,504 leke.
 -Ara' me sip. 1216 m2, e ndodhur në fshatin Vashtrimi Korçë, në vlerën 102,144 leke.
 -Ara' me sip. 1080 m2, e ndodhur në fshatin Vashtrimi Korçë, në vlerën 121,464 leke.
 -Tiruar' ara' me sip. 352 m2, nga kjo truall 200 m2, si dhe ndërtesë prej 80 m2, e ndodhur në fshatin Vashtrimi Korçë, në vlerën 1,456,504 leke.
 Pasuritë janë lene garanci bankare nga debitori Trashëgimtarëve të të ndjerit/ Debitor z. Aligent Mirir Panajoli, znj. Manjola Rexhep Panajoli, znj. Sara Aligent Panajoli, z. Glediol Aligent Panajoli banues në fshatin Vashtrimi, bashkia Malq, rrethi Korçë, për detyrimin ndaj kreditorit Fondi Besa Sh.a, me seli në ish Blloku Tiranë.
 2) Data 16/03/2018, ditën e Premte, ora 16:00, përfundon ankandi i ri (i dytë), për shënjjen e pasurive të pallogjishme të ligjit.
 -Ara' me sip. 1489 m2, e ndodhur në fshatin Zagradec Devoll, në vlerën 87,430 leke.

-Ara' me sip. 1489 m2, e ndodhur në fshatin Zagradec Devoll, në vlerën 107,520 leke.
 Pasuritë janë lene garanci bankare nga debitori Trashëgimtarëve të të ndjerit/ Debitor z. Xhevdar Zama dhe Nexhmije Zama, z. Aurel Zama, z. Sokol Zama, z. Melsi Zama, banues në fshatin Zagradec, bashkia Dibër, për detyrimin ndaj kreditorit Fondi Besa Sh.a, me seli në ish Blloku Tiranë.
 3) Data 15/03/2018, ditën e Enjte, ora 16:00, përfundon ankandi i ri (tretë), për shënjjen e pasurive të pallogjishme të ligjit Ara' me sip. 1.000 m2, truall 190 m2, nga kjo ndërtesë 81 m2 e ndodhur në fshatin Zdojan, Dibër në vlerën 100.800 leke. Pasuria është lene garanci bankare nga (debitorë/hipotekues) z. Bedri Allaman Tuka, banues në fshatin Zdojan-Brezhan, bashkia Dibër, rrethi Dibër, për detyrimin ndaj kreditorit Fondi Besa Sh.a, me seli në ish Blloku Tiranë.
 4) Data 02/03/2018, ditën e Enjte, ora 16:00, përfundon ankandi i ri (i parë), për shënjjen e pasurive të pallogjishme të ligjit.
 -Ara' me sip. 7400 m2, e ndodhur në fshatin Bllinçe Devoll, në vlerën 592,000 leke.
 Pasuritë janë lene garanci bankare nga debitori Trashëgimtarëve të të ndjerit/ Debitor z. Bukurije Sulejman Fezo, znj. Mirza Fezaj (Foto) Fezo, z. Xhimi Foto Fezo, znj. Arkonda Foti Fezo, znj. Elveta Foti Fezo, znj. Luiza Foti (Kasabelli) Fezo banues në fshatin Bllinçe, bashkia Devoll, për detyrimin ndaj kreditorit Fondi Besa Sh.a, me seli në ish Blloku Tiranë.
 Ankandët zhvillohen pranë zyrës së përmbasuesit me seli lagjen nr.3, Rruga e Avni Rustem, nr.31, k.1, Korçë. Kontakti Cet067404466, e-mail: simaartan@yahoo.com

Shefja e Onkohematologjisë në QSUT: Pacientët nuk duhet të detyrohen të blejnë ilaçe



Voltiza Duro

Mungesa e medikamenteve për trajtimin e fëmijëve me sëmundje tumorale vazhdon të mbetet një problem i mprehtë në Shërbimin e Onkohematologjisë në QSUT. Mesatarisht në një vit ka rreth 30 raste të reja me leucemi akute si dhe 40-50 raste me tumore të ngurta që shfaqen të vogëlshëm. Në një intervistë ekskluzive për "Gazeta Shqiptare", Prof. Anila Godo, shefe e Departamentit të Pediatriisë e njëkohësisht shefe e Shërbimit të Onkohematologjisë në QSUT tregon se duhet të gjenden mënyrat e duhura që asnjë pacient i shtruar në spital të mos detyrohet të blejë privatisht medikamentet. Më tej, Godo bën me dije se shëndeti i fëmijëve të prekur nga sëmundjet tumorale është mjaft i cenuar, si për shkak të vetë sëmundjes, por edhe për shkak të kimioterapisë, radioterapisë, e ndërhyrjeve kirurgjikale që komplikojnë edhe më tej gjendjen shëndetësore.

Sa është numri i fëmijëve të prekur nga sëmundjet tumorale në vendin tonë?

Lidhur me numrin e fëmijëve të prekur me neoplazi në vendin tonë kemi shifra të tilla mesatarisht në një vit: rreth 25 deri 30 raste të reja me leucemi akute që është edhe kanceri më i shpeshtë të fëmijët. Gjithashtu, konstatohen në një vit rreth 40 deri në 50 raste të reja me tumore të quajtura të ngurta, pra jo të gjakut si leucemite. Shërbimi i Onkohematologjisë pediatrike është i vetmi i këtij lloji në vend, pra shifrat që dhashë më lart janë, në fakt, kombëtare, pra kanë të bëjnë me pacientët e ardhur nga tërë rrethet.

Si paraqitet gjendja e tyre shëndetësore?

Dua të theksoj se një drejtim tjetër ku janë të përqendruara studimet shkencore në botë është perfeksionimi i strategjive terapeutike, gjë që ka rritur mjaft mbijetesën e këtij kontingjenti. Unë, për shkak të eksperiencës sime të gjatë në këtë fushë e them gjithnjë me gëzim se e kam jetuar ndryshimin e madh, shifra të mbijetesës që shkojnë gjithnjë në rritje. Sidoqoftë, gjatë gjithë kohës së terapisë, shëndeti i këtyre pacientëve është mjaft i cenuar, si për shkak të vetë sëmundjes serioze që kanë, por edhe për shkak të kimioterapisë, radioterapisë, ndërhyrjeve kirurgjikale që komplikojnë edhe më tej gjendjen shëndetësore.

Në cilin stad të sëmundjes paraqiten fëmijët e sëmurë të mjeku?

Alarmi, mungojnë ilaçet për fëmijët me kancer

Anila Godo: Rreth 80 raste të reja në vit



Prof. Anila Godo, shefe e Departamentit të Pediatriisë

gjendja shëndetësore

"Sidoqoftë, gjatë gjithë kohës së terapisë, shëndeti i këtyre pacientëve është mjaft i cenuar, si për shkak të vetë sëmundjes serioze që kanë, por edhe për shkak të kimioterapisë, radioterapisë, ndërhyrjeve kirurgjikale që komplikojnë edhe më tej gjendjen shëndetësore", - tha Godo për "GSH".



MUNGESAT E ILAÇEVE

"Gjatë vitit 2017 furnizimi ishte më i mirë se një vit më parë, por përsëri, në periudha të ndryshme, kemi pasur mungesë medikamentesh të ndryshme. Duhet gjetur rrugë që asnjë pacient i shtruar në spital të mos gjendet i detyruar të blejë privatisht medikamente, apo edhe të bëjë në struktura private ekzaminime të domosdoshme për diagnozë", - u shpreh shefja e Onkohematologjisë.

Cilat janë shkaqet e sëmundjes dhe nga cili lloj kanceri preken më shumë?

Problem e kancerit në përgjithësi si dhe të atij të moshës pediatrike në veçanti vazhdojnë të mbeten në qendër të vëmendjes shkencore. Studimet orientohen në disa drejtime: të evidentohen sa më shumë të jetë e mundur faktorët e ashtuquajturit "shpërthyes", pra që në njëfarë mënyre akuzohen

se "zgjojnë" onkogenet e ndryshëm dhe predispozicionin për shfaqjen e neoplazisë. Flitet për faktorë të akuzuar, jo dhe të konfirmuar plotësisht si shkaktarë. Është e pamundur të flitet për shkaqe direkte ndërsa duket më e drejtë të flitet për një tërësi faktorësh gjenetike apo ambientale, të cilët akuzohen si predispozues, nxitës apo shpërthyes të kancerit. Tek fëmijët, Leu-

cemia Lymfoide Akute është neoplazia më e shpeshtë. **A ka pasur vdekje dhe sa ka qenë numri i tyre?**

Përderisa flasim për patologji serioze, që përbëjnë shumë shqetësim edhe në botën e zhvilluar, është e kuptueshme që ka edhe humbje jetësh. Sidoqoftë është një numër në ulje si në botë, ashtu edhe në vendin tonë.

A ka mungesë medika-

mentesh në pediatriinë onkologjike?

Problemi i citostatikëve (medikamentet kryesore për terapinë e neoplazive) ka qenë dhe mbetet një problem i mprehtë për gjithë strukturat shëndetësore të përfshira në luftën kundër kancerit. Ka qenë e mbetet problem për zgjidhje për tërë qeveritë, pavarësisht ngjyrave. Bëhet fjalë për medikamente të shtrenjta, për të cilët nevojitet një buxhet mjaft ambicioz. Ndërkohë, ne jemi në gjendje, në përgjithësi, të aplikojmë e plotësojmë skemat evropiane të terapisë, që premtojnë shifra më të larta shërimi. Mbetet një sfidë e mprehtë. Gjatë vitit 2017 furnizimi ishte më i mirë se një vit më parë, por përsëri, në periudha të ndryshme, kemi pasur mungesë medikamentesh të ndryshme. Duhet gjetur rrugë që asnjë pacient i shtruar në spital të mos gjendet i detyruar të blejë privatisht medikamente, apo edhe të bëjë në struktura private ekzaminime të domosdoshme për diagnozë.

Si paraqiten kushtet të Pediatria Onkologjike?

Infrastrukturat e reparateve onkologjike duhet të jenë të veçanta, pasi ky kontingjent pacientësh, për shkak të patologjisë e të terapisë vuajnë nga një cenim i shprehur i imunitetit. Për këto arsye kërkohen kushte të veçanta të funksionimit të repartit që të sigurojnë higjienë deri edhe në ambiente pothuaj aseptike për pacientët me dëmtim të rëndë të imunitetit. Përveç kësaj, për shkak se këta pacientë qëndrojnë gjatë në spital, dhe për shumë arsye jo rrallë kanë edhe cenim të shëndetit mendor, është e domosdoshme të sigurohet dhe një ambient sa më i pëlqyeshëm, që ta bëjë fëmijën të ndjehet sa me i lumtur. Në këtë kontekst kuptohet se ambienti "perfekt" është vështirë të arrihet. Por është e drejtë të them që infrastruktura e repartit tonë ka ndryshuar mjaft për mirë në vite, në të dy drejtimet e mësipërme. Por, ka vend për ndërhyrje drejt një standardi më të lartë.

A gjenden të gjitha aparatat e nevojshme për trajtimin e sëmundjes?

Në shërbimin tonë realizohet kimioterapia. Na nevojiten medikamente, jo ndonjë aparaturë e veçantë. Radioterapia bën pjesë në skemat e terapisë së disa llojeve tumorale. Këtë vit në këtë shërbim u vendos një aparat i ri, modern që e ngre në një standard të lartë radioterapinë e neoplazive të fëmijët.

UNIVERSITETI I TIRANËS PËRPLASJET

Mynyr Koni: Jam ndjerë nën presion, të nisin hetimet për veprimtarinë e universitetit

Dekanët e UT-së kërkojnë shkarkimin e rektorit

Kule: Ka dashur të kryejë veprime të paligjshme administrative

Voltiza Duro

Pas mbledhjes së kryeministrit Edi Rama me senatin e Universitetit të Tiranës, përplasja të forta kanë ndodhur dhe mes rektorit Mynyr Koni e 4 dekanëve të fakulteteve në këtë institucion të arsimit të lartë. Këta të fundit në datën 16 tetor 2017-të, nëpërmjet një letre, i kanë kërkuar ministres së Arsimit, Lindita Nikolla fillimin e procedurave për shkarkimin e Mynyr Konit nga posti i rektorit të UT-së. Respektivisht, kërkesa mban firmën e dekanit të Fakultetit të Ekonomisë, Dhori Kule; Fakultetit të Shkencave Sociale, Edmond Rapti; dekanit të Fakultetit të Drejtësisë, Artan Hoxha si dhe atij të Fakultetit të Gjuhëve të Huaja, Artur Sula. "Mbas përpjekjesh të shumta, diskutimesh të gjata dhe një morie të pafund shkëmbimi shkresor me Rektorin e Universitetit të Tiranës (UT), zotin Mynyr Koni, kemi arritur në përfundimin se vazhdimësia e mëtejshme e tij në detyrë është në dëm të interesave të zhvillimit të Universitetit të Tiranës. Në këto 17 muaj të administrimit të Universitetit, kemi konstatuar shkelje të rënda dhe të vazhdueshme ligjore në veprimtarinë e Rektorit të Universitetit, të cilat kanë krijuar një situatë të rëndë paligjshmërie me efekte të drejtpërdrejta në mosfunksionimin normal të të gjitha strukturave të UT, të cilat janë të lidhura drejtpërdrejt apo indirekt me autoritetin e Rektorit të Universitetit", citohet në letrën e 4 dekanëve të UT-së. Ndërkaq, ditën e djeshme këta të fundit kanë dalë në një deklaratë për mediat ku kanë theksuar se Koni ka firmosur kontrata tenderësh që nuk i përkisnin. "Rektori Koni është përpjekur të kryejë në mënyrë të paligjshme funksione administrative. Një situatë shqetësuese firmos kontrata tenderësh, gjë që ja kemi bërë prezent që nuk janë tuajat. Këtë prezencë e kanë verifikuar edhe organet përkatëse", tha dekanit të Fakultetit të Ekonomisë, Dhori Kule. Ndërkohë, vetë rektori i Universitetit të Tiranës në një deklaratë për mediat kërkojë që të nisë një hetim



Katër dekanët e UT-së në deklaratën për median

EDI RAMA: PRERJA E KOKAVE, KËRKESË E DEKANËVE

"Prerjen e kokave e kërkon dekanati. Janë 4 dekanë me në krye Dhori Kule që i janë drejtuar me letër ministres së Arsimit qysh prej disa muajsh duke i kërkuar shkarkimin e rektorit të Universitetit dhe duke e shoqëruar kërkesën me dokumentacion që sipas tyre provon shkelje të ligjit abuzime etj. Kanë përfunduar edhe në gjykatë ata, e dini apo jo. Kanë fituar dhe gjyqe bazuar në ligj dhe ajo që ne kemi bërë ka qenë e kundërta për t'i dhënë kohë që të adaptohen me ligjin e ri dhe të vetëadministrohen.", - tha Rama.

“
Përplasja të forta kanë ndodhur dhe mes rektorit Mynyr Koni e 4 dekanëve të fakulteteve në këtë institucion të arsimit të lartë.

VENDIMI



Anulohet leja mjedisore e HEC-eve mbi

kanionet e Osunit

Lejet mjedisore për Lëndëtimin e dy HEC-eve mbi kanionet e Osunit janë shpallur të pavlefshme nga Ministria e Mjedisit, duke hedhur poshtë vendimin që rrezikonte këtë pasuri natyrore. Ditën e djeshme, pas konstatimit të shkeljeve në kontratë, është bërë anulimi i vendimit nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit, e cila bëri me dije se leja e mëparshme është e pavlefshme, pasi i ka tejkaluar afati. Edhe disa ditë më parë, Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama si dhe ministri i Turizmit e Mjedisit, Blendi Klosi deklaruan se nuk do e lejonin ndërtimin e hidrocentraleve në kanionet e Osunit. Pas anulimit të lejes mjedisore, i takon Ministrisë së Energjetikës të anulojë marrëveshjen koncesionare për projektin e dy HEC-eve, pasi ministri Gjinnuri deklaroi gjithashtu se do ta anulonte marrëveshjen, nëse Agjencia e Mjedisit anulonte lejen. Tashmë pritet vendimi që do të marrë kjo ministri. Ndërkaq, koncesioni për ndërtimin e dy hidrocentraleve mbi lumin Osun është dhënë në prill të vitit 2013, ku përmes falsifikimit të dokumenteve dhe procedurave të jashtëligjshme, u planifikua ndërtimi i dy hidrocentraleve mbi kanione, të cilët sipas ekspertëve, do të shkatërronin përfundimisht këtë pasuri të Shqipërisë.

ILIR META: LARG KOMUNIKIMIT ARROGANT

"Ne e dimë që arsimit të lartë ndeshet me sfida të vështira, me vështirësi dhe sfida dhe për zbatimin e ligjit të arsimit të lartë. Por jam i bindur që të gjitha këto zgjidhen përmes një reflektimi pozitiv nga të gjithë aktorët, larg çdo komunikimi arrogant, i cili nuk na ndihmon për të konsoliduar reformat dhe për të përmirësuar impaktin e tyre në shoqëri, aq më tepër tek të rinjtë dhe fëmijët tanë. Ligji ende sot e kësaj dite nuk ka gjetur zbatim për shkak të mungesës së shumë akteve nënligjore që e bëjnë atë të paimplementueshëm", - tha Meta.

MYNYR KONI: HETIM UNIVERSITETIT QË NGA 2008-ta

"Kam bërë denoncime, dosjet flenë në prokurori, ky bllokim nuk është rastësor, janë përfshirë individë të caktuar, ish-drejtuari i bordit, ish-kancelari. Jam ndjerë në presion institucional nga struktura të ndryshme, nga inspektimet e MASR në 2017, ka arritur deri aty sa edhe Ministria e Financave ka marrë përsipër të interpretojë ligjin e ri, duke pranuar veprime financiare pa vullën e universitetit dhe të firmosur nga persona të larguar nga puna, është lajmëruar thesari dhe ministria dhe situata vazhdon", - tha rektori Koni.

DHORI KULE: KONI FIRMOSI TENDERË TË PALIGJSHËM

"Rektori Koni është përpjekur të kryejë në mënyrë të paligjshme funksione administrative. Një situatë shqetësuese, firmos kontrata tenderësh, gjë që ja kemi bërë prezent që nuk janë tuajat. Këtë prezencë e kanë verifikuar edhe organet përkatëse. Ministria e Financave nuk ka aktet dhe kontratat që ai ka firmosur, sepse janë të paligjshme me firmën e tij. Është krijuar një ngërcë institucionale, i cili zgjidhet jo duke i kërkuar ndihmë debateve politike. I jemi drejtuar ministres së Arsimit të nisë procedurat e shkarkimit.", - tha Kule.

mbi veprimtarinë e UT-së për këto 10 vitet e fundit. "Kam bërë denoncime, dosjet flenë në prokurori, ky bllokim nuk është rastësor, janë përfshirë individë të caktuar, ish-drejtuari i bordit, ish-kancelari. Jam ndjerë në presion institucional nga struktura të ndryshme", u shpreh Koni.

REAGIMET

Kryeministri i vendit, Edi Rama tha se ligji i arsimit të lartë nuk është shkaktari i ngërçit të krijuar në Universitetin e Tiranës. Sipas kreut të ekzekutivit janë vetë dekanët ata që kërkojnë "prerjen e kokave" pra shkarkimin e rektorit Mynyr Koni. "Prerjen e kokave e kërkon dekanati. Kanë përfunduar edhe në

gjykatë ata, e dini apo jo. Kanë fituar dhe gjyqe bazuar në ligj dhe ajo që ne kemi bërë ka qenë e kundërta, për t'i dhënë kohë që të adaptohen me ligjin e ri dhe të vetëadministrohen", theksoi Rama nga foltorja e Kuvendit. Edhe presidenti i Republikës, Ilir Meta ka reaguar në lidhje me mbledhjen e dy ditëve më

parë mes kryeministrit e senatit ku ka theksuar se sfidat e arsimit të lartë zgjidhen me reflektim pozitiv dhe jo me gjuhë arrogante. "Jam i bindur që të gjitha këto zgjidhen përmes një reflektimi pozitiv nga të gjithë aktorët, larg çdo komunikimi arrogant, i cili nuk na ndihmon", u shpreh Presidenti i Republikës.

DOSSIER

Gjeopolitika e kufirit greko-shqiptar sipas Departamentit të Shtetit Amerikan "Studim i kufijve ndërkombëtarë, 18 gusht 1971"

Nga Albert Hitoaliaj

Problemet e njohjes së kufirit shqiptar prej Greqisë e kanë zanafillën qysh në dekadat e para të shtetit grek, kur edhe pse nuk kishte akoma shtet shqiptar, hapësira historike e banuar prej shqiptarëve nën Perandorinë Osmane, synohej si territor prej Mbretërisë Greke së atëherëshme. Shpallja e Pavarësisë së Shqipërisë më 1912, nuk i dha fund çështjes së kufijve, pasi saga e copëtimit dhe marrjes së territoreve shqiptare, e pa finalen pas demarkacionit final nga Komisioni Ndërkombëtar, i cili e përfundoi punën në vitet 1922-1925. Akti Final, i firmosur prej Fuqive të Mëdha dhe Greqisë e Jugosllavisë në 1926, përcaktoi kufijtë që ka sot Republika e Shqipërisë. Akoma sot e kësaj dite, kufiri tokësor i firmosur edhe prej Greqisë si demarkacion, nuk njihet prej shtetit grek. Ky është mishërimi i një paradoksi: Greqia kërkon me ngulm ndërrimin e emrit të shtetit të Maqedonisë pasi mbajta e këtij emri nënkupton synime territoriale ndaj saj; Greqia kërkon që të mos përmendet emri Çamëri as në dokumente shqiptare dhe të mos trajtohet diplomatikisht "çështja çame", pasi kjo gjë përbën pretendim territorial ndaj Greqisë; Presidenti grek, Pavlopoulos, në takimin e fundit me Presidentin turk, Erdogan, pasi ky i fundit i kërkoi "riaktualizimin" e Marrëveshjes së Lozanës, u shpreh se "duhet të kemi respekt për të drejtën ndërkombëtare" (!). Mosnjohja e kufijve tokësorë shqiptarë prej Greqisë, a nuk është shkelje e së drejtës ndërkombëtare përvçese pretendim territorial? Duke e mbajtur të aktivizuar mosnjohjen e kufirit tokësor, pala greke mban të aktivizuar edhe synimin për realizimin e strategjisë së "megali idesë", dhe avancimin verior territorial nëpërmjet argumentit (fabrikuar prej shekujsh!) historik, kulturor e fetar. Varrezat e Luftës Italo-Greke mund të shihen si pjesë e saj. Mosnjohja e emrit të Maqedonisë dhe propozimi për emër sllav, lidhet edhe me një skenar ndarjeje të mundshme, të nesërme, të Maqedonisë, ku e drejta për trashëgiminë kulturore, historike, antike do t'i përkiste vetëm Greqisë, e cila, bazuar te kjo, do të kërkonte ta ngrinte vijën kufitare në brendësi të Maqedonisë aktuale. Shqiptarët, në një të nesërme të tillë, nuk do kishin më

lidhje me kulturën e Maqedonisë antike, pasi nuk u bënë pjesëtarë të këtij debati mbi emrin, edhe pse, vetëm shqiptarët mund të konsiderohen si pasardhës të vetëm të maqedonasve antikë, degë e ilirëve të lashtë.

Por, nga ana tjetër, kjo mosnjohje aktuale e kufirit shqiptar, do shërbente si precedent dhe argument në tryezën diplomatike, që edhe Turqia të mos njihje traktatet ndërkombëtare ndaj Greqisë; madje shërben edhe si argument që Maqedonia të mos e ndërrojë emrin e saj, përderisa vetë Greqia përdor termin "Vorio-Epir" përkundrejt Shqipërisë Jugore, krahinë e cila përfshinte dikur tërë Epirin. Është në interes të Greqisë që të normalizojë çështjet e diskutimeve kufitare me Shqipërinë e sidomos njohjen përfundimtare të kufirit tokësor.

e pesë deteve", ditët e sotme merr ngjyrimin e një projekti gjeopolitik me peshë të veçantë në Euro-Azi. Politika e jashtme shekullore greke duhet analizuar e lidhur me këtë sistem gjeopolitik dhe kësajsoj mund të kuptohen më mirë edhe raportet dypalëshe greko-shqiptare.

Një analizë e shkurtër gjeopolitike shfaqet edhe në dokumentin "Studim i kufijve ndërkombëtarë: Kufiri Shqipëri-Greqi, nr. 113, 18 gusht 1971" (International Boundary Study: Albania-Greece Boundary, No. 113 - August 18, 1971), i bërë nga Byroja e Inteligjencës dhe Kërkimit Shkencor, Departamenti i Shtetit SHBA. Ky dokument serizohet mban autorësinë e Drejtorisë së Gjeografisë së Departamentit të Shtetit, drejtori i cila zhvillon aktivitetin më të gjerë e kryesor lidhur me hartografinë shtetërore, analizat gjeografike rajonale, botërore etj., dhe sigurim informacionin nevrjaljik gjeografik për Shërbimin e Jashtëm e dhe sektorët e tjerë shtetërorë. Studimi në fjalë, krahas analizës jep edhe pikat e kufirit shqiptaro-grek (toponimet e kufirit janë lënë sipas originalit, pra nuk janë shqipëruar). Në vijim studimi në fjalë.

STUDIM I KUFIJVE NDËRKOMBËTARË. KUFIRI SHQIPËRI-GREQI, NR. 113, 18 GUSHT 1971
DREJTORIA E GJEORAFISË, BYROJA E INTELIGJENCËS DHE KËRKIMIT SHKENCOR, DEPARTAMENTI I SHETIT, SHBA

Sidoqoftë, e gjithë loja që zhvillohet është një lojë strategjike ku secili shtet ka objektiva. Sfondi i këtyre strategjive gjendet te historia, e cila është produkt i gjeografisë dhe e thënë në mënyrë më të kthjellët: kjo është gjeopolitika.

Nevojitet një analizë e gjerë mbi gjeopolitikën e kufijve dhe minoriteteve që ka luajtur shteti grek që prej krijimit, por në mungesë të hapësirës, mund të sjell në vëmendje që gjeopolitika me bazë kulturën, pasqyrohet në një prej shtatë ligjeve themelore të Ratzel-it, mbi zgjerimin e hapësirës së shteteve: Hapësira e shtetit rritet nëpërmjet kulturës së tij. Greqia e "dy kontinenteve dhe


I. PËRMBLEDHJE PËR KUFIRIN

Kufiri shqiptaro-grek, me gjatësi rreth 175 milje, është i demarkuar nga shtyllat/shenjat kufitare. I tërë kufiri përbëhet nga rreth 17 milje ujore dhe 158 milje tokësore. Duke nisur në Liqenin e Prespës në tripiqëshin me Jugosllavinë, kufiri drejtohet në jugperëndim, kryesisht përgjatë kreshtes së maleve, derisa arrin Ngushticën e Korfuzit (Stenon Kerkiras), përballë qytetit Kerkira (Korfuz) në Nisos Kerkira (Ishulli Korfuz).

II. SFONDI GJEOPOLITIK



Zona kufitare shqiptaro-greke, ashtu si topografia e ashpër dhe e çrregullt, karakteristike e maleve alpine, reflekton gjeografinë politike shumë të ndërlikuar, e cila është një tipar dallues i Gadishullit të Ballkanit. Fjala tipike "ballkanizim", ka dalë për të skicuuar copëzimin e një rajoni në një përgjatëzesh politike. Në kohët e lashta zona kufitare ishte e banuar nga ilirët, të cilët besohet të jenë paraardhësit e shqiptarëve. Më pas helenët, pushtuan shumicën e Gadishullit të Egjeut, në jug, veçanërisht terrenet detare. Në shekullin e parë të erës së krishterë, zona kufitare ishte pjesë e Perandorisë Romake dhe, lulëzoi falë afrisë me rrugën shumë të zhvilluar tokësore, të njohur si Via Egnatia (përgjatë luginës së lumit Shkumbin), ndërmjet Romës dhe Bizantit. Kjo rrugë historike nga Roma, përgjatë Via Appias-në Brindizi, përmes ngushticave së Adriatikut (Ngushtica e Otrantos) ishte një kyç strategjik dhe një lidhje tregtare për shumë shekuj. Për rreth një mijë vjet, deri në pushtimin otoman të Ballkanit në shekullin e katërmëdhjetë, zona kufitare ishte e përfshirë në një betejë për pushtet, mes sllavëve, bullgarëve, shqiptarëve dhe grupeve të tjera etnike lokale, në konkurrencë me autoritetet perandorake bizantine, me qendër në Kostandinopojë. Të strehuar në qendresat e maleve të tyre, shqiptarët kanë ruajtur në një shkallë të mrekullueshme, identitetin dhe gjuhën e tyre, pavarësisht dyndjeve të njëpasnjëshme të keltëve, romakëve, gotëve, sllavëve, bullgarëve dhe turqve.

II. A. KOHËT OSMANE
Gjatë shekujve



Në foto: Hartë e kufirit shqiptaro-grek, e cila shoqëron studimin

pasues, që nga fundi i shekullit të 14-t e deri në 1913, hapësira shqiptare ishte e sunduar në shkallë të ndryshme nga Turqia Otomane. Në kohën e pushtimit turk, Lumi Shkumbin, me rrjedhë nga lindja në perëndim, shënojti një ndarje historike me veriut dhe jugut, duke ndarë shqiptarët veriorë katolikë, të njohur si "gegë" dhe jugorët ortodoksë, të njohur si "toskë". E njëjta ndarje reflektohej edhe më herët, në ndarjen e mëparshme ndërmjet zonave të influencës romane (latine) dhe tyre bizantine (greke). Nën sundimin osman hapësira shqiptare nuk ishte e qeverisur drejtpërdrejt; përkundrazi, supermarcia turke mbahej nga politika tradicionale "përca e sundo" dhe nga inkurajimi i rivalitetit midis kryetarëve të vegjël ushtarakë. Edhe pse shqiptarët myslimanë ishin të privilegjuar, identiteti i tyre bazohej te besimi; nacionaliteti shqiptar nuk njihet si i tillë. Në vitin 1865, më qëllim që të shuanin rebelimet dhe t'i parandalonin kryetarët feudalë që të mos sfidonin pushtetin e sulltanit, hapësira u nda në vilajetet (ose provinca) e Shkodrës, Manastirit, Janinës dhe Kosovës, ku secila prej tyre kishte valiun e saj, apo guvernatorin, dhe garnizonin. Kjo hapësirë e gjerë e tyre, pavarësisht dyndjeve të njëpasnjëshme të keltëve, romakëve, gotëve, sllavëve, bullgarëve dhe turqve.





II. B. LINDJA E NACIONALIZMIT

Lëvizjet për çlirim, shpërthyen në Ballkan në fillim të shek. 19-të. Lufta Greke e Pavarësisë, e cila filloi në 1821, përfundoi me njohjen zyrtare nga Sulltani osman, të pavarësisë së Greqisë, përmes Traktatit të Adrianopolit, të vitit 1829. Shqiptarët i dhanë një mbështetje të rëndësishme luftës greke. Ndërhryra e Fuqive të Mëdha, ishte po ashtu e rëndësishme për arritjen e suksesit grek. Konventa e Londrës, e datës 7 maj 1832, konfirmoi një Mbretëri të Greqisë së pavarur (nën proteksionin e Britanisë së Madhe, Francës dhe Rusisë) dhe delimitoi kufijtë e saj, duke përfshirë gjithë Peloponezin dhe kufirin verior që shtrihej nga Gjiri Volos në Detin Ege, në perëndim, deri në Gjirin e Ambrakisë (Amvrakikos). Zona kufitare Shqipëri-Greqi, mori rëndësi si pjesë e pretendimeve greke për Epirin, në Kongresin e Berlinit, në 1878, pas mbylljes së Luftës Ruso-Turke. Interesat e Fuqive të Mëdha, veçanërisht frika e Britanisë së Madhe për rritjen e influencës ruse në Ballkan, ua shtoi më shumë rëndësinë kërkesave greke, shqiptare, serbe dhe të kombësive të tjera. Greqia mori vetëm një premtim për përmirsim të kufijve të saj; në 1881 Greqia fitoi pjesën më të madhe të Thesalisë dhe një pjesë të Epirit, duke e zgjeruar në këtë mënyrë kufirin e saj në veriperëndim të lumit Araktos.

II. C. LUFTËRAT BALLKANEKE DHE LUFTA E PARË BOTËRORE

Në vitet para Luftës së Parë Botërore, u ringjallën ndryshimet politike dhe territoriale. Brenda Turqisë kishte një kërkesë në rritje për reformat qeveritare, shumica prej të cilave ishin shtypur që nga shpallja e sulltanit, të Kushtetutës së "Midhat Pashës", së vitit 1876. Në korrik 1908 ndodhi revolta e Turqve të Rinj, udhëheqësi i të cilëve e kishte qendrën në Selanik. Shqiptarët dhe grekët, ashtu si popullsi e tjera (milet) të Perandorisë së madhe Osmane, u ngazëllyen fillimisht me premtimin e Lëvizjes së Turqve të Rinj, e cila u mbështet fuqishëm nga shqiptarët. Më pas, jorutqit, u zhgënjyen. Në 5 tetor 1908, Bullgaria shpalli pavarësinë. Në 7 tetor, Austria aneksoi Bosnjën dhe Hercegovinën dhe menjëherë u përshkallëzua intensiteti i intrigës ballkanike dhe konkurrenca e Fuqive të Mëdha. Gjatë verës së vitit 1912, marrëveshjet sekrete mes aleatëve ballkanikë e detyruan Turqinë që të dilte prej Ballkanit. Këto marrëveshje u bënë teksa Turqia ishte në luftë (1911-1912) me Italinë (asokohe një anëtare e Aleancës së Trefishtë). E gjithë hapësira shqiptare përfshihet në territorin, të cilin aleatët ballkanikë, prisnin që ta pushtonin prej Turqisë. Në 8 tetor 1912, Mali i Zi sulmoi Vilajetin e Shkodrës. Forcat malazeze u bashkuan më pas me ushtrinë serbe dhe kapën brigjet e Adriatikut, duke pushtuar Lezhën dhe Durresin në 30 nëntor. Nga jugu, ushtria greke, kapërceu Thesalinë dhe Epirin dhe kapi Janinën. Një flotë greke ishte duke bombarduar Vlorën në 3 dhjetor, dita që u vendos armëpushimi nën diktatin e Fuqive të Mëdha. Menjëherë pas bisedimeve të paqes të zhvilluara në 16 dhjetor, Austria, në vend që të lejonte copëtimin e Shqipërisë ndërmjet shteteve sllave në veri dhe Greqisë në jug, duke i dhënë kësajserbi një dalje në Adriatik, i detyroi Fuqitë e Mëdha që të njihnin parimin e një Shqipërie të pavarur.

II. D. KUFIRI AKTUAL

Sipas Traktatit të Londrës, 30 maj 1913, i cili i jepte fund Luftës së Parë Ballkanike, u nda mbi statusin e një Shqipërie të re dhe praktikimi i kufijve të saj, iu rezervua vendimeve të ardhshme të Fuqive të Mëdha, të cilat po përballeshin me zgjidhjen e pretendimeve të fitimtarëve grekë, serbë dhe malazezë, përkundrejt të drejtave kombëtare të popullit shqiptar. Marrëveshja në parim, mbi kufijtë shqiptarë, u arrit në Konferencën e Ambasadorëve në Londër, gjatë verës së 1913-s. Komisioni i Kufirit Jugor Shqiptar, e përfundoi punën e tij mbi kufirin shqiptaro-grek në dhjetor 1913. Një zgjidhje përfundimtare dhe një ndreqje finale e kufirit në terren, u vonua nga Lufta e Parë Botërore. Konferenca e Ambasadorëve, e 9 nëntorit 1921, nën juridiksionin e Konferencës së Paqes së Parisit, konfirmoi, me disa modifikime, kufirin siç ishte përcaktuar në Konferencën e Ambasadorëve në Londër, në 1913. Një komision ndërkombëtar kufijsh, i përbërë nga Franca, Britania e Madhe dhe Italia, filloi demarkacionin në 1922, duke e pambullur punën e tij në vitin 1925. Dokumenti final (l'Act final) i demarkacionit, u firmos nga Britania e Mad-

he, Franca, Italia, Greqia dhe Jugosllavia, në Paris, në 30 korrik 1926.

III. ANALIZA E VIJËZIMIT TË KUFIRIT

Pjesa vijuese është një përktim prej frëngjishtes nga teksti zyrtar i kufirit aktual (bazuar në marrëveshjen e Londrës 1913), ashtu siç përshkruhet nga Komisioni Ndërkombëtar Kufitar në 1925 (Commission internationale de delimitation des frontieres de l'Albanie) dhe i pranuar nga Greqia dhe Shqipëria (toponimet janë lënë sipas dokumentit amerikan - shënim, A.H.J.). Që nga pika e përbashkët e të tre shteteve, Shqipëri, Greqi dhe Jugosllavi, që ndodhet në jugperëndim të ishullit Veliki Grad në Liqenin Prespa, kufiri shkoi duke ndjekur meridianin, drejt majës së quajtur Vissaronivje, pika 1214, në bregun jugor të liqenit. Që nga aty, në një drejtim përgjithësisht jugperëndimor, vijon linja e pellgut ujëmbledhës midis Liqenit të Prespës në perëndim dhe luglinës Doskohaqla në lindje, duke kaluar nga pikat 1344 dhe 1434.

Pastaj, ajo ndërron drejtimin drejt juglindjes, duke ndjekur pellgun midis luginës së sipërpërmendur në anën greke dhe basenin ku ndodhet fshati i Tseria-s në anën shqiptare, duke kaluar nga pikat 1152, 1155 dhe 1139. Në pikën 1139 ajo kalon përmes rrugës së Zvedas në territorin shqiptar dhe, Rumbi-t, në territor grek. Më pas, ajo ndjek ujëndarësen mes ultësirave ku ndodhen Horovo dhe Grajdani, dy fshatra që mbeten në Greqi dhe ultësirat ku ndodhen Tseria dhe Rakitska, dy fshatra që mbeten në Shqipëri. Vija arrin kreshtën Vroatseria, duke kaluar nga pikat 1409 dhe 1312, mandej nga maja Golina, pika 1403, dhe vazhdon të kalojë dy pikat 1321 në Tepane. Prej aty, kufiri kalon Liqenin e Prespës në një vijë të drejtë dhe shkoi drejt majës së Tserova-s (1378), duke lënë kështu fshatin e Tsnov-s në Greqi dhe fshatin e Souets-it dhe Zagradets-it në Shqipëri. Që nga maja e Tserova-s, kufiri vazhdon në një vijë të drejtë në drejtim juglindor drejt majës veriore të Kosik-ës (pika 1549); që andej, duke u drejtuar pjerrtas drejt jugut, arin, në vijë të drejtë, pikën e majës jugore 1535. Që aty, vija e kufirit, duke kaluar nga pikat 1249 dhe 1212, shkoi drejt Pletsovits (pika 1344), duke kaluar rrugën Florina-Bihlichta në pikën 1049 dhe duke i lënë fshatrat Vambeli dhe Smerdeche në Greqi dhe, fshatrat Vrnik dhe Kapechtitsa, në Shqipëri. Nga Pletsovits-a, kufiri vazhdon në një drejtim përgjithësisht jugor, deri në përronin/kanonin e luginave të Labanitsa-s dhe Kostenets, në Greqi. Nga ky përrua, vija e kufirit zhvendoset në një drejtim përgjithësisht jugperëndimor, duke ndjekur pikën më të ulët të shtratit të përrorskës së Kostenets-it deri në bashkimin e saj bashkërrjedhës me Vistritsa-n (pika 781), duke lënë në Greqi fshatin e Krestchisa-s dhe në Shqipëri, fshatrat Trestenik dhe Korila. Nga bashkimi bashkërrjedhës i lartpërmendur, kufiri ngjitet në të njëjtin drejtim përgjithësisht jugperëndimor, në drejtim të kurrizit malor të Krostava-s, duke ndërrpërë pikat 903 dhe 992. Pastaj, ai shkoi në vijë të drejtë drejt majës së Tchiouka-s (pika 1108) dhe prej aty, duke ndjekur basenin ujëmbledhës ndërmjet Devoli-t në anën shqiptare dhe

Vistritsa-s në anën greke, ai shkoi në pikën 1085, pastaj në pikën 1274.

Pastaj vazhdon përsëri në vijë të drejtë, duke arritur Chinkova-n (pika 1422) dhe duke lënë fshatrat Novosselo, Chak, Revani, Kalevich-ta dhe Yanoveni në Greqi dhe, fshatrat Bratchani, Pontchara dhe Vidova, në Shqipëri. Nga Ghinkova, kufiri shkoi pjerrtas drejt perëndimit dhe bashkohet me ujëndarësen mes Belitsa-s në anën greke dhe Devoli-t në anën shqiptare, duke kaluar pikat 1364 (Kodra e Bidos), 1459 (Proi i Hasanit) dhe 1467 (Vratsa), duke lënë fshatrat Pilkati dhe Slimnitsa, në Greqi dhe fshatin e Kiouteza-s, në Shqipëri. Nga Vratsa, vija kufitare drejtohet në drejtim jugor, pa e lënë pellgun ujëmbledhës Devoli-Belitsa, dhe ajo arrin nëpërmjet Tchafa e Fouches (pika 1469), majën e Badaroches, (pika 2036). Nga Badaroches, kufiri vazhdon të ndjekë vijën e kurrizit të vargut malor të Gramos-it, në një drejtim kryesisht jugor, radhazi në pikat 2217 (Goubbel), 2519 (mali Tchoukapetsit), 1977, 2167 (mali Sarpoun), 2144; nga Tchafa e Badres (pika 1772); mandej nga pika 1909 (mali Guiontchit), 1934 (Golo), 2041 (mali Kammenik), 1474 (Vari Lople), 1634 (mali Vaches), 1047; pastaj bie poshtë shpejt, duke kaluar pikat 712 dhe 644, në ultësirën ujërrjedhëse të Sarandaporos, në pikën 430.

Fshatrat Gramosta, Kionat (Koniades), Izvor dhe Kosarska mbeten në Greqi dhe fshatrat Ranova, Guiontchit, Arza, Radati dhe Koukusi, në Shqipëri. Nga pika 430, kufiri ndjek ultësirën ujërrjedhëse të Sarandaporos, deri në bashkimin me ultësirën e Voyoussa-s, duke ndjekur Urën Perati dhe duke lënë në territorin grek fshatrat Derveni, Pirovitska dhe Melissopetra dhe, fshatrat Sarandaporos dhe Perati, në territor shqiptar. Nga bashkimi Sarandaporos-Voyoussa, kufiri vazhdon në një drejtim përgjithësisht perëndimor drejt pikës 1407 (Gropes), duke lënë fshatin Divalitsa në Greqi dhe fshatin Messarea në Shqipëri. Nga Gropes, kufiri kalon në një drejtim përgjithësisht perëndimor, nga maja e Kourouna-s (pika 1965) dhe Toumba (pika 1956), duke kryqëzuar vargmalin e Nemerchka-s (pika 2196) dhe duke arritur pikën 874 në Megavortop; duke lënë fshatin Drimades në Greqi dhe fshatin Sopik në Shqipëri. Nga pika 874, ai vazhdon në drejtim jugor drejt Makrikambos (pika 1671), duke ndjekur fillimisht kurrizoren e Damaskiniva-s e pastaj kurrizoren e Bosovo-s. Nga Makrikambos, kufiri drejtohet pjerrtas përsëri drejtim jugor, përmes malit Ailias dhe Plaka, pika 1487 në Bourato. Më pas, duke u drejtuar, ai vazhdon në drejtim jugor, duke kaluar nga pikat 1118, 549 dhe 406 dhe duke kaluar Luginën e Drinos në pikën 301.

Ai kalon rrugën Santi Quaranta - Han Kalpaki në pikën 339, duke lënë fshatrat Ksirovalto, Bosanico, Gaidohori, Krisodali, Mavropoulo dhe Zavroho në territor grek dhe, ato Glina, Episkopi, Radati dhe Kakavia, në territor shqiptar. Duke përvijuar akoma në një drejtim përgjithësisht jugor, kufiri kalon nga pikat 544, 306, 801, 718, 500 dhe 619 dhe mandej ngjitet në majën Mourgana (pika 1806 dhe 1804), duke i lënë fshatrat Arinista, Valtista dhe Kastaniani në Greqi dhe, fshatrat Ai Nicolas, Katouna

dhe Kochovitsa in Shqipëri. Nga Mourgana, kufiri merr një drejtim veriperëndimor, duke ndjekur kurrizoren e vargut malor Mourgana-Stougara, duke arritur në pikën 1756. Pastaj, ai merr një drejtim përgjithësisht jugperëndimor, duke kaluar nga pikat 1659, 1512 (Ver-top), 588, duke kaluar luginën Pavla dhe duke arritur në pikat 470, 708 (Gelil), 650, 174, 614 dhe 960 në malin Poulia. Në këtë segment të fundit, kufiri lë fshatrat Tchamandas, Ledizda, Povla, Achouria dhe Palamba në Greqi dhe fshatrat Leskovetch, Zimnети, Perdikari, and Yanitari, në Shqipëri.

Nga pika 960, në malin Poulia, vija e kufirit vazhdon në një drejtim përgjithësisht veriperëndimor, drejt pikës 1050 në malin Chenndeli; pas kësaj, ajo drejtohet pjerrtas drejtim jugor, duke kapur pikën 831 dhe 837 në malin Tourli. Më pas, në një drejtim përgjithësisht veriperëndimor; ajo arrin Gjirin e Phtelia-s, duke ndjekur pikat 666, 854 (mali Ligoyani), 135, 171 (Brigues), 161, 387 (Orla), 257 (Tch-enqueli), 184 (Thier), 86 (Kalliho-ra) dhe pikën 8. Ajo lë në këtë mënyrë fshatrat Kotska, Liopesi dhe Sayada në Greqi dhe fshatrat Verva, Konispoli, Mourssi, Zara dhe Vrina, në Shqipëri. Në segmentin detar në Gjirin e Phtelia-s, kufiri ndjek vijën perpendikulare sipas drejtimit të përgjithshëm të brigjeve deri në limitet e ujërave territoriale, duke lënë ishullin e vogël Tongo në Shqipëri.

Firence, 27 janar 1925, (firmosur) Medhi Frasherit, i deleguar i qeverisë së Shqipërisë; (firmosur) nënkolonel Cr. Avramides, i deleguar i qeverisë së Greqisë.

IV. PËRMBLEDHJE

Kufiri shqiptaro-grek, me gjatësi rreth 175 milje, përbëhet nga 158 milje tokësore dhe 17 milje ujore. I tërë kufiri është i demarkuar nga 178 shtylla kufitare me numra dhe të dallueshme dhe nga shumë shënjesa të tjerë pa numra. Megjithatë zona kufitare ka qenë një çështje diskutimi për shumë vite, çështjet nuk kanë lidhje me vijëzimin specifik të vetë kufirit. Kufiri duhet të jepet në hartat zyrtare, si një kufi i përcaktuar ndërkombëtar. Kufiri është një rezultat i Luftërave Ballkanike dhe Luftës së Parë Botërore, në të cilat diplomacia e Fuqive të Mëdha, u përshi thellësisht. Ekziston një mundësi fërkimi, në atë zonë të Shqipërisë Jugore, të cilën Greqia e quan Epiri Verior. Kompleksiteti etnografik, acarohet nga ekzistenca e një minoriteti grek që jetojnë në anën shqiptare si dhe disa shqiptarë që jetojnë në Greqi. Sidoqoftë, pritsshmëria e një mundësie mosmarrëveshjeje mbi kufirin, do të qëndrojë e fjetur. Vendndodhja e shtyllave kufitare, paraqitet në fletët 11-17, në shkallë 1: 50,000, sipas Komisionit Ndërkombëtar Kufitar, 1923-1924. Një prezantim i arsyeshëm dhe korrekt i kufirit, në shkallë të mesme, gjendet në Shërbimin e Hartave Ushtareke 1: 250,000, Seria 1501, Fletë NK 34-11 dhe NJ 34-2. Megjithatë, kufiri i hequr në kanalin e Korfuzit nuk ka vlefshmëri. Një përshkrim në shkallë të vogël të kufirit, gjendet në Shërbimin e Hartave Ushtareke 1: 1,000,000, Seria 1301, Fletë NK-34 dhe NJ-34.

(RGE-INR/Geographer; Drejtor: RDHodgson; Analisti: ESBasoum)

EKSPOZITA



Foto nga ekspozita




"Lookaftering", dialog me imazhet e nanës

Lek M. Gjeloshi*

Domethënia e fjalës "Lookaftering", duke i referuar fillimisht një përkujdesjeje në akt e sipër (e të evokuar në një farë mënyre në mungesë), na projektton gjithashtu tek marrëdhënia e çuditshme mes shikimit e kohës, vazhdimësia e të cilës, dhënë nga mbrapshtesa "ing" që e shkëput prej realitetit të fjalorit, duket se mban ende në veprim atë pjesë kohore që për definicion nuk është më. Kemi të bëjmë me një fjalë të përveçme, ku shikimit të ndalur e pa kohë, megjithëse të disponueshëm, i rrjedh një e kryer potencialisht e hapur dhe e mundur. Pak a shumë si në idenë e Grekëve, që sipas Roland Barthes "hynin te Vdekja së prapthi: ajo çka kishin përpara ishte e kaluara e tyre."

Drejt një perspektive të ngjashme, ku atmosfera e një "kohe tjetër" i përkon një kohë të "tjetërsuar", orientohet edhe ekspozita e artistes italiane Moira Ricci në Muzeun "Marubi", me dy vepra të realizuara kryesisht nga ngjarje të jetës së saj private, të cilave i rikthehet me një protagonizëm diskret e në një dialog të pamundur, gati-gati obsesiv, me imazhet e nanës – bashkëautore indirekte e momenteve që ata rrëfijnë.

Nga gjuha e fotografisë tek ajo e videos, qëndrimi i saj mbetet pezull mes një kohe të rrjedhshme e të ktheshme, e një tjetre që e gjen përfundimisht të shtangur. Në secilën nga veprat, kontekstet, ambientet e situatat ndërtojnë një galeri me imazhe ku artistja s'ka qenë e pranishme, ose asiston përmes vështrimit të dikujt. Në rastin e videos, këtë e bëjnë filmimet e nanës në kohën kur e ndiqte në shfaqje e konkurse. Në të Moira rekuperon koreografitë e veta e marrëdhënien e kahershme me kërcimin. Një histori që e sjell të sinkronizuar me optimizmin e shpenguar të njëjës prej kolonave zanore të filmit "Flashdance"; por ndryshe prej ekzaltimit të një ëndrre të realizuar që shpërfaq personazhi në film, aspirata e saj e dikurshme i flet me shumë një nostalgji, të perceptueshme deri



Ekspozita e Moira Ricci te 'Marubi', qëndrimi pezull mes një kohe të rrjedhshme e të ktheshme

MOIRA RICCI

Muzeu Marubi çel me 24 shkurt, ekspozitën "Lookaftering" të artistes italiane Moira Ricci, kuruar nga Lek M. Gjeloshi. Moira Ricci (Itali, 1977) jeton dhe punon në Itali. Puna e saj (fotografi, video, instalacion), shpesh me karakter autobiografik, trajton tematika të lidhura me identitetet sociale e individuale, historitë familjare, shtëpinë dhe lidhjen me territorin duke gërshetuar shpikjet teknologjike me rizbulimin e imazhit të një përkatësie shoqërore.

togratitë e vjetra të familjes, brenda të cilave futet në kuptimin më direkt të fjalës. Për t'u bërë pjesë organike e tyre, asaj i duhet të inskenojë jo pak, e të vetë-fotografohet; të gjurmë imazhin, vendin e përshatshëm që e pret; të kamuflojë veshje e kostume të periudhave të ndryshme; të zbrërthejë sipërfaqe e tekstura fotosh; të bëjë të koinçidojë dritën, temperaturën e ngjyrave, e ndonjëherë të presë edhe stinë e përshatshme për të realizuar shkrepjen... Në stacionin final të procesit, në këtë seri me fotomontazhe, autorja stimulon si të vertetë e real një iluzion tejet të kuar pranë, të "paditur" poetikisht (e qëllimisht) vetëm nga vigjilencia e saj melankolike, e izolimi në një kohë që vepron në çdo skaj të fotove, përveçse mbi të.

Jeta e dyfishtë e këtij cikël vjen në kontekstin e Muzeut si një refleks i padiskutueshëm i erës dixhitale e i mundësive që ajo ofron. Si i tillë, më shumë se para dëshmisë e momentit të pranishëm të fotografisë, na vë përballë natyrës së një imazhi të krijuar për një imazh tjetër, e para egzjencës intime që i bashkon duke ngarkuar pikërisht të mosqenurit aty, në atë moment, deri në mbërritjen e një normaliteti prej ku ata çlirohen nga varësia e faktit teknik dhe ringjiten në ndërgjegjen tonë afektive si të zakonshëm e njëkohësisht të pamundur.

*Kuratori i ekspozitës

Tani është Moira, e gjendur para ndarjes nga jeta të nanës, që përpiqet ta ndjekë figurën e saj, e t'i afrohet në të vetmin vend akoma të mundur për të: në fotografitë e vjetra të familjes, brenda të cilave futet në kuptimin më direkt të fjalës.

në zhurmat e vogla të videokasetave VHS që e trazojnë lehtë projektionin.

Përbri tij shtrihet në vijë të njëtrajtshme cikli fotografik "20.12.53 - 10.08.04", ku invertohet

Foto nga ekspozita



TAKIMI I ORGANIZUAR NGA "UET PRESS" DHE COD



I ftuar për të folur mbi librin e tij më të ri "Përkthyesi", në një auditor me gjimnazistë të "Ismail Qemalit" dhe të gjimnazit të "Nju Jorkut", përballë Alda Bardhyllit dhe Ben Andonit, Velo u shpreh se ndjehej i tronditur, pasi vetëm disa ditë më parë kishte marrë dosjen e tij nga Autoriteti për Informim mbi Dokumentet e ish-Sigurimit

Maks Velo hap dosjen: Më ka spiunuar miku im, Llambi Blido

Maks Velo ka bërë publike dje gjatë një takimi organizuar nga UET PRESS dhe COD (Qendra për Hapje dhe Dialog) në Kryeministri, se cilët ishin miqtë që e kishin spiunuar. I ftuar për të folur mbi librin e tij më të ri "Përkthyesi", në një auditor me gjimnazistë të "Ismail Qemalit" dhe të gjimnazit të "Nju Jorkut", përballë Alda Bardhyllit dhe Ben Andonit, Velo u shpreh se ndjehej i tronditur, pasi vetëm disa ditë më parë kishte marrë dosjen e tij nga Autoriteti për Informim mbi Dokumentet e ish-Sigurimit. "Këto ditë kam qenë shumë i tronditur, sepse mora dje nga Autoriteti i Informimit për Dosjet e ish-Sigurimit të Shtetit, dosjen time. Kisha 6 muaj që e kërkoja dhe mora dje dosjen me rreth 250 faqe. Jam tronditur. Nuk fle natën. Nuk e dija që paskemi qenë kaq të poshtër", tha Velo. Ai ka bërë publike pasazhe nga kjo dosje, duke treguar se një nga njerëzit që e kishte spiunuar ishte miku i tij, piktori Llambi Blido. Një tjetër personazh që e kishte spiunuar ishte vjehrra e tij. "Shoku im i ngushtë, Llambi Blido ka bërë 27 denoncime për mua. Madje ka ardhur edhe për të regjistruar në shtëpi. Postërsia më e madhe ishte që atë e kanë përdorur edhe pasi më kishin futur në burg. Shkonte në shtëpi për të mësuar se çfarë thoshin prindërit e mi. Imagjinoi ai ishte dhe piktor, punonte në ministri dhe ka shkruar më vonë për modernizimin", tha Velo, duke lexuar dy faqe të shkëputura nga dosja për të rinjtë, duke thënë se e zgjodhi këtë pasazh për t'u treguar se si mund të jetohej në burg. "Gjatë burgut jam zënë dy herë. Një herë në galeri me një kuksian që donte të më digjte në furnelë, por që nuk është e dokumentuar, kurse kjo është e dokumentuar", tha Velo duke treguar dokumentin e mbajtur më 14.07.1982. "Në rajonin e banimit nga ora 22:00, në kohën që ishte bërë pushimi, i dënuari Skënder Vreto flinte gjumë në krevatin e tij. Në këtë kohë shkon i dënuari Maksim Velo tek krevati për të fjetur gjumë. I dënuari Skënder gjatë kohës së gjumit kishte hedhur batanijen dhe çarçafin në krevatin e Maks Velos, si dhe krahu përmbi krevat. I dënuari Maksim Velo, duke mos e zgjaur të dënuarin Skënder, i kap krahu dhe ia hedh në fytyrë të dënuarit. Atëherë ky zgjohet dhe kapen duke u shtyrë me duar me njëri-tjetrin. Gjatë kapjes nuk kanë ndonjë plagë. Shkaktar për këtë është i dënuari Maksim Velo, sepse duhet ta kishte zgjaur nga gjumi të dënuarin Skënder Ndreu dhe nuk do kishin përfunduar në grindje me njëri-tjetrin. Që të dy të dënuarit të thirren dhe të këshillohen. Të dënohen me vërejtje të dy të dënuarit", lexoi Velo



Në foto: Maks Velo me gazetaret, Alda Bardhylli dhe Ben Andoni

Artisti flet me ermra: 27 denoncime nga miku e nga vjehrra, jam i tronditur

nga relacioni. Sipas tij, gjëja më e vështirë në burg ishte të zije shok. Më tej ai ka treguar se tashmë ka dokumentin që vërteton që nuk ka pranuar të bëhej bashkëpunëtor i Sigurimit të Shtetit. Në dokumentin me datë 13.01.1986 mbajtur nga operativ Pëllumb Sinoimeri thuhet. "Unë operativ Pëllumb Sinoimeri, bashkë me shefin e seksionit Nuro Sako, në datën 8.01.1986 shkua në kampin e riedukimit të Garthit, të rrethit të Mirditës, për të tërhequr në bashkëpunim sekret me bazë vullnetare, të dënuarin për agitacion dhe propagandë armiqësore, Maksim Velo, i cili lirohet nga burgu me amnistinë e datës 13.01. Fillimisht me të u bënë biseda të karakterit familiar dhe jetën e tij në burg, kandidati fillimisht reagoi pozitivisht, na falënderoi për trajtimin e mirë që i ishte bërë në burg dhe për punën e tij të bërë atje. Pas kësaj u fol në lidhje me masën e dënimit të tij, për luftën e klasave dhe punën që bëjnë organet tona për zbulimin e veprimtarisë armiqësore dhe keqbërëse me ndihmën që jep populli, këtyre organeve. Pasi dëgjoi bisedat që u bënë, Maksim u shpreh se unë për veten time e quaj dënimin tim të padrejtë. Sepse jam dënuar mbi bazë shpifjesh, por një gjë kam pasur unë, kam qenë i prirë pas artit modernist dhe filloi të na shpjegojë si ishte dënuar. Pas kësaj, tha: Unë e kuptoj se përse keni ardhur ju dhe çfarë doni nga mua. Ju doni që unë të bashkëpunoj me organet e Sigurimit të Shtetit. Këtë propozim ma kanë bërë edhe herë të tjera kur kam qenë i lirë, shokët e Drejtorisë së Tiranës, por unë nuk e kam pranuar, se nuk jam dot në gjendje të bëj punën e spiunit", lexoi Velo. Artisti i ftoi të rinjtë të lexojnë duke u thënë se, "duhet të lexoni absolutisht Kadarenë". "Pa njohur Kadarenë, nuk njihni Shqipërinë. Shqipëria e servitur nga një gjeni. Ajo që ka bërë Kadare gjatë komunizmit, përveçse kemi qenë miq të ngushtë dhe ka bërë shumë për mua, por për të gjithë popullin, që ruajti një nivel të lartë intelektual përballë një barbarie. Dhe ne i detyrohemi shumë atij", tha Velo.

REAGIMI

"Këto ditë kam qenë shumë i tronditur, sepse mora dje nga Autoriteti i Informimit për Dosjet e ish-Sigurimit të Shtetit, dosjen time. Kisha 6 muaj që e kërkoja dhe mora dje dosjen me rreth 250 faqe. Jam tronditur. Nuk fle natën. Nuk e dija që paskemi qenë kaq të poshtër"



Dje në 'Deutsche Welle'

Nga Anila Shuka

Ballkani Perëndimor, në grup bashkë, apo në garë drejt BE?



Torikisht më 2025 dy shtete të Ballkanit mund të anëtarësohen në BE, sipas strategjisë së re të Komisionit të BE. Ekspertët e Europës Juglindore e vlerësojnë sinjalin si të drejtë, por edhe e kritikojnë procesin. Premtimi është bërë që në vitin 2003, kur BE i zgjati dorën Ballkanit Perëndimor dhe e ftoi për anëtarësim. Por hovi i atëhershëm ka rënë, shkëlqimi është zbehur. Kush, kur dhe si duhet të hyjë në BE, kjo është e paqartë dhe duket se i përkent një të ardhmeje të largët. "Premtimi i 2003-shtit në Selanik kishte kohë që nuk ishte më i besueshëm", thotë për DW Gernot Erler, ish-ministër Shteti dhe president i Shoqatës së Evropës Juglindore.

Sipas Erler-it, kjo mungesë besueshmërie i kishte bërë këto shtete më të ndjeshme për ndikime nga jashtë. Në këtë garë strategjish, "ka pasur në të kaluarën përpjekje serioze nga Kina, Rusia, Turqia dhe vendet arabe për të pasur ndikim në Ballkanin Perëndimor", thotë Erler, i cili si edhe ekspertët e tjerë ndodhej më 9./10. shkurt në Berlin, në konferencën vjetore të Shoqatës së Evropës Juglindore. Ai përshëndet faktin që strategjia e re e komisionit ka edhe një plan veprimi konkret në të cilin mund të marrim pjesë gjithkush.

Më kritik është gjithkëmi i Forian Bieber-it, drejtuesi i Qendrës së Europës Juglindore në Grac. "E mirë në diagnozë, por e dobët në propozime", jep vlerësimin profesor i Evropës Juglindore. E mirë është strategjia, sepse aty komisioni për herë të parë identifikoi problemet në rajon. Flitet për ndikimin e interesave private në sektorin publik (state capture), për krimin e organizuar, për korrupsionin, për probleme me shtetin ligjor. Por e

dobët, sepse propozimet janë ca si të papërpunuara, mendon Bieber. "Duket se refuzojnë të konfrontohen me ata që i shkaktojnë problemet".

ELITA PROBLEMATIKE

Dhe sipas Bieber-it, shakatarrë të problemeve janë shpesh elitat sunduese. Bieber paralajmëron që në realizimin e kësaj strategjie, BE të mos fokusohet vetëm tek to dhe ta anashkalojë opozitën demokratike. "Duhet pasur kujdes që opozita të mos shkasë në një diskurs antieuropanacionalist", thotë Bieber. Kjo vlen si për Kosovën, ashtu edhe për Serbinë: "Dhe do të jetë rrezik shumë i madh, nëse Bashkimi Evropian do ta shohë veten aleat të autoritativë, ndërsa opozita, që përpiqet të bëjë kritikë demokratike, do të dalë e humbur".

Edhe deputeti socialdemokrat, Josip Juratovic, sheh një problem

të madh të elitat që qeverisin Ballkanin. Ka shumë politikanë që "nuk duan aspak të shkojnë drejt BE, sepse në BE ata do të gjejnë një sistem të rregulluar, një shtet ligjor, një shoqëri të rregullt dhe në këtë shoqëri ata nuk kanë shansë", thotë Juratovic, i cili preferon t'ua kalojë përgjegjësinë vetë qytetarëve: "Si njerëzit, ashtu edhe politikanët", shprehet ai me keqardhje dhe thekson se megjithatë, janë qytetarët ata që duhet ta shpëtojnë situatën: "Në nuk duam koloni, por partnerë në sensin demokratik".

ANËTARËSIM VETËM KUR TË PLOTËSOHEN KUSHTET

Për deputetët e Bundestagut është e qartë që në BE hyn vetëm kur të përmbush kushtet. Prandaj edhe Manuel Sarrazin, deputet i "Die Gießel" në parlamentin federal të Gjermanisë e shikon datën 2025, për anëtarësimin e Serbisë dhe

Malit të Zi, jo si një premtim fiksis, por si një detyrim, për politikanët vendës për të dëshmuar se deri atëherë duhet të kenë arritur diçka: "Nëse deri në vitin 2025 elitat politike nuk sjellin rezultatet e kërkuara, atëherë ato duhet t'u japin llogari zgjedhëseve dhe zgjedhëseve të tyre se përse nuk e kanë bërë, megjithëse kishte qenë e bëshme", thotë Sarrazin.

Peter Beyer, deputet i grupit parlamentar të Unionit Kristian-demokrat e Kristiansocial (CDU/CSU) është për parimin e kushtëzimit, si të vetmin kriter anëtarësimi: "Kjo do të thotë se duhen zbatuar reformat konkrete në sektorin publik, në sektorin juridik, luftimin e krimin të organizuar, të korrupsionit dhe jo vetëm duke miratuar ligje, por duke i vënë ato në jetë".

KRIKË NDAJ PARIMIT TË GARËS

Michael Schmunk mendon se nuk është mirë që Serbia dhe Mali i Zi të hyjë në BE para të tjerëve. Diplomati gjerman ka qenë përfaqësues i Gjermanisë në Sarajevë dhe Prishtinë dhe është sot ekspert për Europën Juglindore në disa institucione këshilluese. "Sepse atëherë ata katër që mbeten pas, sidomos Kosova dhe Bosnja, do ta kenë më të vështirë të hyjnë në BE", thotë Schmunk, edhe duke pasur parasysh mungesën entuziazmit për raunde të mëtejshme zgjerimi brenda BE. Ai madje propozon që gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor të bëhen bashkë dhe të zhvillojnë një strategji kundër skepticizimit: "Unë besoj se atëherë po, që kanë shans që një ditë të anëtarësohen në BE në grup të bashku".

← e sistemeve antiraketore, nënshkruar në vitin 1972. Dhe në 2002 Shtetet e Bashkuara me të vërtetë u tërhoqën në mënyrë të njëanshme nga ky dokument kyç ruso-amerikan, i cili garantonte qëndrueshmërinë e balancës globale të fuqive. Ishte një goditje e rëndë për paqen dhe stabilitetin e përgjithshëm. Në 2003 SHBA-të dhe aleatët e tyre përdorën një pretext të tremë për të pushtuar Irakun. Megjë ra fjala, pasojat katastrofike të këtij pushtimi mund t'i shohim edhe sot e kësaj dite. Në 2004 ndodhi zgjerimi i radhës i BE-së dhe NATO-s kur këtyre organizatave iu bashkuan disa shtete të Evropës Lindore, përfshirë këtu edhe vendet Baltike. Natyrisht që bashkë me zgjerimin e NATO-s nisi edhe afrimi i infrastrukturës ushtarake të aleancës me kufijtë e Rusisë.

Një goditje kolosale për marrëdhëniet Rusi-Perëndim u shkaktua në 2006, kur SHBA-të bënë të ditura planet e tyre për vendosjen në Evropë të një sistemi antiraketë, objektiv i të cilit, sipas amerikanëve, është neutralizimi i rrezykave të pretenduar nga Irani. Kuptohet se Moskë kishte nevojë për garancitë që ky sistem të mos përdoret kundër Rusisë. Për këtë arsye Presidenti Putin i propozoi Amerikës që të krijohet një sistem i përbashkët ruso-amerikan në bazë të radarëve rusë dhe të vihet pastaj nën kontroll të Këshillit Rusi-NATO. Por Uashingtoni na tha "jo".

Po t'i marrim parasysh të gjitha këto fakte, atëherë deklaratat e liderëve perëndimorë se veprimet aktuale të NATO-s mbartin karakter mbrojtës tingëllojnë të paktën naive. Sepse gjatë shumë viteve Perëndimi nuk bënte asgjë tjetër përveç se sulmonte, ndërkohe që ishte Rusia ajo që duhej ta mbronte veten.

Në këndvështrimin tim, e gjithë politika e sotme e Perëndimit me në krye Shtetet e Bashkuara ndaj Rusisë ka për qëllim justifikimin e aktivitetit të NATO-s, të këtij blloku gjigant ushtarako-politik me një buxhet prej 1 trilion dollarësh, i cili siç duket ka nevojë për një armik imagjinar për të justifikuar ekzistencën e vet. Dhe pikërisht për këtë arsye mund të dëgjohemi vazhdimisht këto akuzat të pabaza ndaj Rusisë "agresive", nga e cila gjoja duhet të mbrohet.

Unë dua t'ju them me përgjegjësi të plotë se as nuk bëhet fjalë për kurfarë ndikimi negativ të Rusisë në Ballkan. Interesat e Rusisë në shtetet ballkanike janë krejtësisht të njëjtë me interesat e saj në rajone të tjera të botës dhe synojnë ndërtimin bashkë me partnerët të një dialogu të barabartë në bazë të respektit reciprok, një bashkëpunim pragmatik ekonomikotregtar, si edhe një ndërveprim energjik në fushën e kulturës dhe atë të arsimit. Dhe megjë ra fjala, Rusia kurë nuk ka dalë kundër perspektivës evropiane gofite të Shqipërisë, gofite të vendave të tjera të rajonit. I vetmi

interes i Rusisë është që Ballkani Perëndimor të zhvillohet në mënyrë të qëndrueshme dhe të kapërcejë të gjitha kontradiktat e brendshme që ende ekzistojnë në rajon.

Siç theksoi Ministri Lavrov, ka ardhur koha që Ballkani të mos përdoret më në lojërat gjeopolitike. Në vend të kësaj duhet të punohet për krijimin e sigurisë së përbashkët evropiane, në kuadër të së cilës edhe anëtarët e NATO-s, edhe anëtarët e CSTO-s, edhe vendet që nuk bëjnë pjesë në aleanca ushtarako-politike të ndiheshin të mbrojtura në masë të barabartë me siguri të pandashme. Asnjë rrugë tjetër nuk ka. Në të kundërt, për shkak të dëshirës së Perëndimit për të ruajtur natocentrimin dhe mosdashjes së tij për të diskutuar mbi garancitë ligjore të sigurisë jashtë kufijve të aleancës, ne do të vazhdojmë të biem gjithmonë në të njëjtin kurth. Dhe pa dyshim ne do të ishim të lumtur nëse Shqipëria do të ndiqte pikërisht një politikë të tillë, pra një politikë shumë dimensionale.

Të nderuar miq, duke e mbyllur fjalën time dëshiroj t'ju them edhe diçka tjetër. Unë kam më shumë se tre vite që punoj në Shqipëri. Sigurisht që gjatë kësaj periudhe jam njohur nga afër me vendin tuaj të mrekullshëm, me natyrën e tij, me monumentet historike, po edhe me kushtet fantastike për turizmin. Gjithsesi, përshtrypiet e mia më emocionuese lidhen me komunikimin tim me qytetarët e thjeshtë të Shqipërisë, shumica

e të cilëve ushqejnë ndjenja pozitive ndaj Rusisë dhe popullit rus. Shqiptarët e duan shumë kulturën tonë, letërsinë, muzikën, pikturën dhe jo vetëm. Ata nuk e kanë harruar se në periudhën e pasluftës pothuajse e gjithë elita e shtetit shqiptar ishte përgatitur në Rusi: inxhinierët, mjekët, pedagogët, ushtarakët dhe madje shkrimtarët me famë botërore, si Dritëro Agolli dhe Ismail Kadare. Jam vërtetë i gëzuar që arsimi i lartë rus edhe sot e kësaj dite mbetet mjaft i kërkuar në Shqipëri. Çdo vit ambasada jonë u akordon maturantëve shqiptarë rreth 40 bursa për studimet falas në universitetet më të mira të Rusisë (për vitin e ardhshëm akademik kemi një kuota prej 50 bursash). Të gjithë shqiptarët që studiojnë në Rusi diplomohen pastaj si specialistë të klasës së lartë dhe i shërbejnë denjësisht vendit të tyre.

Për mua si ambasador i Rusisë në Shqipëri objektivi im personal dhe detyra kryesore e ambasadës është rivendosi e bashkëpunimit dhe besimit reciproc midis vendeve dhe popujve tanë në atë nivel të lartë, i cili ka ekzistuar më përpara. Jam i sigurt që kemi gjithçka të nevojshme për këtë.

Ju faleminderit për vëmendjen tuaj!

* Fjala e ambasadorit të Rusisë në Tiranë gjatë tryezës me temë: "Politika e jashtme e Rusisë: Shqipëria dhe çështje strategjike"

HOROSKOPI

DASHI

Të shpërblyer nga Venusi në shenjë tuaj që përqafojnë Hënë, do të përballeni me vendosmëri dhe optimizëm pengesa të mundshme. Nëse keni dyshime në lidhje me një çështje, është e kotë të shqetësoheni. Duhet të vazhdoni me tej.

DEMI

Nëse nuk jeni të sigurt për ndjenjat tuaja, mos hyni në lojë: rrezikoni të krijoni ndonjë situatë të pakëndshme, për të cilën mund të pendoheni. Përpara se t'i futeni kokë e këmbë një ndërmarrjeje, do t'i ishte mirë të vlerësonit të mirat dhe të këqijat.

BINJAKET

Me Venusin, Marsin dhe Uranin që ju favorizojnë do të rinovoni disa aspekte në fushën e dashurisë, për të vendosur më shumë mirëkuptim me partnerin. Me Hënë mike do të dini të endëroni, por mbajni sytë hapur kur vjen puna për bazën materiale!

GAFORJA

Është koha e duhur për të ndërtuar me vendosmëri dhe durim bazat për të zhvilluar më tej projekte të ndërmarrja. Jepini, pral Do të dini të shqyrtoni në mënyrë të pretër dhe me zgjuarsi çështje shumë delikate dhe të rëndësishme që kanë të bëjnë me punën.

LUANI

Për meritë të Saturnit dhe Uranit miq, në punë mund të ndërmerrni një nisim pak të sforcuar, për të shënuar rezultate të mira. Me një qëllim pozitiv si juaji, ndiheni plot me energji: mbylleni atë që ju ka mbetur pezull.

VIRGJERESHA

Neptuni jo i favorshëm ju bën të jeni më të ndjeshëm. Bëni kujdes, sepse jeni më të prekshëm ndaj negativitetit të personave që ju rrethojnë. Në dashuri, kijihi idetë e qarta dhe dilni drejtë në temë, duke shmangur dyshimet dhe ngurrimet të kota.

PESHORJA

Me Saturnin që ju mbështet do të vini në pah nevojën për t'u përmbushur profesionalisht në mënyrë të vazhdueshme dhe të qëndrueshme. Urani e keni kundra sot. Në pengesë mund t'ju shfaqet para rrugës së juaja, por që keni mundësi ta kaloni.

AKREPI

Gjithçka do të shkojë për më mirë, mbi të gjitha nëse kërkoni të veproni në aktivitetin e juaja, gjithmonë duke u bazuar në kriteret e paanshmërisë dhe respektit për të tjerët. Hëna është dinake, dhe sot do të jeni si situata pozitive ashtu edhe tensione.

SHIGJETARI

Për shkak të Uranit dhe Plutonit armiqësorë, shmangni të ngrënit dhe të pirët jashtë mase si edhe lodhjen e tepër. Duhet të llogaritni mirë forcat tuaja. Me Marsin kundra parashikohet disa shqetësime. O të jeni nën trysi nga angazhime të shumta.

BRICJAPI

Sot duhet të bëni kujdes me ata që nuk janë duke ju thënë të vërtetën. Nuk mund të bëni më sikur nuk e kuptoni: është koha për sqarime. Do të përfilloni nga një frymëzim nisimtar, do të mbështetni nga fantazia dhe krijimtaria.

UJORI

Me Hënë që i buzëqesh Venusit, ngjarje entuziazmuese dhe sensuale do t'ju stimulojnë jetën sentimentale. Do të dini të pëpozi gëzim kudo. Një Uran i shikëslyer do të vërë në plan të parë mendjehpërsinë e juaj. Mësoni t'i besoni intuitës së juaj.

PESHQIT

Pas ditës të mbushura me angazhime, po vijmë momente më të qeta. Do të ndiheni në formë, të qetë dhe në dispozicion të personit që ju qëndron në krah. Do të keni mundësinë të kaloni në veprim, duke realizuar edhe gjëra që i konsideroni shumë të vështira.



Frika është e madhe për mbrojtësin

Jashanica, rezonanca do të bëhet pas disa ditësh

Ndoshta ai dëmtim i rëndë i pësuar dje ndaj Teutës, ku u fut në lojë si zëvendësues, ishte si një "mesazh" që mbrojtësi kosovar të mos largohet nga Skënderbeu. Kuptohet që në Korçë e duan ta kenë gjithmonë aty, por po ashtu të gjithë duan më të mirën për

të, që të ketë një karrierë së më të mirë. Bajram Jashanica i ka trishtuar të gjithë në ekip me atë dëmtim shumë serioz në gju. Fat i keq, në momentin më të mirë, kur lojtari po bëhej gati për hapin e madh, për kalimin nga Skënderbeu në një kampionat të huaj. Jashanica ish-

ortopedë të spitalit rajonal të Korçës, nuk bëhet fjalë për një dëmtim shumë të rëndë. Frika më e madhe ka kaluar, por sigurisht që duhen bërë ekzaminime të tjera për të mësuar detajet. Lojtari duhet të kryejë pas pak ditësh një rezonancë, pasi gjuri të mos jetë më i ënjtur. E sigurt është se Jashanicës i duhet më shumë se një muaj për rikuperimin, por kjo është e keqja më e vogël. Një informacion më i plotë për këtë dëmtim do të mund të jepet pas rezonancës.

Dënimi i parë në vitin 2016 ishte administrativ. Tani pritet dënimi disiplinor

'Shtrëngatë' nga UEFA! Skënderbeu, pranë një dënimi shembullor

Akuza: 10 vjet përjashtim dhe 1 mln euro gjobë



10 vite përjashtim dhe 1 milion euro gjobë. Këto janë shifrat e frikshme që kërcënojnë Skënderbeun. Lajmi bëhet i ditur nga Komisioni i Etikës dhe Disiplinës në UEFA, inspektorët e të cilët kanë kërkuar dënimin shembullor për klubin korçar. Dokumenti është firmosur nga Karl Dont, inspektor i trukimeve në UEFA, që prej gati dy vitesh po merret ekskluzivisht me çështjen "Skënderbeu", që shpërtheu në qershor të vitit 2016. Asokohe u dha vetëm 1 vit përjashtim nga Kupat e Europës, por atëherë bëhej fjalë për një ndëshkim administrativ, teksa ai disiplinor ende nuk ka mbërritur, por që mbetet mbi kokën e Skënderbeut si shpata e Demokleut, pasi më 7 shkurt, akuza ka firmosur kërkesën e saj. Ndërkohë, ka reaguar klubi i Skënderbeut, që ka dashur të qartësojë opinionin, duke saktësuar se bëhet fjalë vetëm për një kërkesë, e cila nuk përbën një vendim përfundimtar.

SITUATA

Në të vërtetë nuk kemi të bëjmë ende me një dënim të Skënderbeut nga komisionet e UEFA-s, por me një kërkesë për dënimin e tij me 10 vjet nga Kupat e Europës, si dhe me një gjobë prej 1 milion eurosh. Kjo është pretenca e përfaqësuesve të Komisionit të Disiplinës në UEFA. Tani UEFA pritet të marrë një vendim, që gjithsesi do të jetë i rëndë për Skënderbeun, por ndoshta jo 10 vjet, sa është kërkuar aktualisht. Herën e parë Skënderbeu u përjashtua një vit nga Kupat e Europës dhe në atë rast kishim të bënim me një dënim administrativ. Pra, Disiplina e UEFA-s kërkon nga Apeli një dënim disiplinor dhe gjithçka do të mësohet më vonë.



VENDIMI I PLOTË:

Bazuar në konsideratat e sipërpërmendura, inspektorët e Etikës dhe të Disiplinës kërkojnë nga Komisioni i Disiplinës dhe Etikës pranë UEFA-s që:

" Të referojnë çështjen

tek Komisioni i Apelit në UEFA në lidhje me nenin 34(3) në Statutin e UEFA-s dhe nenit 29(3) në Rregulloren e Disiplinës.

Kështu, inspektorët e Etikës dhe Disiplinës kërkojnë nga Komisioni i

Disiplinës që:

" Të deklarojë se KS "Skënderbeu" është i përjashtuar nga pjesëmarrja në çdo kompeticion të UEFA-s për dhjetë (10) vite.

I shtohet edhe një gjobë prej 1 milion eurosh për KS

Herën e parë Skënderbeu u përjashtua një vit nga Kupat e Europës dhe në atë rast kishim të bënim me një dënim administrativ. Pra, Disiplina e UEFA-s kërkon nga Apeli një dënim disiplinor dhe gjithçka do të mësohet më vonë.

"Skënderbeu".

" Inspektorët e Etikës dhe të Disiplinës kanë të drejtat e tyre të shtojnë apo të ndryshojnë këtë raport me informacione apo prove të tjera në lidhje me këtë çështje. Nion, 7 shkurt 2018.

Mediat e huaja, jehonë lajmit të dënimit të mundshëm të Skënderbeut

REAGIMET

Lajmi i një dënimi të prishëm nga UEFA për Skënderbeun ka bërë bujë në mediat ndërkombëtare. Të parat kanë qenë mediat përtej Adriatikut, ato italiane, të cilat kanë pasqyruar këtë ngjarje. Më pas, kanë filluar me radhë edhe mediat e tjera, si ato greke, turke etj. Në vijim, disa nga titujt e portaleve të ndryshëm për lajmin e përjashtimit të mundshëm të Skënderbeut nga aktivitetet e UEFA-s.

"Gazzetta.gr": 10 vite



përjashtim për Skënderbeun për baste

"Premium Sport": Skënderbeu përjashtohet 10 vite nga aktivitetet europiane

"Goal.com": Kaos Skënderbeu, përjashtohet 10 vite nga kompeticionet e UEFA-s

"Calcioweb": E bujshme, Skënderbeu përjashtohet nga të gjitha aktivitetet e UEFA-s

"Tuttomercatoweb": Skënderbeu, 10 vite skualifikim për manipulim ndeshesh.

KLUBI KORÇAR

Reagon Skënderbeu: Nuk ka dënim, akuzën e dinim prej kohësh

Klubi i Skënderbeut ka reaguar nëpërmjet një statusi në "Facebook", në lidhje me dënimin e mundshëm nga UEFA, sipas raportit të Komisioneve të Disiplinës dhe Etikës, të cilët kërkojnë përjashtimin e Skënderbeut për 10 vite nga kompeticionet europiane si dhe 1 milion euro gjobë. "Duke marrë shkas nga lajmet më të fundit të publikuara sot në mediat sportive mbi ekzistencën e vendimit të UEFA-s për dënimin e klubit të Skënderbeut, klubi i futbollit Skënderbeu dëshiron të informojë opinionin publik, se nuk ka aktualisht ndonjë vendim të trupave gjyqësore, disiplinore të UEFA-s për klubin e Skënderbeut. Shpjegojmë se dokumenti i publikuar nuk është aspak vendim përfundimtar, por kërkesa për gjykim e inspektorëve të disiplinës së UEFA-s drejtuar trupës së Apelit, të Komisionit të Disiplinës dhe Etikës në UEFA. Duam të qartësojmë se ky është një apelim i inspektorëve ndaj vendimit të marrë pothuajse dy vite më parë ndaj Skënderbeut në bazë të nenit 34(3) të statutit të UEFA-s dhe jo një çështje e re kundër klubit. Kjo procedurë është konform nenit 29/3 të Kodit të Disiplinës së UEFA-s, gjithashtu ju bëjmë me dije se kemi të bëjmë me një çështje disiplinore në proces për të cilën nuk është caktuar ende një seancë dëgjimore. KF "Skënderbeu" është njohur me kohë me këtë akuzë të inspektorëve të Disiplinës. Sektori juridik i KF "Skënderbeu" po ndjek procedurat e nevojshme juridike për çështjen në fjalë dhe shprehim sigurinë tonë që çështja do të mbyllet me sukses. Faleminderit për mirëkuptimin!", mbyllet reagimi i zyrës për shtyp të klubit korçar.

RENDITJA E FIFA-S

FIFA ka publikuar dje renditjen e ekipeve kombëtare për muajin shkurt dhe Shqipëria ka fituar një vend, duke shkuar në vend të 59-të nga vendi i 60-të. Kombëtarja kuqezi nuk ka luajtur së fundi, por renditja lëviz edhe nga paraqitja e ko-



Shqipëria dhe Kosova fitojnë nga një vend

mbëtareve të tjera. Ndeshja e fundit është miqësorja me Turqinë. Rënditja kryesohet nga Gjermania, Brazili dhe Portugalia, ndërsa Norvegjia, kundërshtari i Shqipërisë në miqësoren e

radhës mban vendin e 56-të në renditje, pra është para kuqezi. Janë përmirësuar me nga një vend edhe Skocia dhe Izraeli, kundërshtarët në grup të Shqipërisë në Ligën e Ko-

mbeve. Skocia, nga vendi i 31-të, është ngjitur në të 30-in, kurse Izraeli ka lënë vendin e 99-të për t'u ngjitur në të 98-in. Edhe Kosova ka fituar një vend në këtë renditje dhe tashmë e sheh veten në vend të 177-të nga i 178-i që ishte më parë.

Dikur ishin pranë rënies nga kategoria, sot janë nga emrat më të frikshëm në kontinent

Kur PSG i shikonte Kupat e Europës nga televizori

Miliardat e Al Thani ringritën klubin francez

Sot PSG-ja është një nga klubet më të fuqishme e të pasura në futbollin botëror. Marrja në pronësi e klubit francez nga pronarët nga Katar i ka ndryshuar totalisht mënyrën e të punuarit. Parisienët po dominojnë futbollin francez në 6 vitet e fundit, ku kanë fituar 4 herë kampionatin dhe janë favoritët në këtë sezon, shkruan "eduasportin.com". Por, rruga drejt shndërrimit në një superfuqi të futbollit evropian ka kaluar në vitin 1974, kur u bashkuan klubet e Paris FC (1969) dhe Stade Saint Germain (1904). Në vitin 1970, Federata Franceze e Futbollit pyeti 70 mijë parisienë se çfarë duhej bërë që të krijohesh një skuadër konkurrese me ekipet e kryeqyteteve të tjera. PSG nisi të luajë në stadiumin "Parc des Princes" me 48583 spektatorë, që u hap fillimisht në 1987. Aty më parë luheshin ndeshjet e regjise. Klubi ka përfutur lunturi dhe trishtim, pasuri dhe varfëri e madje ka rrezikuar edhe të falimentojë. Në sezonet 2006-07 dhe 2007-08 ata ishin pranë rënies nga kategoria. Pasi fituan "Coupe de France" në 2004, Hugo Leal, ish-lojtar i Atletico Madridit tha se sukcesi ishte special, pasi ekipit gjithnjë i kërkohet të luan mirë. "Kam luajtur me futbollistë të mëdhenj si Ronaldinho, (Nicolas) Anelka, (Mikel) Arteta, (Mauricio) Pochettino. Kishte më shumë rëndësi që gëzimin t'ndanim me të gjithë skuadrën se sa vetë titullit. Ekipi po rritej, kishte tifozë, por në Paris, njerëzit ishin më të përkushtuar me kombëtaren se sa me ekipin e qytetit. Disa qytetarë nuk njihnin futbollistët dhe kjo më tërhoqi vëmendjen, sidomos nëse e krahasojmë me Madridin. Pra, PSG-ja nuk ishte shumë popullore". Ish-mesfushori dhe kapiteni i Arsenalit, Mikel Arteta rrefën se çfarë atmosfere dominonte në ekipin e kryeqytetit francez. "Kur firmosa, vura re se çdo gjë ishte urgjente; loja, rezultatet, fansat, struktura. Të duhej pak kohë të përshatëshe. Mendoj se ishim pak a shumë si Atletico Madridi i

Francës, një ekip i madh, që duhej të kishte pritshmëri në varësi të potencialit. Atletico e bëri këtë pasi ra nga La Liga. Ne nuk shkuam aq poshtë, por duhej të riorganizim çdo gjë". Por, ai dhe shokët e ekipit bënin një jetë luks, pasi në atë kohë, klubi ishte në pronësi të "Canal+". "Mbjaj mend se udhëtonim me Boeing 747, kishim shumë vende të lira në avion. Mbjaj mend se në dimër erdhi Ronaldinho, talenti më i madh brazilian që po shikonte në Evropë dhe ne kishim dhe Anelka, që ishte i mrekullueshëm në stërvitje. Kishim çdo gjë për t'i bërë punët mirë, por nuk shkoi ashtu siç dëshironim", deklaroi asistenti i Pep Guardiola të Manchester Siti. Kurse mesfushori spanjoll që iu bashkua PSG-së në huazim në vitin 2001, Enrique de Lucas, tregon se si lojtarët duhej të përballëshin me trafikun e Parisit dhe tifozët. "Ne duhej që t'i parkonim makinat tona disa kilometra larg qendrës stërvitore dhe më pas lëviznim me mikrobus. E njëjta gjë edhe gjatë ditëve të ndeshjeve. Gjithashtu kam foto të lojtarëve që pinë du-



han me trajnerin. Ne kishim presion nga stafi mjekësor, por as gjysma e asaj që bëhet sot. Tifozët e PSG-së ishin më fanatikët në të gjithë vendin dhe ndeshjet kundër Marseille-s ishin shumë të tensionuara. Kur humbim, tifozët tërboheshin. Mbjaj mend në një takim për kupë kur ne u mundëm në shtëpi 0-4 nga Guingamp, na u desh të rrinim 2 orë në dhomat e zveshjes e pastaj të largoheshim", kujton De Lucas. Ndërsa, ish-portieri i PSG-së dhe Kombëtares së "Gjelave", Bernard Lama dhe Vincent Guerin u kënaqën më shumë gjatë qëndrimit të

Evropës (sot Liga e Kampioneve) ishte diçka që e shikim vetëm në televizor", rrefën francezët. Që nga krijimi, PSG është një nga klubet që i kushton shumë vëmendje anës estetikë. Mjafton të përmendet fakti se stemën, klubin e ka ndryshuar 7 herë. Fanellat u dizajnuan nga Daniel Hechter, një ekspert mode i cili ishte një ndër drejtuesit e parë të klubit. Ardhja e parave nga Katar nuk ka bërë gjë tjetër veçse ka shtuar përpjekjet për ta bërë PSG-në një markë ndërkombëtare. Nëse më parë në ekip vinin futbollistë si David Ginola, George Weah, Ronaldinho, David Beckham dhe Zlatan Ibrahimovic, tani PSG-ja është më e fortë se kurrë me emra si Edinson Cavani, Kylian Mbappe dhe Neymar. Shansin për të treguar se sa të mëdhenj janë bërë e kanë në takimin e kthimit të 1/8-ve në Champions. Në "Parc de Prince" do të duhet përmbysin humbjen 3-1 të pësuar në "Santiago Bernabeu" nga Reali.

TITULLARËT

Sergio Ramos	11.385
Kroos	13.362
Inco	11.491
Bale	2.913
Keylor Navas	4.094
Modric	12.003
Nacho	11.452
Marcelo	10.574
Caseirino	10.992
Varane	11.320
Lucas Vázquez	2.036
Benzena	9.404
Atensio	1.829
TOTAL	123.644

Real Madridi fitoi sepse vrapoi më shumë se PSG

Titullarët e Real Madridit që u përballën me PSG-në të mërkurën në "Santiago Bernabeu" vrapuan 15 kilometra më shumë se sa mesatarja deri në këto momente në Ligën e Kampioneve. "Galaktikët" regjistruan 123.644 metra të përshkuara, 15.706 më shumë se sa mesatarja e vendosur aktualisht në kampionat, 107.938 metra. Angazhimi më i madh i madrilenëve në fazën grupeve ishte në takimin e gjashtë kundër Borussia Dortmund-it (114.790 metra të përshkuar). Por, kjo shifer nuk ka të bëjë me lëvizshmërinë e futbollistëve në takimin kundër parisienëve. Përveç kësaj, duhet thënë se asnjë nga titullarët e djeshëm nuk ka vrapuar më shumë në takimet e tjera të luajtura në këtë sezon në fazën e grupeve. Kristiano Ronaldo tejkaloi veten duke vrapuar 10749 metra nga 9567 metra. Asnjë në klub nuk ka vrapuar më shumë se sa ai, 65.505 metra. Kroos vrapoi më shumë se të tjerët me 13.362 metra, shumë më tepër se sa mesatarja e tij 9.889. Skuadra sakrifikoji shumë ndaj parisienëve, në aksionet sulmuese, por edhe duke u kthyer në mbrojtje. Edhe portieri Keylor Navas vrapoi 4 kilometra. Autori i golit të tretë, Marcelo, ishte ai që regjistroi distancën më të ulët të përshkuar nga titullarët që nuk u zëvendësuan, me 10.574 metra. Real Madridi ka vrapuar në të gjitha sfidat e Champions-it 771.272 metra. Është e qartë, se "Galaktikët" transformohen kur u duhet që të fitojnë sfida të vështira si ajo ndaj PSG-së.

BARDHEZINJTË

Qetësohet Alegri, rikthehet Dybala dhe Howedes

Qetësohen te Juventusit. Paulo Dybala dhe Bene diket Howedes janë rikthyer në dispozicion të trajnerit Alegri. Sulmuesi argjentinas dhe mbrojtësi gjerman kanë lënë pas dëmtimet dhe tashmë do të jenë të gatshëm për sfidat e radhës që do të zhvillojnë kampionatet e Italisë. Të dy futbollistët i janë bashkuar grupit në seancën e sotme stërvitore. Sulmuesi argjentinas nuk luajti prej më shumë se një muaj, por për fat të mirë, ai do të jetë i gatshëm edhe për takimin e kthimit në Champions kundër Tottenhamit.

MARKO REUS

Milani ka gati ofertën për yllin e Dortmundit

Ecuria e dobët e Milanit këtë sezon duket se i ka bërë drejtuesit e saj të mendojnë që tani për merkaton e verës. Kuqezi janë të interesuar për shërbimet e yllit të Dortmundit, Marko Reus. Drejtori sportiv i Milanit, Masimiliano Mirabeli ka udhëtuar drejt Gjermanisë për të parë mundësinë e transferimit në Itali të sulmuesit Rojs. Kontrata e 28-vjeçarit skadon në verën e vitit 2019 dhe transferimi këtë verë kap shifrën e 50 milionë eurove. Të interesuara për shërbimet e tij janë edhe ekipet si Real Madridi, Barcelona apo edhe dy skuadrat e Manchesterit. Marko Reus është rikthyer të luajë këtë javë, pasi vuan prej një dëmtimi të rëndë, që e ka detyruar të jetë jashtë fushave për disa muaj. Ky nuk ishte dëmtimi i parë i sulmuesit, prandaj edhe ekipet europiane kanë frikën e ndonjë shpenzimi të tepërt, i cili mund të rezultojë një dështim.

Zyrtari i lartë për mediat: Procedura përfundon brenda shkurtit

Vizita e Markoviç, arrihet marrëveshja për demarkacionin

Delawie: Kosova e Serbia të arrijnë marrëveshje

Mesa duket vizita e kryeministrit të Malit të Zi në Kosovë ka dhënë frytet e saj pasi të dy palët kanë arritur më në fund një marrëveshje për demarkacionin. Vizita e kryeministrit të Malit të Zi Dushko Markoviç në Prishtinë përfundimisht pritet ta zgjidhë çështjen e demarkacionit, e cila po e mban të bllokuar Kosovën prej tre vitesh. Express njofton nga burimet e saj se Markoviç gjatë takimeve në Prishtinë me liderët kosovarë ka gjetur gjuhë të përbashkët për çështjen e kufirit dhe se kjo temë do të marrë epilog të shpejtë. Një burim i besueshëm ka thënë se Prishtina dhe Podgorica kanë rënë dakord që në ditët në vijim të kenë një komunikim intensiv që do ta prodhojë zgjidhjen. "Dy delegacionet e larta janë dakorduar që të ketë një komunikim intensiv ditëve të ardhshme në të gjitha nivelet dhe të shihet se ku mund të jenë bërë gabimet. Pastaj do t'i hapet rrugë ratifikimit me një procedure të shpejtë. E gjitha do të kryhet gjatë muajit shkurt", ka thënë një zyrtar i lartë për Express. Ndërkohë që ambasadori i SHBA-së në Kosovë, Greg Delawie ka thënë se e sheh pozitive Strategjinë e Bashkimit Evropian për Ballkanin Perëndimor. Sipas tij, në të ka shumë elemente të rëndësishme për Kosovën që janë pozitive. "Ajo më pozitive është se thotë se të gjitha vendet e Ballkanit perëndimor, përfshirë Kosovën do të jenë në gjendje që t'i bashkohen Bashkimit Evropian", ka thënë Delawie në RTV21. Ai ka shtuar se udhëheqësit duhet t'i marrin përgjegjësitë e tyre për t'i ofruar ndryshimet që priten. Delawie ka folur edhe për marrëdhëniet Kosovë-Serbi, me ç'rast tha se BE-ja nuk do të importojë probleme bilaterale. "Dokumentet e BE-së qartazi e thotë se BE-ja nuk do të importojë probleme bilaterale mes shteteve anëtare të saj dhe thotë se Kosova dhe Serbia duhet ta kenë një ujdetyruese dhe duhet ta bëjnë këtë urgjent", - ka shtuar Delawie. Ambasadori amerikan ka thënë se Kosova duhet të punojë në marrëdhëniet me Serbinë dhe këtë duhet ta bëjë për interesin e vet, po ashtu duhet ta bëjë edhe për t'i përmbytur ambicjet për në BE. "Nuk dëshiroj që Kosova të mbetet prapa", - përfundoi ambasadori.



Kryeministri i Malit të Zi, Dushko Markoviç me Hashim Thaçin

Deklarata



AMBASADORI GREG DELAWIE:

"Dokumentet e BE-së qartazi e thotë se BE-ja nuk do të importojë probleme bilaterale mes shteteve anëtare të saj dhe thotë se Kosova dhe Serbia duhet ta kenë një ujdetyruese dhe duhet ta bëjnë këtë urgjent", - ka thënë Delawie.



Kryeministri turk, Binali Yildirim

Tensionet në detin Egje, Turqia i kërkon Greqisë të përmbahet

Ankaraja në mënyrë eksplicite i ka thënë Greqisë se heqja dorë nga tensionet do të ishte më e mirë për lidhjet e ndërsjella", tha kryeministri turk Binali Yildirim, duke shtuar se Deti Egje duhet të jetë një det "miqësie" mes dy vendeve. Duke folur me mediat në Aeroportin e Esenbo'ga të Ankarasë para se të nisej për në Bjellorusi, Yildirim tha se qëndrimi larg tensioneve do të jetë më mirë, lidhur me marrëdhëniet midis dy vendeve. Vërejtjet e tij erdhën një ditë pasi ai dhe Tsipras patën një bisedë telefonike dhe diskutuan zhvillimet e fundit në Detin Egje. Ai tha se Deti Egje duhet të jetë një det "miqësie: midis Turqisë dhe Greqisë. "Kohët e fundit, ka pasur disa shkelje në këtë tension, i cili filloi me ishujt Kardak, për të cilat kemi dhënë një përgjigje", tha Yildirim. Ai shtoi se të dy kryeministrat kanë dakord të lehtësonin tensionet dhe të mbanin linjën e komunikimit përmes kanaleve politike dhe diplomatike. Yildirim tha se një takim i Shtabit të Përgjithshëm të NATO-s do të mbahej në maj.

Kryediplomati Gabriel: Keni mbështetjen tonë

Ministri gjerman: Serbia s'hyn në BE pa njohur Kosovën

Stigmar Gabriel, ministri i Punëve të Jashtme të Gjermanisë, ka takuar dje kryeministrin e Kosovës Ramush Haradinaj. Ai bëri me dije se ia ka bërë të qartë edhe shtetit të Serbisë që nëse dëshiron integrimin evropian, duhet ta njohë Kosovën, përveç plotësimit të kriterit për shtet ligjor. "Ne edhe në Beograd e kemi theksuar që, nëse Serbia dëshiron të

shkojë në drejtim të BE-së, duhet që të plotësojë kriteret e shtetit ligjor dhe natyrisht edhe pranimin e pavarësisë së Kosovës. Ky është një parakusht për rrugën e tyre për në BE dhe për këtë ju mund të llogarisni në mbështetjen tonë", tha Gabriel. Kryediplomati gjerman,

para se të shkonte në Prishtinë, dje ka qëndruar në Beograd, ku është takuar edhe me presidentin serb Aleksandër Vuçiç. Gabriel i ka dhënë leksione Vuçiçit se si ndodhë pajtimi me popujt tjerë, duke përmendur gjenocidin të kryer nga Gjermania. "Bashkimi Evropian

është një shembull, ku (edhe) nga hasmëritë më të mëdha, nga luftërat më të mëdha, bile edhe nga një Gjenocid i ushtruar organizuar nga ne Gjermanët - megjithatë mund të ngjizet një partneritet, madje edhe një miqësi", ka thënë Gabriel.

Masakra në SHBA, flet sulmuesi 19-vjeçar: Do jem një qitës profesionist

Tmerr në Florida, vriten 17 persona në shkollë

Ditën e djeshme një ngjarje e tmerrshme ka ndodhur në SHBA. Të paktën 17 persona kanë mbetur të vrarë në një shkollë të mesme në Parkland të Floridas, në Shtetet e .re është Nikolaus Cruz, një 19-vjeçar, ish-nxënës i përjashtuar nga kjo shkollë. Sipas asaj që shkruan amerikanja CBS, duke cituar policinë, ai aktivizoi alarmin e zjarri duke shkaktuar kaos në shkollë, përpara se të hapte zjarr. Nxënësit u detyruan të fshiheshin nëpër klasa, ndërkohë që policia rrethoi ndërtesën. Zyrtarë të policisë thanë se Cruz kishte një pushkë dhe "një numër të madh revistash". Jë shtënat me armë nisën jashtë shkollës, ku 3 persona u vranë. Më pas 19-vjeçari u fut brenda ku vrau 12 persona të tjerë. 2 persona humbën jetën në spital. Me ngritjen e alarmit, policia nisi të evakuonte nxënësit duke



Masakra në Florida

Sulmuesi 19-vjeçar


marrë me radhë ndërtesat. Një numër të madh prindërisht që ishin mbledhur jashtë perimetrit të vendosur nga policia. Dëshmitarë të shumtë që ndodheshin brenda

ndërtesës raportuan se përpara se të nisnin të shtënat me armë kishte rënë alarmi i zjarrit. Një prej studentëve të evakuuar nga shkolla, duke folur për CBS tha

se kishin menduar se s'bëhej fjalë për asgjë serioze, e se ishte një lloj stërvitjeje. Një mësuese tha për WSVN se së bashku me 19 studentë të tjerë ishin fshehur në dol-

lapë, përreth 40 minuta dhe se shkolla ishte trajnuar për në situatë të tillë 6 javë më parë. Ndërkaq FBI konfirmoi se ka qenë e paralajmëruar për adoleshentin. Nikolas Cruz, i cili është ngarkuar me 17 akuzë për vrasje me paramendim, raportohet se ka komentuar një video në YouTube vitin e kaluar, duke thënë: "Do të jem qitës profesionist në shkollë". Një përdorues i ka alarmuar autoritetet për postimin. Mësuesit po ashtu kanë qenë të paralajmëruar për Cruzin, i cili nuk është lejuar të hyjë në kampusin e shkollës me çantë shpine. "Ka pasur probleme me të vitin e kaluar, pasi ka kërcënuar studentët", ka thënë Jim Gard, mësues i matematikës. Ai është arrestuar nga policia një orë pas sulmit. FBI tha se e ka hetuar komentin në YouTube, por nuk ka qenë në gjendje të konfirmojë plotësisht personin që e ka postuar atë.

Fjalëkryqi (1)



HORIZONTAL

2. Janë vërejtje për veten.
12. Një veprim shumës.
14. Një verë në Paris.
15. Një pjesë e atributive.
16. Një rrugë në Paris.
17. Fillojnë kalimin.
18. Ekstre në rrizik.
20. Në hyrje të oazit
21. Mbyllin një spital.
23. Eshhtë e përpjeta.
24. Kufizojnë një mekanik.
25. Jeton në vetmi.
28. Mund të jenë autonome.
30. Janë diktatorë shtypës.
31. Gjysmë nderim.
32. Janë sekte islamike.
33. Shteti i francezëve.
35. Janë legjenda.
36. Nuk bëhet me lepuj.

VERTIKAL

1. Jessica Parker aktore.
2. Haset pa kufij.
3. Arturo i Brecht.
4. Një sferë për model.
5. Ndezur në aparatë.
6. Një virtual në computer.
7. Italia në Internet.
8. Një fushë sportive.
9. Kapen të parat.
10. Janë grimcat me bërthama.
11. Eshhtë marrëveshje edhe miqësie.
13. Eshhtë portofol.
17. Janë brinjat në skuadër.
19. Janë të drejtë në skuadër.
22. Shuma e brinjëve të shumëkëndeshit.
23. Një që punon në galeri.
26. Grirë pa kufij.
27. Një metalprerëse si tornio.
29. Eshhtë një ushtarak i rangut të ulët.
32. Janë gra të Ankarasë.
34. Ema aktore.
36. Një është edhe Kosova
37. Një Luan në LSI.
38. Altini mesfushor.
41. Kufijtë e rritjes.
42. Një tifoz i rockstar-it
43. Gjysmë aneksi.
45. Ente Tregtare Tiranë.
47. Fillojnë takimin.
48. Inicialet e Mann.


Fjalëkryqi (2)

HORIZONTAL


1. Turk ai i Mozart.
6. Gjysma e sasisë.
9. Qytet termal belg.
12. Një pije freskuese.
13. Janë edhe ato të forcës.
15. Mund të jetë emërore.
16. Ngrihen për shkak të epidemive.
17. Rubinstein që qe balerinë.
18. Eshhtë riparimi i përgjithshëm.
19. Në krye të noterëve.
20. Kështu është i mërzitshmi.
21. Carson i fumetti-t.
23. Ushtrohej nag bukanierët.
25. Qendër ditore.
26. Kanë shtretër për derman të tillë.
28. Inicialet e Redford.
30. Emri i Zola.
32. Dickinson që qe poete.
34. Kufizojnë një vend.

VERTIKAL


1. Janë trupat e Flotës VI.
2. Jorge shkrimtar.
3. Dino regjisor.
4. Pak stabilitet.
5. Një hektar i shkurtër.
6. Mund të jenë filmi.
7. Eshhtë diletant.
8. Qe arkitekt i famshëm me origjinë shqiptare
9. Bie një me rebesh.
10. Ishte titulli i Nehru.
11. Ai dhe ajo.
13. Një pallto ushtarake
14. I ka të ndryshme stili.
16. Ndërohen me zapping.
18. Janë këngët me shumë zëra.
20. Si legjendarë.
22. Renis që këndonm Quando, quando, quando.
23. Shpimi pa shi.
24. Një mund të jetë deri në dhembë.
27. Almodovar regjisor.
29. Mund të jetë fetar.
31. Eshhtë mudi pa doby.
32. Nuk ka akoma një bebe.
33. Qarkullojnë në Shqipëri.
34. I bylbylit ai i Mjedës.
37. Janë në skaje.
39. Një pjesë e territorit.
40. Fisku pa zë.
41. Eshhtë lloj papagalli.
43. Dymijë romake.
44. Inicialet e Adjani.



Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave



PËRGJIGJET E FJALËKRYQEVE TË NUMRIT TË KALUAR

FJALËKRYQI (1)

FJALËKRYQI (2)



Argëtim filozofik

- Fjala "krizë" në gjuhën e shkruar kineze, përbëhet nga dy simbole. Njëri përfaqëson rrezikun, dhe tjetri përfaqëson mundësinë. (Xhon Kenedi)
- Nëse doni që diçka të realizohet shkoni vetë, nëse nuk doni, dërgoni të tjerë. (Benxhamin Franklin)
- Fundi i madh i jetës nuk janë njohuritë, por veprat. (Tomas Fuller)

Ehënie të mençura

- Guxoni të veproni në vend që të kundërveproni. (Lërlin Larson Xhenks)
- Vlera qëndron pikërisht në mes të rrugës midis nxitimit dhe ndrojtjes. (Servantes)
- Për miqësinë
- Fatkeqësia të tregon se kush janë miqtë tuaj të vërtetë. Lois McMaster Bujold
- Dua gjithmonë të di çdo gjë mbi miqtë e mi të rinj dhe asgjë mbi ata të vjetrit. Oscar Wilde (1854 - 1900)

SUDOKU

	6	2	9			5	8	
	7		3	2	1		6	
			4	6				3
		1	7					4
	4	3				6	2	
9					3	8		
8					7	1		
	5		1	4	8		3	
1	7				6	9	5	


Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

4	8	6	3	5	7	9	2	1
7	2	3	8	1	9	5	4	6
1	5	9	4	6	2	3	7	8
5	7	2	1	4	3	6	8	9
6	3	4	2	9	8	7	1	5
8	9	1	5	7	6	4	3	2
2	4	7	6	8	5	1	9	3
9	6	8	7	3	1	2	5	4
3	1	5	9	2	4	8	6	7

KRIPTOSKEME

KRIPTOSKEME
Përgjigja e numrit të djeshëm



www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

GAZETA SHQIPTARE

GSH.AL



- Na merrni!
- Na shkruani!
- Na lexoni!

GSH

www.gsh.al



Tashmë edhe lundroni!

